

PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XXV, viti 2005 / 25th issue, year 2005

Faqe

Reforma ligjore dhe Integrimi europian:

Reforma në fushën tregtare dhe plani kombëtar i përafrimit të legjislacionit të shoqërive tregtare	Besjana BUFI, Ketrin TOPÇIU	4
Pronësia industriale dhe tregtare në Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit	Elvis ÇIBUKU	17
Disa rekomandime mbi hartimin e akteve normative me qëllim harmonizimin dhe unifikimin e legjislacionit.	Rezana BALLA	28
Ndikimi i <i>Acquis Communautaire</i> në efektshmërinë e ligjit në Evropën Qendrore dhe Lindore	Matin BRUNCKO	44

E Drejta Kushtetuese:

Ligjshmëria e ligjshmërisë	Charles-Albert MORAND	64
----------------------------	-----------------------	----

Nga veprimtaritë e Qendrës së Studimeve Parlamentare:

Monitorimi i zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare”. Raport paraprak		82
---	--	----

Nga punimet e Kuvendit:

Legjislacioni i miratuar	Filip LAKO	97
--------------------------	------------	----

Përmbledhje në anglisht:

Information on laws passed by Assembly	Filip LAKO	120
--	------------	-----

TABLE OF CONTENTS:

25th issue, year 2005

	Page
<hr/> <i>Legal reform and European Integration:</i>	
Reform in the market field and the national plan of the approximation of commercial companies legislation	
Besjana BUFI, Ketrin TOPÇIU	4
Industrial and trade property in the Stabilization and Association Agreement	
Elvis ÇIBUKU	17
Some recommendations on drafting the legal acts aiming at the harmonisation and unification of the legislation.	
Rezana BALLA	28
The impact of <i>Acquis Communautaire</i> on the effectiveness of the law in Central and Eastern Europe	
Matin BRUNCKO	44
<hr/> <i>Constitutional Law:</i>	
Legality of legality	
Charles-Albert MORAND	64
<hr/> <i>From the activities of the Centre for Parliamentary Studies:</i>	
Monitoring of the implementation of the law “Right to information on the official documentation”. Preparatory report	82
<hr/> <i>From the proceedings of the Assembly:</i>	
Information on laws passed by the Assembly	
Filip LAKO	97
<hr/> <i>Summary in English:</i>	
Information on laws passed by Assembly	
Filip LAKO	120
<hr/>	

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studiuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Reforma në fushën tregtare dhe plani kombëtar i përafrimit të legjislacionit të shoqërive tregtare

*Besjana Bufi **
*Ketrin Topçiu **

HYRJE

Integrimi është një nga fjalët më të përdorura aktualisht në jetën shqiptare. Politikanët, artistët, intelektualët flasin për integrimin politik evropian, ekonomik, kulturor, madje edhe për integrimin shpirtëror. Një nga drejtimitet ku synojmë të integrohemi, ai euro-atlantik, mbetet më i rëndësishmi, pasi do të nxisë edhe procese të tjera integruese. Të gjitha programet qeveritare shqiptare, që nga viti 1992, kanë shpallur qartë orientimin e tyre euro-atlantik.

Kështu, një nga çështjet për të cilën të gjithë janë dakord në Shqipëri është se anëtarësimi në Bashkimin Evropian mbetet objektivi kryesor si afatshkurtër, ashtu dhe afatgjatë i Këshillit të Ministrave. Bashkimi Evropian është i pranishëm pothuajse në çdo aspekt të jetës shqiptare, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në ndërtimin dhe përmirësimin e institucioneve,

* Autorja është specialiste në Sektorin e së Drejtës Civile-tregtare në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë. Mendimet e shprehura në këtë artikull nuk përfaqësojnë opinionin e institucionit ku ajo punon.

* Autorja është shefe e Sektorit të së Drejtës Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë. Mendimet e shprehura në këtë artikull nuk përfaqësojnë opinionin e institucionit ku ajo punon.

nëpërmjet vëzhgimit të zgjedhjeve, dhënies së ndihmës ekonomike etj. Në këtë sfond, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ka qenë në qendër të vëmendjes dhe një qëllim parësor i tërë politikës shqiptare.

Për të vazhduar më tej në ecurinë e këtij procesi, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 317, datë 13.5.2005 miratoi Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të Bashkimit Europian dhe të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Ky artikull synon të shpjegojë për lexuesit e përzgjedhur të kësaj reviste reformën në legjislacionin tregtar që konsiderohet si angazhim parësor në procesin e nisur në kuadrin e përafrimit të legjislacionit të brendshëm me atë komunitar.

KUADRI LIGJOR DHE PRAKTIKA AKTUALE

Për të kuptuar dhe më tej për të analizuar ndryshimet që parashikohen në legjislacionin tregtar, duhet të paraqesim në mënyrë të përmbledhur tri ligjet bazë që për 13 vjet kanë drejtuar ekonominë dhe biznesin shqiptar, por që me zhvillimet e reja në këtë fushë janë krijuar probleme dhe vështirësi që imponojnë domosdoshmërisht zgjidhje juridike nëpërmjet përmirësimit në tërësi të legjislacionit tregtar.

Ligji nr. 7632, datë 04.11.1992 “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar”.

Ky ligj është miratuar me idenë që pas tij do të kalonte për miratim ligji me pjesën e posaçme të Kodit Tregtar, gjë që nuk u realizua si rezultat i miratimit të ligjit “Për shoqëritë tregtare” dhe të vendosjes në Kodin Civil të pjesës së posaçme të Kodit Tregtar, që lidhet me kontratat dhe veprimet juridike tregtare. Gjithashtu, një tjetër mangësi e nxjerrë nga praktika konsiston në faktin se çështje të njëjta i gjejmë të dubluara jo vetëm në këtë ligj, por edhe në atë të regjistrimit tregtar.

Ligji nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, i ndryshuar me ligjin nr. 7953, datë 21.06.1995 dhe ligjin nr. 8108, datë 28.03.1996. Ky është ligji bazë që përcakton 4 forma shoqërie tregtare (shoqëri kolektive,

komandite, me përgjegjësi të kufizuar, anonime dhe shoqëritë shtetërore si shoqëri anonime, në të cilat të gjitha aksionet zotërohen nga shteti ose nga një ent publik), mënyrën e krijimit dhe të funksionimit të tyre, organet kryesore drejtuese dhe strukturat organizative, rolin dhe kompetencat e çdo organi dhe mënyrën e vendimmarrjes, raportet hierarkike dhe mënyrën e dhënies llogari për veprimet e kryera në emër dhe për llogari të shoqërisë etj. Një vend me rëndësi në ligj zë edhe kapitali i shoqërive, mënyra e rritjes dhe e zvogëlimit të tij, si dhe procedurat e likuidimit të shoqërive tregtare në kuadrin e formave për mbarimin dhe krijimin e subjekteve të reja.

Legjislacioni shqiptar pranon edhe krijimin e subjektit tregtar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar me pjesëmarrjen vetem të një personi. Ky person quhet “ortaku i vetëm”¹ dhe shoqëria quhet shoqëri me ortak të vetëm.

Në mjaft raste në praktikë krijohet një konfuzion midis termit “degë” dhe termit “filial”, aq sa ndonjëherë ato trajtohen si identike, por nga mënyra e trajtimit në ligjet përkatëse, del se janë dy koncepte të ndryshme. Situatat përjashtimore nga nocioni i trajtimit të barabartë kanë të bëjnë vetëm me dispozitat tranzitore të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (p.sh. real estate, shërbimet financiare, transporti, njohja e ndërsjellë e diplomave).

Lind nevoja që në ndryshimet që do t'i bëhen paketës ligjore, e cila rregullon legjislacionin tregtar, të saktësohen këta terma dhe të bëhet dallimi nga njëri-tjetri, sepse nuk del e qartë, se kur jemi para njëres dhe kur jemi para tjetres, si dhe nuk del e qartë se cila prej tyre ka personalitet juridik.

Mbështetur në paketën ekzistuese ligjore dhe në praktikë figurojnë të evidentuara: shoqëri të reja tregtare, shoqëri të regjistruara si degë dhe shoqëri të regjistruara si përfaqësi. Ndryshimi midis degëve dhe përfaqësive në praktikën shqiptare është se dega ka personalitet juridik, mban emrin e

¹ Për më shumë hollësi shih nenin 37, paragrafi i dytë i ligjit për shoqëritë tregtare.

“mëmës”, kryhen veprimtari të njëjtë ose pjesërisht më të ngushtë se sa shoqëria “mëmë” dhe regjistrohet si subjekt më vete brenda kufijve që i jep shoqëria “mëmë”. Ndërsa përfaqësia është një subjekt që mban emrin e shoqërisë “mëmë”, por nuk kryhen veprime të përfaqësimit të saj juridik, sepse personaliteti i saj është i kufizuar vetëm në promovimin e veprimtarisë të shoqërisë “mëmë”, por ajo regjistrohet në gjykatë dhe, madje, ka pasur raste kur subjekti i huaj parapëlqen krijimin e përfaqësisë dhe jo të degës, sepse përfaqësia nuk konsiderohet fitimprurëse dhe nuk është subjekt i pagimit të taksave dhe i detyrimeve fiskale ndaj shtetit.

Regjistrimi i degës dhe i përfaqësisë është përafërsisht i njëjtë dhe bëhet me vendim të gjykatës. Regjistrimi kërkon dokumentacionin në vijim:

- *kërkesën e noterizuar të organit drejtues të shoqërisë “mëmë”;*
- *statutin e shoqërisë “mëmë”;*
- *aktin e themelimit të shoqërisë “mëmë”;*
- *vendimin e organit drejtues të organit «mëmë» për krijimin e tyre.*

Për *degën*, ka një ndryshim: vendimi i organit drejtues të shoqërisë mëmë” duhet të përcaktojë kufijtë e veprimit ose të administrimit dhe përfaqësimit të së drejtave të «mëmës», strukturën organizative dhe administrative të degës dhe personin drejtues të saj. Në rastin e degës kërkohet edhe vërtetimi bankar për depozitimin e një kapitali të kërkuar nga ligji si kapital themeltar.

Për *përfaqësinë* vendimi duhet të përcaktojë vetëm emrin e personit që drejton përfaqësinë, së bashku me kufijtë e përfaqësimit të shoqërisë «mëmë» prej tij.

Duhet theksuar se dega ose filiali, pas regjistrimit në gjykatë, duhet të regjistrohen edhe në zyrën e tatim taksave të ndarjes administrative ku ato kanë selinë e tyre², për të marrë një numër identifikimi si subjekt fiskal (NIPTI),

² Siç e shohim, kemi një lehtësi për regjistrimin si subjekt fiskal, sepse nuk është e centralizuar vetëm në Tiranë, siç ndodh për regjistrimin si subjekt juridik, por është në çdo rreth ku kanë selinë shoqëritë tregtare ose degët e tyre. E njëjta gjë duhet të ndodh edhe për regjistrimin e shoqërive tregtare në mënyrë që të lehtësohet lëvizja e lirë e njërëzve dhe e shërbimeve.

ndërsa përfaqësitë nuk regjistrohen si subjekt fiskal.

Me daljen e ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, çdo subjekt jofitimprurës duhet të regjistrohet në zyrën e tatim taksave, kështu që edhe përfaqësitë duhet të regjistrohen pranë saj, me qëllim që veprimtaria e tyre të mos jetë e kundërligjshme dhe të shmanget rreziku i të qenit një shoqëri tregtare apo degë që shmanget nga detyrimet fiskale.

Që nga viti 2001, kur ka dalë ligji i sipërpërmëndur, janë regjistruar gjithsej 1691 subjekte jofitimprurëse, nga të cilat 1293 shoqata, 177 fondacione dhe 221 qendra, ndërkohë kur deri në vitin 2000 vetëm në Tiranë janë regjistruar mbi 850 subjekte jofitimprurëse. Ky regjistër, ndonëse menaxhohet nga të njëjtët punonjës që menaxhojnë edhe Regjistrin Tregtar, nuk ka të dhëna as në rrugë elektronike, as në formë materiale dhe sa më shpejt të ndahet në fakt nga Regjistri Tregtar, aq më shpejt do të lehtësojë punën, sepse juridikisht janë dy regjistra të ndryshëm nga njëri-tjetri.

Regjistrimi në zyrën e tatim-taksave edhe i përfaqësive është parashikuar meqënëse ligji shqiptar për organizatat jofitimprurëse pranon mundësinë që ato mund të ndjekin qëllime ekonomike, por gjithmonë pa patur të drejtë të nxjerrin fitime dhe me kushtin që të ardhurat e krijuara nga veprimtaria tregtare e tyre të riqarkullohen për veprimtarinë e tyre. Regjistrimi pranë zyrës së tatim taksave në një regjistër të veçantë për OJF-të, u jep mundësinë autoriteteve fiskale që të mbajnë nën kontroll tregun për të minimizuar mundësitë e abuzimeve nga subjekte të ndryshme.

Për regjistrimin pranë zyrave të tatim-taksave duhen dokumentet e mëposhtme:

- *kërkesa e subjektit;*
- *vendimi i gjykatës për regjistrimin si subjekt tregtar;*
- *statuti i shoqërisë;*
- *kontrata me sigurimet shoqërore;*
- *certifikata e anëtarësisë në Dhomën e Tregëtisë;*
- *personi i kontaktit.*

Certifikata e regjistrimit si subjekt del brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Legjislacioni tregtar nuk ka ndonjë rregullim lidhur me shërbimet e mundshme që mund të kryhen pa qenë i regjistruar si degë a përfaqësi e një shoqërie të huaj tregtare, por neni 1 i ligjit nr. 7632, datë 4.11.1992 parashikon se për praktika të veçanta, të cilat nuk gjejnë rregullime në legjislacionin tregtar, zbatohen dispozitat e Kodit Civil. Duke u nisur edhe nga fakti, që pjesa e posaçme e Kodit Tregtar është brenda dispozitave të Kodit Civil, mund të arrijmë në përfundimin se ka shërbime që mund të kryhen nga subjekte të huaja tregtare me anë të kontratave të shitjes së mallrave, të kryerjes së shërbimeve të transportit, të sigurimit etj, pa qenë nevoja të jesh patjetër i regjistruar si subjekt tregtar, por duhet të bëhet kujdes që të mos operohet me strukturë të përhershme në Shqipëri, sepse kjo e fundit patjetër duhet të regjistrohet në një nga format e kërkuara ligjore.

Veç kësaj, Kodi Civil njeh edhe mundësinë e krijimit të shoqërive të thjeshta³, të cilat janë subjekte që nuk e fitojnë personalitetin juridik me regjistrim në gjykatë. Shoqëria e thjeshtë, sipas Kodit Civil, është një bashkim i vullneteve të dy ose më shumë personave me anë të një kontrate që synon zhvillimin e një veprimtarie ekonomike, me qëllim ndarjen e fitimeve. Anëtarët e shoqërisë së thjeshtë mund të venë në dispozicion të shoqërisë pasuri, të holla ose shërbime. Në këtë formë funksionojnë në Shqipëri studiot ligjore, klinikat mjekësore private etj, të ngjashme me to që ofrojnë shërbime të një lloji të veçantë. Në këto shoqëri taksat paguhen në mënyrë individuale nga subjektet që i kanë krijuar.

Shoqëritë e sigurimit dhe ato të specicionit mund të operojnë në Shqipëri pa qenë të detyruara të regjistrohen si subjekte tregtare, sepse janë të mbështetura në marrëdhëniet kontraktore.

Legjislacioni shqiptar parashikon si rregullohen këto shërbime:

³ Për hollësi, shih nenet 1074 deri 1112 të Kodit Civil, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar.

- Blerjet me qëllim rishitje, shitja që rrjedh nga një blerje e mëparshme, çdo veprim shkëmbimi.

- Çdo veprim i sipërmarrjes industriale, të ndërtimit, të minierave, të transportit, të sigurimeve, të magazinimit, të shfaqjeve publike, të reklamës, të botimit, të shtypshkrimit joartizanal.

- Çdo shërbim bankar dhe këmbimi.

- Çdo shërbim që lidhet me specicionin, ndërmjetësimin dhe përfaqësimin.

- Çdo shërbim që ka të bëjë me përpunimin, sipërmarrjen dhe shitjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

- Çdo shërbim artizanati i organizuar jo nga një person i vetëm⁴.

Ligji nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”.

Ky ligj plotëson një pjesë të rëndësishme të legjislationit tregtar, sepse përcakton procedurat për regjistrimin e personave juridikë e fizikë tregtarë me qëllim fitimin e personalitetit juridik, si dhe anën formale që ka të bëjë me dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim. Një vend të rëndësishëm zënë edhe mënyra e depozitimit të ndryshimeve në statut, pas regjistrimit fillestar të shoqërisë, roli i gjykatës në procesin e regjistrimit, ana teknike e mbajtjes së regjistrit në formë skedarësh. Ligji autorizon Këshillin e Ministrave që brenda datës 6 dhjetor të çdo viti të caktojë gazetën ose gazetën në të cilat lejohet publikimi i regjistrimeve që do të bëhen gjatë vitit të ardhshëm. Publikimi i të dhënave të Regjistrit Tregtar në Fletoren Zyrtare dhe në të paktën një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore, parashikohet edhe nga ligji i shoqërive tregtare, por faktikisht, kjo gjë nuk ka gjetur zbatim.

Regjistri Tregtar mbahet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqsor të Tiranës për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë⁵. Informacioni që

⁴ Për hollësi shih nenet 3-7 të ligjit 7632 “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar”.

⁵ Shih: nenin 1të ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”.

lidhet me shoqëritë tregtare është i kompjuterizuar, por që nga viti 2000 është pezulluar procesi i hedhjes së të dhënave në sistem, sepse programi është i vjetëruar dhe nuk i përgjigjet kapaciteteve. Deri në fillim të vitit 2005 rezultojnë rreth 40669 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe 627 shoqëri anonime, prej të cilave një numër i konsiderueshëm janë të huaja⁶. Po ashtu, ka mjaft degë dhe përfaqësi të shoqërive të huaja tregtare, ndërsa filialet janë më të pakta. Praktika na tregon se në Regjistrin Tregtar nuk ka subjekte të regjistruara në mënyrë të mirëfilltë si filiale, sepse edhe nga mënyra se si është përkufizuar kuptimi i tyre në ligj lë një shteg për vështirësi, por gjithsesi ekzistojnë filialet, të cilat evidentohen vetëm në rastin kur shoqëria “kryesore” që ka mbi 50 për qind të kapitalit shprehet në aktet e saj se cilat filiale ka.

Liria e vendosjes së shoqërive tregtare komunitare në Shqipëri dhe trajtimi jodiskriminues i shoqërive tregtare të huaja të vendosura në territorin e Republikës së Shqipërisë

Legjislacioni dhe praktika gjyqësore ofrojnë mundësinë për të ushtruar veprimtarinë tregtare dhe për t’u regjistruar si subjekt juridik në gjykatë në mënyrë jodiskriminuese si për shoqëritë komunitare, ashtu dhe për ato shqiptare.

Është evidentuar një trajtim i pabarabartë në lidhje me pagesën e diferencuar që duhet të kryejnë shoqëritë e huaja në Shqipëri për qëllim regjistrimi, në raport me ato shqiptare, praktikë e cila do të ndryshojë në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë:

- *Taksë e regjistrimit (1.500 Lekë për shoqëritë shqiptare dhe 4.500 Lekë për shoqëritë e huaja).*
- *Taksë noteri (25.000 Lekë për çdo dokument për shoqëritë shqiptare, ndërsa shoqëritë e huaja duhet të paguajnë edhe 10.000 Lekë plus).*

⁶ Nuk mund të nxirren dot statistika të sakta, madje as të përafërta, për shkak se Zyra e Regjistrimit Tregtar nuk ka një program të përshtatshëm kompjuterik për përpunimin e të dhënave ose qoftë edhe për kategorizimin e tyre në varësi të llojit të subjektit ose të llojit të veprimtarisë.

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar një numër marrëveshesh dypalëshe për shmangien e tatimeve të dyfishta mbi të ardhurat dhe kapitalet. Këto marrëveshje janë nënshkruar me Bullgarinë, Poloninë, Republikën Çeke, Norvegjinë, Belgjikën, Francën, Kroacinë, Turqinë, Zvicrën, Suedinë, Rusinë, Moldavinë, Rumaninë, Maltën, Italinë, Hungarinë, Greqinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Sistemi i taksimit vendas është i njëjtë si për shoqëritë e huaja, ashtu dhe për ato shqiptare. Në lidhje me dividendin që paguajnë shoqëritë e huaja tregtare, kuadri ligjor shqiptar përcakton pagimin e një takse prej 10 përqind, me përjashtim të rasteve kur ndërmjet Shqipërisë dhe vendit të origjinës së shoqërisë “mëmë” ekziston një marrëveshje për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe nëse në këtë marrëveshje përcaktohet një pagesë më e ulët për dividendin se ajo e përcaktuar në legjislacionin shqiptar.

Legjislacioni, që lidhet me marrëdhëniet e punës, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, parashikon rregulla që janë të njëjta si për subjektet shqiptare, ashtu edhe për ato të huaja, duke u krijuar mundësinë të huajve të punësuar në Shqipëri të zgjedhin sistemin e sigurimeve shoqërore të Shqipërisë ose atë të vendit të origjinës.

Ligji “Për të huajt” parashikon disa kushte lehtësuese për “Personelin Kyç” të shoqërive tregtare të huaja, duke përjashtuar nga detyrimet për t’u pajisur me leje pune:

- drejtorët ekzekutivë dhe punonjësit e rëndësishëm të shoqërive të huaja që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri ose që kanë qëllim të hapin veprimtari.
- punonjësit dhe profesionistët e tjerë të kompanive të huaja që vijnë për të punuar në degët dhe filialet e kësaj kompanie në Shqipëri.
- personelin e transportit ndërkufitar të mallrave dhe njerëzve.
- personat që bëjnë negociata për një shoqëri të huaj.
- personat që përfundojnë marrëveshje për një shoqëri të huaj.
- personat që punojnë në fushën e transportit, të instalimit të makinerive, të konstruksioneve, të riparim-shërbimit të makinerive, si dhe të trajnimit për përdorimin e tyre.

Seksionet tregtare janë në gjykatat më të rëndësishme, por aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit të Tiranës ka volumin më të madh të punës. Pranë kësaj gjykate funksionon një seksion tregtar me 8 gjyqtarë, si dhe Zyra e Regjistrimit që është e njësuar vetëm pranë kësaj gjykate. Ligji parashikon një afat kohor prej 30 ditësh nga marrja e kërkesës, brenda të cilit, Gjykata duhet të japë vendimin për regjistrimin e subjektit tregtar. Ky afat kohor është konsideruar i gjatë dhe në krahasim me praktikën e vendeve të tjera dhe, për këtë arsye, mendohet të reduktohet në 15 ditë. Megjithatë, nga praktika rezulton se këto afate janë më të shkurtra. Zakonisht gjykata shprehet me vendim për regjistrim jo më vonë se 10 ditë nga depozitimi i kërkesës, si për subjektet shqiptare, ashtu edhe për ato të huaja.

Legjislativi shqiptar parashikon se nëse për ushtrimin e disa shoqërive tregtare të caktuara kërkohet një *autorizim zyrtar*⁷, (licencë) me ligje të posaçme, atëherë kërkesa drejtuar gjykatës duhet të shoqërohet me një kopje të noterizuar të licencës. Për shembull, licencë duhet për krijimin e shoqërive të sigurimit, të shoqërive të ndërtimit⁸, atyre që ndjekin veprimtari në fushën farmaceutike, kimike, bankare etj. Kur subjekti tregtar është degë e një shoqërie të huaj, duhet të depozitohet edhe një kopje të licencës së marrë në shtetin ku ka selinë “mëma”.

Ligji për regjistrimin e shoqërive tregtar nuk ka penalitete ose gjopa për mospërbushjen e detyrimeve që lidhen me Regjistrin, ndërsa ligji për shoqëritë tregtare ka një seksion me penalitete, nga neni 295 – 301, që lidhen me deklarime të rreme lidhur me ndarjen e pjesëve të kapitalit themeltar, me shpërdorimin e kompetencave nga administratorët ose anëtarët e këshillit

⁷ Shih, nenin 19, paragrafi i pestë i ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

⁸ Shih, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 613, datë 13.12.1993 “Për ushtrimin e veprimtarisë në ndërtim dhe projektim të shoqërive », ku parashikohet se kur shoqëria është e huaj dhe ushtron veprimtari edhe në një vend të huaj, duhet të paraqesë licencën profesionale të ushtrimit të veprimtarisë në vendin e saj.

mbikqyrës, nga emisioni i parregullt i aksioneve, si dhe nga parregullsitë dhe paligjshmëritë që lidhen me funksionet e ekspertëve kontabël të autorizuar. Këto penalitete lëvizin nga 5000 deri në 200 000 lekë, ndërsa mosshënimi i të dhënave të detyrueshme në aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët penaliteti shkon deri në 250 000 lekë.

Decentralizimi i regjistrimit të shoqërive tregtare vetëm pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit të Tiranës ka krijuar probleme në praktikë, prandaj amendimet në ligjet tregtare do të parashikojnë procedura regjistrimi edhe pranë gjykatave të rretheve. Zbatimi i plotë i legjislacionit të ri tregtar dhe i sistemit përkatës të gjykimeve tregtare duhet të realizohet nëpërmjet ngritjes së infrastrukturës së nevojshme fizike dhe institucionale, si dhe të investimeve në drejtim të rritjes së kapaciteteve të këtij sistemi.

PËRFUNDIME

Në kuptim të reformës në legjislacionin tregtar, angazhimet që ka marrë Shqipëria në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit janë si në vijim:

- *Përmirësimi i klimës së biznesit dhe promovimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit për shoqëritë tregtare, me qëllim harmonizimin e tij me *acquis communautaire*⁹.*

Qëllimi i këtij objekti është krijimi i një mjedisi të përshtatshëm veprimi për shoqëritë tregtare dhe harmonizimi i ligjeve kombëtare me direktivat komunitare. Një harmonizim i tillë ka qëllim të dyfishtë: së pari, të heqë pengesat për lirinë e ngritjes së shoqërive, duke iu ofruar ndërmarrjeve mënyrat për të zgjeruar dhe përmirësuar konkurrencën e tregut; së dyti, të vendosë një shkallë të njëvlershme mbrojtjeje në gjithë bashkësinë, duke u

⁹ Shih: MSA (Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit), neni 70 paragrafi 3, në lidhje me fazën e parë të përcaktuar në nenin 6; Neni 49. PSA: Raporti i tretë vjetor për Procesin e Stabilizim-Asociimit në Shqipëri. Paragrafi 3.2: “Ekzistenca e ekonomisë së tregut të lirë dhe reformat strukturore”; Dokumenti i Partneritetit Europian: “Përmirësimi i mjedisit të biznesit”; Axhenda e Selanikut: paragrafi 4: “Promovimi i Zhvillimit Ekonomik”.

siguruar aksionerëve, kreditorëve dhe palëve të treta, që kanë marrëdhënie kontraktuale me shoqëritë, mbrojtje të interesave të tyre¹⁰.

- *Përmirësimi i legjislacionit me qëllim liberalizimin e vendosjes së shoqërive tregtare komunitare në Shqipëri dhe anasjelltas (neni 49 i MSA-së). Përcaktimi i një trajtimi për shoqëritë tregtare komunitare jo me pak të favorshëm sesa ai shoqërive tregtare shqiptare dhe anasjelltas në mënyrë të ndërsjellë (neni 50 paragrafi 1. dhe neni 51 paragrafi 1. i MSA-së).*

Reforma në legjislacionin tregtar synon që projektligjet t'u përgjigjen zhvillimeve të reja sociale dhe ekonomike të shtetit dhe shoqërisë shqiptare, duke u fokusuar në përmirësimin dhe plotësimin e legjislacionit tregtar aktual, duke rregulluar mangësitë e vërejtura në praktikën e deritanishme, duke harmonizuar dispozitat bazë tregtare me ato të legjislacionit civil në tërësi, si dhe duke realizuar një përafrim gradual me standartet europiane në mënyrë që përqsaja me 12 direktivat e BE-së (12 direktivat në lidhje me të drejtën e shoqërive tregtare) dhe përmbushja e detyrimeve që burojnë nga dokumentet politike: MSA, Axhenda e Selanikut dhe Dokumenti i Partneritetit të jetë sa më e kompletuar.

Drejtimet kryesore të përmirësimit të legjislacionit tregtar ekzistues duhet të konsistojnë kryesisht në¹¹:

- *përmirësimin e të drejtës së vendosjes të shoqërive tregtare të huaja në Shqipëri;*
- *trajtimin e barabartë të shoqërive të huaja me shoqëritë shqiptare;*
- *ndarjen e qartë të rasteve kur shoqëria duhet të falimentojë ose të likuidohet;*
- *përcaktimin e procedurave të formimit të shoqërisë së re në rastet*

¹⁰ Baza ligjore: neni 54 i Traktatit të BE-së.

¹¹ Për detaje të mëtejshme shih: "Partneri European: Plani i veprimtimit 2004-2007", pjesa "Përmirësimi i mjedisit të biznesit, përmirësimi i legjislacionit tregtar".

e ndarjes së shoqërive anonime, në ndarje me likuidim, me shkrirje ose përthithje;

- *përcaktimin e drejtë në ligj të masave të konvertimit të aksioneve të shoqërisë;*

- *përcaktimin e saktë të mënyrës, vendit, kushteve dhe procedurave të emëtimit të aksioneve;*

- *përcaktimin e procedurave të rivlerësimit të kapitalit, si dhe të modaliteve për rritjen progresive të vlerës minimum të kapitalit fillestar;*

- *përcaktimin e saktë procedural në lidhje me rritjen e vlerës nominale të aksioneve nëpërmjet kontributeve të një pjese të aksionereve, kur ata kontribuojnë për rritjen e veprimtarisë së shoqërisë dhe aksioneve;*

- *përcaktimin në procesin e likuidimit të ndarjes së përgjegjësisë dhe të detyrave të ekspertit të likuidimit dhe ekspertit që kontrollon procesin e likuidimit.*

Pronësia industriale dhe tregtare në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit

Elvis ÇIBUKU

1. PËRMBLEDHJE

Ky artikull analizon detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë dhe Bashkimit Europian dhe shteteve anëtare, nga ana tjetër. Duke interpretuar dispozitat përkatëse të MSA-së dhe angazhimet e Shqipërisë në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit dhe zbatimit të MSA-së, artikulli synon të identifikojë vështirësitë kryesore më të cilat pritet të përballet administrata shqiptare gjatë procesit të implementimit të Marrëveshjes.

Edhe pse legjislacioni i hartuar kohët e fundit në fushën e pronësisë industriale respekton në një shkallë të gjerë parimet e *acquis communautaire*¹ dhe ato të Marrëveshjes së TRIPS-it për garantimin e një niveli të njëjtë

¹ Sipas Glosarit të Bashkimit Europian, *acquis communautaire* përbledh traktatet themeluese dhe aktet e nxjerra nga institucionet komunitare (rregullore, direktiva dhe vendime), përfshirë këtu edhe vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Në një kuptim më të gjerë ai përbledh të gjitha rregullat e rendit juridik komunitar, përfshirë parimet themelore të së drejtës, të drejtën e rrjedhur nga marrëdhëniet e jashtme të bashkësisë si dhe dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet shteteve anëtare.

mbrojtjeje me Bashkimin Europian, administrata shqiptare duhet të përqendrojë përpjekjet e saj në forcimin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

Një kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet rritjes së vetëdijes së administratës publike dhe operatorëve privatë mbi rëndësinë e zbatimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale. Kjo lidhet ngushtë me studimin e këtyre të drejtave në universitete dhe analizimin e kostos dhe të efekteve të procesit të përafrimit të legjislacionit për ekonominë shqiptare.

Artikulli nuk ka për qëllim të trajtojë në hollësi modelet e pronësisë industriale në Shqipëri (si patentat ose markat tregtare) dhe as të studiojë efektet e MSA-së për secilin nga këto modele.

2. PRONËSIA INDUSTRIALE DHE TREGTARE² NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

“Pronësia industriale” është një kategori e pronësisë intelektuale që përfshin patentat, markat, dizenjot industriale, treguesit gjeografikë të produkteve dhe shërbimeve, si dhe dizenjot e qarqeve të integruara, të cilat sikurse sendet e prekshme mund të përbëjnë objekt pronësie.

Pronësia industriale në Shqipëri rregullohet nga ligji i amenduar nr. 7819, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale” dhe nga ligji nr. 8488, datë 13.5.1999 “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruar”. Përveç burimeve të brendshme, Shqipëria është anëtare e një numri konventash ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale, që datojnë në vitin 1992 me anëtarësimin në Organizatën Botërore të Pronësisë Industriale (WIPO) dhe vazhdojnë me Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale (1995), Marrëveshjen e Madridit për Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave (1995)

² Në terminologjinë financiare “pronësia tregtare” përkufizohet si pronësi që prodhon të ardhura, e destinuar për t'u përdorur nga industria ose nga biznesi, e dallueshme nga pronësia rezidenciale, e cila përdoret për banim. Edhe pse ky term nuk gjen përkufizim në *acquis* dhe as në terminologjinë juridike shqiptare, ai mund të konsiderohet si një alternativë e termit “pronësi industriale”.

dhe Protokollin përkatës (2003).

Që prej shtatorit 2000, kur Shqipëria u anëtarësua në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), parimet themelore të pronësisë industriale në Shqipëri bazohen në Marrëveshjen mbi Aspektet e të Drejtave të Pronësisë Industriale që lidhen me Tregtinë (TRIPS). Kjo marrëveshje ka vendosur standarde të reja për zhvillimin e pronësisë industriale në shtetet anëtare të OBT-së.

Përgjegjësia kryesore për zbatimin e legjislacionit në fushën e pronësisë industriale rëndon mbi Drejtorinë e Përgjithshme e Patentave dhe të Markave (DPPM). Duke qenë në varësi të Këshillit të Ministrave, pozicioni i saj ndryshon nga ai i institucioneve homologe në shtetet anëtare të BE-së, të cilat, duke pasur parasysh rëndësinë financiare të të drejtave të pronësisë industriale dhe rëndësinë e tyre për ekonominë kombëtare, kanë ngarkuar ministrinë e ekonomisë për mbikëqyrjen e autoriteteve përgjegjëse në këtë fushë.

Përveç DPPM-së, të drejtat e pronësisë industriale janë në kompetencë të organeve gjyqësore, veçanërisht Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës, e cila ka juridiksion ekskluziv për shqyrtimin e konflikteve në këtë fushë, dhe Administratës Doganore, e cila mund të urdhërojë konfiskimin e mallrave, të cilat dyshohen se cenojnë të drejtat e pronësisë industriale, duke garantuar mbrojtjen në kufi të këtyre të drejtave.

3. DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA MARRËVESHJA E STABILIZIM-ASOCIIMIT

Që prej 31 janarit të vitit 2003, Shqipëria është duke negociuar me Bashkimin Europian për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim -Asociimit. Negocimi i MSA-së është një proces sa politik aq edhe teknik, i cili ka për qëllim të afrojë vendin tonë me Bashkimin Europian, duke forcuar bashkëpunimin në fushat me interes të ndërsjellë³. Në këtë drejtim, Shqipëria

³ Raporti i Komisionit Europian “Mbi punën e Grupit të Lartë Drejtues BE-Shqipëri, në përgatitjen e negociimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Shqipërinë; fq. 26 (Bruksel, 6 Qershor 2001).

duhet të provojë jo vetëm se ndan të njëjtat vlera me BE-në, por edhe se disponon kapacitetet e nevojshme për zbatimin e detyrimeve të rëna dakord në Marrëveshje.

Garantimi i lëvizjes së lirë të mallrave është një ndër objektivat kryesorë të çdo marrëveshjeje asociimi të lidhur nga Komuniteti European me vendet e anëtarësuara rishtazi në BE dhe ato candidate. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit përcakton detyrimin e Shqipërisë për krijimin gradual të hapësirës së tregtisë së lirë me Bashkimin European, e cila nënkupton zhdukjen e të gjitha kufizimeve në lëvizjen e mallrave, të shërbimeve dhe kapitaleve, si dhe mbrojtjen e konkurrencës.

3.1. Përafrimi i legjislacionit

Në nenin 70 të MSA-së, Shqipëria është angazhuar që legjislacioni i saj ekzistues dhe ai i ardhshëm të jenë në përputhje me *acquis communautaire*, pa ndonjë detyrim për adoptimin “e plotë” të legjislacionit komunitar. Edhe pse çdo pjesë e këtij legjislacioni është në parim e rëndësishme dhe anëtarësimi në Bashkimin European mund të kryhet vetëm pas inkorporimit të plotë të tij në sistemin e brendshëm, për periudhën e asociimit përafrimi me disa prej fushave kryesore të *acquis-it* është i mjaftueshëm.

Në pamje të parë mund të duket se gjuha e nenit të mësipërm nuk është shumë e fortë dhe e detyron Shqipërinë vetëm të “përpiqet” të harmonizojë legjislacionin e saj me *acquis-in*. Megjithatë, në kuadër të hapësirës së tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, çdo dallim ndërmjet legjislacionit shqiptar dhe *acquis-it* në fushën e pronësisë industriale mund të bëhet shkak për mosfunksionimin e hapësirës së tregtisë së lirë.

Procesi i përafrimit të legjislacionit do të realizohet brenda dhjetë vjetësh nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes. Fushat përparësore në këtë proces do të jenë fushat e lidhura drejtpërsëdrejti me tregtinë dhe tregun e brendshëm, në të cilat bën pjesë edhe pronësia industriale dhe tregtare.

Në stadin aktual të marrëdhënieve me Bashkimin European, kur ende

nuk është nënshkruar Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, nuk ekziston asnjë detyrim ligjor për vendin tonë për përafrimin e legjislacionit vendas me *acquis-in*. Fillimi “i parakohshëm” i këtij procesi tregon vullnetin e Republikës së Shqipërisë për pranimin e standardeve të Europës së Bashkuar, duke përshpejtuar procesin e integritimit evropian.

3.2. Zbatimi i legjislacionit

Neni 73 i MSA-së thekson nevojën për mbrojtjen dhe shtrëngimin efektiv të të drejtave të pronësisë industriale, duke përcaktuar se *Shqipëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar, brenda 4 vjetësh nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, një nivel mbrojtjeje për të drejtat e pronësisë industriale të ngjashëm me atë të Komunitetit*. Zbatimi i legjislacionit përbën sfidën kryesore të vendit tonë edhe në këtë fushë. Shtrëngimi duhet të përmirësohet nëpërmjet plotësimit dhe mirëbashkërendimit të kuadrit ligjor, si dhe forcimin e kapaciteteve të organeve përgjegjëse në fushën e piraterisë dhe të falsifikimit⁴.

Mbrojtja e pronësisë industriale duhet t’i mundësojë krijuesit dhe shpikësit nxjerrjen e një përfitimi të ligjshëm nga veprimtaria e tyre intelektuale. Ndërtimi i një sistemi të detajuar dhe gjithëpërfshirës për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale nuk do të kishte asnjë kuptim nëse mbajtësve të këtyre të drejtave nuk do t’u jepej mundësia t’i shtrëngonin ato efektivisht. Këta të fundit duhet të jenë në gjendje të marrin masa ndaj shkelësve dhe të kompensohen për dëmet që mund t’u jenë shkaktuar. Mbajtësve të të drejtave duhet t’u jepet edhe mundësia për t’u kërkuar autoriteteve marrjen e masave kundër falsifikimeve⁵.

Zbatimi i të drejtave të pronësisë industriale përfshin mjetet e shtrëngimit penal dhe atij civil. Në varësi të rrethanave, mjetet shtrënguese mund të

⁴ Raporti i Stabilizim Asociimit 2004- COM(2004) 203; fq. 25

⁵ Libri i WIPO-s mbi Pronësinë Intelektuale; fq. 207

kenë karakter parandalues, të cilat kanë për qëllim parandalimin e shkeljeve të mëtejshme të të drejtave të pronësisë industriale; dhe korrigjues - siç mund të jetë detyrimi për tërheqjen e mallrave të falsifikuara nga kanalet e tregtisë ose për shkatërrimin e tyre⁶.

Procedurat e shtrëngimit duhet të jetë uniforme, të shpejta, dhe të mjaftueshme për parandalimin e veprimtarive kriminale⁷. Kjo ndoshta është pika ku Shqipëria ka për t'u ndeshur me vështirësitë më të mëdha gjatë procesit të përafritimit. Dobësitë e sistemit ligjor shqiptar janë ngadalshmëria, ineficenca dhe, për konfliktet e sofistikuara të pronësisë industriale, edukimi i pamjaftueshëm i sistemit gjyqësor. Numri i vogël i gjykatave kompetente për konfliktet e pronësisë industriale, numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve që trajtojnë këto çështje, pamjaftueshmëria e njohurive teknike dhe mungesa e transparencës në sistemin ligjor mund të bëhen pengesë serioze për zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si çdo marrëveshje ndërkombëtare, do të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga organet përgjegjëse të Shqipërisë dhe të gjitha shteteve anëtare të BE-së, proces ky që mund të zgjasë deri në dy vjet pas nënshkrimit. Për të përshpejtuar hyrjen në fuqi të dispozitave për tregtinë dhe çështjet që lidhen me të, Shqipëria dhe Komuniteti Europian do të nënshkruajnë një Marrëveshje Interim, e cila ka për qëllim të përparojë procesin e përafritimit të legjislacionit në disa fusha përparësore, përpara plotësimit të afatit dhjetëvjeçar⁸. Në këtë mënyrë, Shqipëria do të ketë mundësinë të adoptojë menjëherë disa pjesë të *acquis-it* dhe duke e lënë pjesën tjetër për në momentin e anëtarësimit në Bashkimin Europian.

⁶ Direktiva 2004/48/EC mbi shtrëngimin e të drejtave të pronësisë intelektuale

⁷ Shtrëngimi i të drejtave të pronësisë intelektuale dhe përmirësimi i kapaciteteve gjyqësore në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore. Përmbledhje rekomandimesh nga Qendra për Studimet Ndërkombëtare dhe Strategjike (Uashington); 24 Dhjetor 2004.

⁸ Neni 135 i MSA-së përcakton se data e hyrjes në fuqi e Marrëveshjes, në lidhje me nenin 73, nënkupton datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Interim.

3.3. Monitorimi

Procesi i përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së do të monitorohet nga Këshilli i Stabilizim-Asociimit⁹, i cili do të jetë përgjegjës edhe për zgjidhjen e problemeve që mund të lindin në këtë fushë. *Këshilli mund të detyrojë Shqipërinë të aderojë në konventat shumëpalëshe në fushën e pronësisë industriale*. Sipas mendimit tim, Shqipëria nuk mund ta kundërshtojë një vendim të tillë të Këshillit, situatë kjo e pazakontë në një marrëveshje ndërkombëtare, ku palët hyjnë lirisht dhe në kushte të barabarta.

Anëtarësimi në konventat ndërkombëtare në fushën e të drejtave të pronësisë industriale¹⁰ do të krijojë premisa për forcimin e mbrojtjes së këtyre të drejtave në Shqipëri, si dhe për uljen e kostos dhe të kohëzgjatjes së përfitimit të tyre. Megjithatë, duke qenë se kompanitë shqiptare përdorin vetëm një pjesë relativisht të vogël të buxhetit të tyre për kërkime dhe zhvillim, korporatat e huaja do të jenë në gjendje të nxjerrin përfitime më të mëdha nga një regjim i tillë.

4. MASAT E PARASHIKUARA PËR ZBATIMIN E MSA-SË

Më 13 maj 2005, Këshilli i Ministrave miratoi Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit dhe zbatimit të MSA-së, i cili përbën instrumentin kryesor për implementimin dhe monitorimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Stabilizim-Asociimit dhe siguron përputhshmërinë me programet e ndihmës komunitare.

Plani identifikon masat kryesore për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja dhe partneriteti evropian¹¹ për sektorin e pronësisë industriale,

⁹ Këshilli i Stabilizim-Asociimit parashikohet në Titullin X të MSA-së si një organ i përbërë nga përfaqësues të Këshillit të BE-së dhe Komisionit Evropian, nga njëra anë dhe përfaqësues të Qeverisë Shqiptare, në anën tjetër. Ai do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e implementimit të Marrëveshjes.

¹⁰ Të parashikuara nga Aneksi VII i MSA-së

¹¹ Vendimi i Këshillit të BE-së, 2004/519/EC, mbi parimet, përparësitë dhe kushtet e partneritetit evropian për Shqipërinë. Partneriteti evropian përcakton përparësitë afatshkurtra

si dhe mjetet financiare për realizimin e tyre. Megjithatë, vetëm adoptimi i *acquis communautaire* nuk mjafton për realizimin e hapësirës së tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian. Po aq e rëndësishme është ngritja dhe forcimi i strukturave përgjegjëse për implementimin e legjislacionit, detyrë e cila në praktikë rezulton më e vështirë për t'u realizuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave ka përgatitur projektligjin për pronësinë industriale, i cili është miratuar në Këshillin e Ministrave dhe aktualisht është duke u shqyrtuar në Kuvend. Duke qenë se projektligji është hartuar gjatë procesit të negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, në të janë pasqyruar pjesa më e madhe e parimeve të *acquis communautaire*. Prandaj mund të themi se Shqipëria shumë shpejt do të ketë një legjislacion modern të pronësisë industriale, të mbështetur në standardet ndërkombëtare. Megjithatë, kusht për ndërtimin e një sistemi eficient për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, i cili ende mungon në Shqipëri, është zbatimi efektiv i këtyre të drejtave.

5. VËSHTIRËSITË NË PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË MSA-SË

Vështirësitë me të cilat do të përballlet administrata shqiptare gjatë zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit kanë të bëjnë me mungesën e burimeve njerëzore të nevojshme për zbatimin e detyrimeve të saj në praktikë.

Një prej vështirësive të para është përkthimi në shqip i *acquis communautaire* në fushën e pronësisë industriale. Kjo nënkupton jo vetëm rregulloret, direktivat dhe vendimet, por edhe praktikën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Për përkthimin e *acquis communautaire* nevojitet bashkëpunimi i ekspertëve të familjarizuar me terminologjinë e veçantë të kësaj fushe, e cila është ende e panjohur në legjislacionin shqiptar. Një numër

(1-2 vjet) dhe afatmesme (3-4 vjet) në përgatitjen e Shqipërisë për integrim të mëtejshëm në Bashkimin Europian, siç identifikohen në Raportin Vjetor të Komisionit të vitit 2004

i tillë ekspertësh në Shqipëri, veçanërisht në administratën publike, është i pamjaftueshëm.

Një tjetër vështirësi ka të bëjë me njohjen e pamjaftueshme të tyre nga ana e bashkësisë të biznesit dhe organeve zbatuese, përfshirë edhe gjyqësorin¹².

Gjyqtarët që merren me çështjet e pronësisë industriale në Shqipëri janë vetëm profesionistë ligjorë, të cilëve iu mungojnë njohuritë nga mekanika, bioteknologjia, farmaceutika dhe fusha të tjera teknike, prandaj duket se do të duhen më shumë se katër vjet për të krijuar një brez gjyqtarësh të specializuar në çështjet e pronësisë industriale, të cilët do të jenë në gjendje të zgjidhin konfliktet në mënyrë të shpejtë dhe korrekte.

Nga ana tjetër, universitetet shqiptare nuk i kushtojnë aspak rëndësi studimit të drejtave të pronësisë industriale. Për vetë rëndësinë e këtyre të drejtave për funksionimin e tregut të brendshëm, mendoj se do të ishte me interes studimi i natyrës dhe i shtrirjes së tyre, procesi i fitimit dhe i regjistrimit, si dhe zbatimi dhe mbrojtja e tyre¹³. Numri i studentëve që mund të përfitojnë nga një edukim i tillë është i gjerë dhe përfshin degët e biznesit, të drejtësisë, inxhinierisë dhe shkencave të tjera të aplikuara.

Procesi mësimor duhet të organizohet në bashkëpunim me ekspertët e DPPM-së, profesionistët ligjorë dhe organizatat jofitimprurëse. Gjithashtu, kurse të veçanta për pronësinë industriale mund të organizohen në dobi të nëpunësve të administratës shtetërore, të bashkësisë së biznesit dhe të pjesëtarëve të publikut të interesuar për këtë fushë.

Universitetet duhet të japin ndihmë në trajnimin e ligjvënësve, të gjyqtarëve, administratorëve, praktikantëve ligjorë dhe profesorëve të ardhshëm të drejtave të pronësisë industriale. Puna e tyre duhet të përqendrohet në analizimin e sistemit të pronësisë industriale në Shqipëri dhe dhënien e

¹² Raporti i Stabilizim-Asociimit 2004- COM(2004) 203; fq. 25

¹³ Libri i WIPO-s mbi Pronësinë Intelektuale; fq. 422

sugjerimeve për përmirësimin e tij. Në këtë drejtim, universiteteve duhet t'u jepet e gjithë mbështetja e nevojshme njerëzore dhe financiare nga ana e administratës shtetërore.

6. PËRFUNDIME

Afati katërvjeçar i vendosur nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit për përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e pronësisë industriale me atë të BE-së është mjaft i shkurtër. Zbatimi i këtyre të drejtave brenda afatit të mësipërm duket pothuajse i pamundur, për sa kohë që administratorët e pronësisë industriale nuk kualifikohen me standardet europiane dhe ndërkombëtare të mbrojtjes dhe nuk ndryshojnë kurrikulat e universiteteve.

Inkorporimi i parimeve të reja juridike në këtë fushë dhe anëtarësimi i Shqipërisë në konventat ndërkombëtare sigurisht që do të sjellë efekte tepër pozitive për ekonominë shqiptare. Megjithatë, subjektet e huaja, të cilat investojnë më tepër për krijimin e të drejtave të pronësisë industriale, kanë për të nxjerrë përfitime më të mëdha.

Përafrimi me legjislacionin e Bashkimit European është një proces kompleks, i cili ka për qëllim integrimin e ekonomisë shqiptare në ekonominë e tregut të brendshëm të BE-së. Do të duhet kohë për forcimin e institucioneve përgjegjëse për implementimin e legjislacionit të ri në fushën e pronësisë industriale. Pjesë e këtij procesi janë edhe reformat e parashikuara për forcimin e pushtetit gjyqësor. Pa ndryshime të tilla institucionale, procesi i përafrimit të legjislacionit do të rezultonte në një adoptim formal të normativës komunitare, pa mundur të prodhojë efektet ekonomike dhe përfitimet e pritura nga Shqipëria.

BIBLIOGRAFIA

1. Libri i WIPO-s mbi Pronësinë Intelektuale.
2. Raporti i Komisionit Europian “Mbi punën e Grupit të Lartë Drejtues BE-Shqipëri, në përgatitjen e negociimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Shqipërinë”.
3. Projektmarrëveshja e Stabilizim-Asociimit midis Bashkimit Europian dhe Shqipërisë (3 Shkurt 2003).
4. Raporti i Stabilizim-Asociimit 2004- COM(2004).
5. Vendimi i Këshillit të BE-së, 2004/519/EC, mbi parimet, përparësitë dhe kushtet e partneritetit europian për Shqipërinë.
6. Plani Kombëtar i Përafimit të Legjislacionit vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.
7. Direktiva 2004/48/EC mbi shtrëngimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Disa rekomandime mbi hartimin e akteve normative me qëllim harmonizimin dhe unifikimin e legjislacionit

Rezana Balla
Sektori i Studimeve
Ministria e Drejtësisë

HYRJJE

Duke iu referuar përvojës, gjate dhënies se opinioneve ligjore për projektakte të ndryshme normative, në përputhje me legjislacionin aktual¹ dhe me synimin dhe qëllimin për të unifikuar dhe harmonizuar legjislacionin shqiptar dhe njëkohesisht për të mundësuar përmirësimin e procesit hartues, jemi perpjekur të përkufizojme disa sugjerime apo konstatime që do të ndihmojnë nga ana profesionale juristët që punojnë në institucionet e administratës publike dhe ushtrojnë nismën ligjvënëse.

Në këtë kuadër, vëzhgimi fokusohet mbi praktikën që i përket periudhës mbas hyrjes në fuqi të Kushtetutës² dhe paraqet konstatimet e specialistëve të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe sugjerimet e orientimet e nevojshme për të mundësuar unifikimin e praktikës hartuese për të gjitha subjektet e angazhuara në këtë veprimtari.

¹ Nenet 6 paragrafi 5 dhe 10 paragrafi 2, shkronja “d” të ligjit nr. 8678, datë 14. 05 2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, ligji nr. 9000, date 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 584 datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”.

² Kushtetuta e RSH, 1998

STRUKTURA E AKTIT NORMATIV

Në shumicën e projekteve që shqyrtohen vërehet një kuptim i padrejtë lidhur me strukturimin e përmbajtjes së aktit. Disa projekte paraqiten të ndara në pjesë, tituj e krerë, pa ndjekur ndonje radhë ose klasifikim të objektit të çdo ndarjeje. Të njëjtën gjë vërejmë edhe për njësitë e normave të emërtuara nene ose të numërtuara me pika. Për këtë nuk ka ndonjë rregull fiks, por bazuar në rregullat e teknikës legjislative³, ndarjet e mëdha shërbejnë për projekte, të cilët kanë numër të madh rregullimesh dhe gama e problemeve që përfshijnë e trajtojnë në objektin e tyre është e gjerë. Ndarjet më të vogla bëhen duke i grupuar dispozitat sipas afërsisë që ka objekti i tyre.

Shpesh ndodh që hartuesit nuk i numërtojnë paragrafet e neneve, por kjo konfondon zbatuesit, duke bërë të vështirë referimin. Gjithashtu, ndodh që hartuesit të jenë të pakujdesshëm. Për shembull, në një nen ata përdorin shifrat për të bërë emërtimin e paragrafeve dhe në një nen tjetër përdorin shkronjat. Bazuar në pikëpamjen e teknikës legjislative, emërtimet e paragrafëve ose të nënparagrafëve duhet të jenë të njëjta, duke ndjekur këtë logjikë. Për shembull: neni 1, pika 1, paragraf a), nënparagraf 1) etj.

Ndodh që shpesh titulli i aktit nuk është në koherencë me përmbajtjen e tij. Titulli duhet të shprehë me pak fjalë objektin e aktit normativ.

Përgatitja e projektakteve normative kërkon një strukturë të përgjithshme, e cila përgjithësisht dhe fatkeqësisht nuk ndiqet nga hartuesit. Kështu, projektakti ndër të tjera, duhet të përbëhet nga pjesa e përgjithshme, pjesa e krijimit të strukturave organizative që do të shërbejnë për rregullimin e çështjeve që synohet të trajtohen, kompetencat e tyre, sanksionet ku të përfshihet edhe mënyra e vjeljes dhe e shpërndarjes së të ardhurave, pjesa kalimtare ku të trajtohen dispozita kalimtare, shfuqizime dhe hyrja në fuqi.

³ Rregulla dhe rekomandime për hartimin e akteve normative; Sokol Berberi, Tirane 2004

REFERIMET

Nga pikëpamja e teknikës së hartimit të projektakteve normative, e konsiderojmë me rëndësi çështjen e dispozitave referuese që vihen re në projektet e akteve të çdo kategorie. Këto dispozita u referohen me numër datë e titull akteve konkrete, duke lënë të hapur mundësinë e një vakumi legjislativ në të ardhmen. Duke vepruar në këtë mënyrë, hartuesit nuk marrin në konsideratë dinamikën e legjislacionit tonë dhe e zgjidhin përkohësisht një çështje, duke ju referuar një akti në fuqi. Në çastin kur akti, të cilit i referohet projekti, do të shfuqizohet, projekti (i miratuar tashmë) do të ketë një normë referuese në një akt të shfuqizuar. Gjithsesi, mendojmë që këtu kemi të bëjmë me një problem, të cilin duhet ta marrë në konsideratë jurisprudenca shqiptare, në përputhje me rregullat e teknikës legjislative për referimet. Pasi edhe ne rastin kur referimet e projektakteve janë të natyrës së përgjithshme, duke përdorur fraza të ngjashme me shprehjen “...sipas legjislacionit në fuqi...”, verëjmë se përdorimi i rregullimeve të kësaj natyre i krijon mundësi referimit për t’u adoptuar me cilindo akt në fuqi që rregullon objektin e synuar nga norma referuese. Por në të njëjtën kohë vështirëson zbatuesin e ligjit që të referohet konkretisht, për të mundësuar zbatimin e frutshëm të ligjit.

Gjithashtu, ka raste që hartuesit përgatisin një projektakt me referime të njëpasnjëshme, të cilat e rëndojnë aktin dhe e bëjnë të vështirë për t’u kuptuar e veçanërisht për t’u zbatuar. Një nga rastet më tipike për këtë është projektligji i përgatitur nga Ministria e Bujqësisë, në vitin 2004, “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin,.... e qumështit”. Po ta shohim në tërësi, pothuajse në të gjithë projektligjin, në shumicën e neneve konstatojmë referime në ligjin nr.7941, datë 31.05.1995 “Për ushqimin”, dhe akte të tjera nënligjore. Në këtë rast, natyrshëm lind pyetja nëse duhet vërtet të hartojmë një ligj të ri apo thjesht të ndërmerren disa ndryshime në ligjin “Për ushqimin”, ndërkohë që edhe ky ligj po ndryshohej dhe ishte vetëm një projekt⁴. Nga pikëpamja e teknikës legjislative nuk mund të

⁴ Ishte përgatitur projekti për disa ndryshime në ligjin “Për ushqimin” dhe projektligji “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin,.... e qumështit”, i referohej ndryshimeve që nuk

hartohet një projektligj, për të plotësuar elementët e përcaktuar në një ligj tjetër, i cili ende është në fazën e projektimit dhe nuk ka marrë formën e ligjit.

NDRYSHIMET

Në disa raste kemi vënë re se i njëjti projekt parashikon ndryshime të disa akteve në fuqi. Jemi të mendimit se një qëndrim i tillë nuk është praktik për zbatuesit e tyre. Metodologjia dhe praktika e deritanishme mban qëndrimin që ndryshimet e një akti të caktuar të bëhen nga një projekt, i cili do të ketë për objekt vetëm këto ndryshime.

Në disa raste kemi vërejtur se titulli dhe pjesa hyrëse e projektit përmendin aktin bazë, si dhe të gjitha aktet që e kanë ndryshuar atë ose përmendin vetëm një akt ndryshues, të cilin parashikojnë ta ndryshojnë. Nga pikëpamja teknike një qëndrim i tillë e konsiderojmë të gabuar. Akti, të cilit duhet t'i referohet një ndryshim ose shfuqizim, është akti bazë. Të gjitha ndryshimet që i janë bërë atij, pavarësisht se janë bërë me akte me identitet të veçantë⁵, identifikohen me aktin bazë (aktin e ndryshuar). Akti ndryshues luan rolin e një instrumenti, i cili ka vlerë vetëm për t'i dhënë fuqi juridike ndryshimit ose shfuqizimit. Në çastin që akti ndryshues hyn në fuqi, përmbajtja e tij bëhet pjesë integrale e aktit të ndryshuar (aktit bazë) dhe identifikohet me numrin, datën dhe titullin e këtij të fundit.

PJESA HYRËSE

Nga pikëpamja formale është vënë re që në pjesën hyrëse të projektligjeve përcaktohen si dispozita kushtetuese të cilat parashikojnë kompetencën e Këshillit të Ministrave për të propozuar dhe të Kuvendit për të nxjerrë ligje nenet 78, 81 dhe 83/1. Duke konsideruar se këto dispozita nuk tregojnë në mënyrë eksplicite

ishin miratuar ende, pra nuk kishin marrë formën e ligjit.

⁵ Nga pikëpamja formale janë bërë me ligje të veçanta

kompetencën e Kuvendit për të nxjerrë ligje, në praktikën tonë, është gjetur si i përshtatshëm përcaktimi në pjesën hyrëse të projektligjeve i neneve 78/1, 81/1, 81/2, 83/1, 83/2, me përjashtim të rasteve të veçanta kur duhet të vendosen edhe nene të tjera të Kushtetutës (për shembull: neni 6, 84/4, 114, 120, 121, 123/2, 135, 147, 148, 150, 155, etj).

OBJEKTI OSE QËLLIMI

Një dukuri shumë e theksuar që kemi hasur gjatë praktikës së përditshme, në hartimin e projektligjeve është edhe përshkrimi i fushës së zbatimit të projektligjeve, duke përcaktuar veprimtaritë dhe jo subjektet që kryejnë këto veprimtari. Pavarësisht nga parimi klasik, se ligji është i zbatueshëm për të gjithë, projekti duhet të parashikojë në mënyrë të qartë subjektet mbi të cilat ai shtrin veprimtarinë e tij dhe gjeneron efekte juridike.

Për shembull: projektligji “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin, tregtimin e qumështit dhe produkteve me bazë qumështi”, në nenin 2 parashikon: “*Objekt i zbatimit të këtij ligji janë: fermat prodhuese, qendrat e grumbullimit, si dhe pajisjen e tyre me lejet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.*”

TERMINOLOGJI E UNIFIKUAR

Në tekstet e projekteve vërehet në përgjithësi mungesa e kujdesit për të përdorur terminologji të njëjtë në çdo normë. Ky qëndrim duhet të ndryshojë, sepse krijon situata paqartësie e keqinterpretimesh, që çojnë në zbatim të gabuar të aktit dhe në praktika të ndryshme zbatimi nga subjekte të ndryshme. Gjithashtu, përcaktimi i termave ose dhënia e përkufizimeve në një projekt lehtëson kuptimin dhe zbatimin e ligjeve, por ato duhet të jenë të qarta dhe të sakta. Nëse i referohemi praktikës, mund të sjellim disa shembuj të përcaktimit të termave. Kështu, për shembull në projektligjin e vitit 2004, “Për Inspektoriatin Shtetëror të Ndërtimit” shikoni përcaktimin e termit “punime ndërtimi”:

“*Punime ndërtimi*” – janë ato punime për ndërtimin e objekteve civile, industriale, bujqësore, të infrastrukturës dhe çdo objekt tjetër, që kanë të

bëjnë me plotësimin e kërkesave themelore. Ky term në përkufizimin që synohet t'i jepet nga hartuesit është i paqartë dhe i pasaktë, fjalët “me plotësimin e kërkesave themelore” e konfundojnë kuptimin e termit.

Një shembull tjetër nga projektligji i vitit 2003, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor shqiptar”, “*Qeverisja e Pyjeve*” - *nënkupton tërësinë e ligjësisë dhe biologjinë e bashkësisë së jetës së pyllit e tokës pyjore, përcaktim të qartë të politikave e masave që duhet të ndërhyhet në strukturën funksionale të tyre për të garantuar efektivitetin më të lartë tekniko-ekonomik.*

Në këto përkufizime dallojmë përdorimin e termave që nuk kuptohen dhe e bëjnë të paqartë përkufizimin. Nga pikëpamja e teknikës legjislativë në tekstet e akteve normative duhet të shmangim përdorimin e termave të paqarta ose të pasakta.

PËRMBAJTJA

Permbajtja e projektakteve normative duhet të jetë e qartë dhe t'i përmbahet strukturës së përgjithshme të akteve normative. Shpeshherë ndodh që hartuesit nuk vëzhgojnë qartësisht në legjislacionin aktual dhe synojnë të krijojnë projekte të reja, pa pasur parasysh që tematika, e cila synohet të trajtohet aktualisht, është e rregulluar. Projektligji i vitit 2004, “*Për Entin Kombëtar të Turizmit*” përbën një shembull, ku specialistët nuk kanë bërë vëzhgimin e hollësishëm të rregullimit aktual të çështjeve. Pra, çështjet që ata synojnë të rregullojnë nëpërmjet projektit janë tashmë të rregulluara.

Kjo përbën detyrën kryesore të specialistëve të Ministrisë së Drejtësisë, që, në përputhje me kompetencën e përcaktuar në ligj, të realizojë harmonizimin dhe unifikimin e legjislacionit.

KARAKTERI NORMATIV

Një dukuri që vihet re shpesh është edhe pajisja e projektakteve me dispozita të karakterit deklarativ, duke i hequr normës juridike thelbin e saj, pra, karakterin rregullues dhe normues të një norme juridike. Jemi të mendimit që në projekte

aktesh normative të reduktohen sa më shumë që të jetë e mundur përmbajtja e dispozitave me karakter deklarativ. Për shembull: në projektligjin e vitit 2004, “Për ripërtëritjen urbane dhe mirëmbajtjen e banesave”, konstatojmë se megjithëse, në tërësi, projekti shfaq elementët e një norme juridike, duke u ndarë në nene të veçanta në përmbajtje ky projekt përbën më shumë dhe paraqitet me dispozita të karakterit deklarativ dhe në konturet e një strategjie, lidhur me politikat e përmirësimit të zonave urbane.

Po kështu, mund të japim një shembull të një dispozite me karakter deklarativ: neni 2 i projektligjit “Për Inspektoriatin Shtetëror të Ndërtimit” përcakton: *“Këshilli i Ministrave zhvillon politika dhe merr masat e nevojshme që sigurojnë zbatimin e legjislacionit të ndërtimit në punimet e produktet e ndërtimit.”* Në këtë dispozitë nuk përcaktohen çështje konkrete që do të rregullohen nga Këshilli i Ministrave. Aktet normative krijohen për të rregulluar fusha të caktuara veprimtarish dhe njëkohësisht marrëdhënie të caktuara juridike. Pra, qëndrimi ynë në këtë rast është shmangia e dispozitave me karakter deklarativ.

GJUHA NORMATIVE

Përgatitja e projektakteve kërkon kujdes dhe vëmendje të madhe nga ana e hartuesit, lidhur me trajtimin e çështjeve në mënyrë të thjeshtë e koncize. Për këtë kërkohet të zgjidhen fjalë të thjeshta, në gjuhën shqipe⁶ dhe në numrin njëjës. Të ndërtohen fjali sa më të shkurtra, të qarta dhe me foljet në kohën e tashme dhe në mënyrën dëftore, si dhe të shmangen periudhat me fjali bashkërenditëse ose nënrenditëse. Gjithashtu, fjalitë nuk duhet të jenë evazive, të mos krijojnë situata të diskutueshme e me kuptim të dyzuar. Njëkohësisht, aktet normative duhet të shmangin referimet, sa më shumë të jetë e mundur.

⁶ Shpeshherë konstatojmë se në akte normative përdoren fjalë të huaja.

DISPOZITA KALIMTARE

Shpesh ndodh që hartuesit nuk parashikojnë dispozita kalimtare, duke sjellë kështu vështirësi në zbatimin e aktit dhe, njëkohësisht, duke krijuar probleme te vërteta serioze. Bazuar në jurisprudencë, dispozitat kalimtare krijohen për të rregulluar një marrëdhënie të përcaktuar dhe për një afat të përcaktuar kohor, që është më i shkurtër se shtrirja kohore e ligjit ose aktit normativ në tërësi. Lidhur me dispozitat kalimtare, po ju sjellim një shembull: Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit harton ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”. Në këtë ligj të ri, ato përcaktojnë një dispozitë që shfyqizon ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, pasi ai ishte vjetëruar, nuk përmbushte objektivat dhe synimet e tyre dhe menduan të hartojnë një ligj të ri gjithëpërfshirës. Njëkohësisht, në këtë ligj të ri, hartuesit nuk parashikojnë dispozita kalimtare. Por, nuk marrin parasysh që marrëdhënia e krijuar nëpërmjet këtij ligji nr. 8030, datë 15.11.1995, pra, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave dhe qytetarëve të strehuar në banesat e ndërtuara prej tij, nuk kishte përfunduar. Familjarët nuk kishin shlyer ende kontratat e shitblerjeve. Pra, hartuesit e ligjit, bazuar në pikëpamjen e teknikës legjislative, duhet të mbanin parasysh dhe të mos anashkalonin rëndësinë e parashikimit të një dispozite kalimtare, duke përcaktuar një afat të shkurtër kohor për rregullimin e këtyre marrëdhënieve. Më vonë hartuesve iu desh të ndërmerrnin nismen për të bërë ndryshime në ligjin e ri për të parashikuar dispozitat kalimtare. Një shembull i një dispozite kalimtare është përcaktimi *’Të gjithë prodhuesit të pajisjen me leje brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji’*⁷.

⁷ Shembujt më të mirë të dispozitave me karakter kalimtar janë në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Në këtë ligj janë përcaktuar afatet kohore të kalimit të pushteteve, pra, procesi i decentralizimit.

SHFUQIZIMI

Çështje e cila mendojmë se duhet të merret në konsideratë, është parashikimi, në dispozitat e fundit të projekteve, i shprehjes së përgjithshme për shfuqizimin e të gjitha akteve që vijnë në kundërshtim me përmbajtjen e projektit. Në këtë rast lindin 2 probleme:

- Duke mos qenë të percaktuara konkretisht, aktet ose rregullimet që shfuqizohen, zbatuesit vazhdojnë t'i zbatojnë ende.

- Në disa raste shfuqizimi u drejtohet edhe akteve normative që, për nga mënyra e miratimit dhe fuqia janë të një hierarkie më të lartë (një projektligj i miratuar me shumicë të thjeshtë shfuqizon dispozitat e një ligji të miratuar me tre të pestat, pra me shumicë të cilësuar⁸).

Duke marrë në konsideratë këto probleme, hartuesit e projekteve duhet të mos e përdorin shprehjen e përgjithshme dhe të përcaktojnë me saktë si cilat akte dhe cilat dispozita do të shfuqizojë projekti.

HYRJA NË FUQI

Në praktikën e përditshme, jo rrallë ndeshemi edhe me raste kur një akt nënligjor i karakterit normativ parashikon hyrjen e tij të menjëhershme në fuqi. Në këtë rast gjendemi përpara papajtueshmërisë së parashikimit të aktit me kërkuesat e nenit 117 të Kushtetutës, kjo për shkak të paqartësisë që kanë hartuesit lidhur me dallimin ndërmjet akteve normative. Në përgjithësi që ndërrimi i jurisprudencës është i qartë. Aktet normative kanë karakter rregullator të përgjithshëm dhe përgjithësisht i shtrijnë efektet për një kohë të gjatë. Ato ndahen në akte të përgjithshme dhe në akte individuale, pra, që i drejtohen një personi të vetëm (të nominuar)⁹.

Çështja e hyrjes në fuqi të akteve normative është e lidhur edhe me botimin e tyre në Fletoren Zyrtare. Në këto raste hartuesit duhet të jenë të qartë për

⁸ Neni 81, pika 2 e Kushtetutës

⁹ Megjithëse qëndrimi i jurisprudencës është i qartë, ka diskutime për këtë dallim.

natyrën e aktit dhe duhet t'u përmbahen kërkesave të nenit 117 të Kushtetutës. Vetë projekti duhet të parashikojë hyrjen e tij në fuqi, pas botimit në Fletoren Zyrtare ose në një datë të mëvonshme.

RELACIONI SHPJEGUES

Në praktikë ndodh shpesh që projektaktet shoqërohen me relacione, por ato nuk japin informacionin që u duhet specialistëve të Ministrisë së Drejtësisë, për të gjykuar dhe mundësuar dhënien e një opinioni ligjor të duhur dhe profesional, për realizimin e unifikimit dhe të harmonizimit të legjislacionit në tërësi.

Nisur nga parimet e përgjithshme të teknikës legjislative, por edhe nga ato të përcaktuara tashmë nga legjislacioni aktual¹⁰, të gjitha projektet e akteve normative duhet të shoqërohen me një relacion të hollësishëm me shpjegimet e nevojshme lidhur me arsyet kryesore për propozimin e projektaktit, çështjet më të rëndësishme që parashikohen të rregullohen prej tij, përputhshmërinë me programin politik të Këshillit të Ministrave, me programet kombëtare ose sektorale të zhvillimit të vendit. Relacioni shpjegues duhet të përmbajë ndër të tjera edhe: argumentimin e propozimit të projektaktit, duke bërë analizën lidhur me përparësitë dhe problemet e mundshme në zbatimin e projektaktit, nivelin e efektivitetit, të zbatueshmerisë, efikasitetit, impaktit dhe efekteve përkatëse, si dhe të kostos ekonomike që rezulton në raport me legjislacionin në fuqi, vlerësimin eventual për projektaktet normative, të shkallës së përafrimit të përmbajtjes së tyre me legjislacionin komunitar (acquis communautaire), raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, ndikimin e tyre në buxhet etj.

AKTET NËNLIGJORE

Një çështje e rëndësishme për t'u trajtuar mendojmë se është përgatitja e

¹⁰ Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584 date 28.8.2003 "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave"

projektakteve të karakterit nënligjor, duke patur si bazë një nga dispozitat e fundit të ligjeve të miratuara para hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, në mënyrë të përgjithshme parashikohet nxjerrja e akteve nënligjore për të gjitha çështjet që i përkasin objektit të ligjit, ose jo. Nën këndvështrimin e parashikimeve të nenit 118 të Kushtetutës, nxjerrja e akteve nënligjore, me këtë bazë ligjore, është e diskutueshme, pra, natyrshëm lind pyetja, nëse ligjvënësi ka parashikuar që të bëjë edhe rregullimin e një çështjeje të caktuar me akt nënligjor. Vërejmë se rast pas rasti këto dispozita të përgjithshme deleguese mund të mos respektojnë raportin normal kushtetues ndërmjet çështjeve që duhet të parashikojë ligji dhe atyre që mund të kërkojnë aktet nënligjore normative të nxjerra në zbatim të tyre. Në përputhje me paragrafin 2 të nenit 118 të Kushtetutës, akti nënligjor duhet të nxirret në bazë e për zbatim të një ligji dhe duhet që vetë ligji të përmbushë këto kërkesa:

- të parashikojë nxjerrjen e aktit nënligjor;
- të përcaktojë organin kompetent;
- të përcaktojë çështjen që synohet të rregullohet;
- të përcaktojë parimet që duhen respektuar për nxjerrjen e aktit nënligjor.

Nisur nga praktika e deritanishme, hartuesit përpiquen t'i përmbahen këtij rregulli të ri të përcaktuar nga Kushtetuta, por shpeshherë nuk i gjejmë të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 118/2 të Kushtetutës. Nëse do të bënim një interpretim të këtij paragrafi, do të kuptojmë që kushti i plotësimit të tij është që të parashikohen, pra të përmbushen, të gjitha kërkesat që përcaktohen dhe jo vetëm disa prej tyre. Kështu ndodh që hartuesit në projektet e tyre parashikojnë llojin e aktit dhe organin që do ta nxjerrë atë, duke lënë pa përcaktuar çështjet që synohen të rregullohen dhe parimet që duhen respektuar në nxjerrjen e aktit nënligjor. Për shembull: në nenin 3 të projektligjit "Për Inspektoriatin Shtetëror të Ndërtimit" pika 2 e tij përcakton: *2. Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit nxjerr udhëzime.*

Duke analizuar këtë dispozitë konstatojmë se në të përcaktohet organi kompetent, që në këtë rast është ministri dhe lloji i aktit nënligjor, që do të nxirret,

që është udhëzim. Por çfarë ka ndodhur? Nuk është përcaktuar çështja që do të rregullohet dhe parimet në bazë të të cilave do të nxirret akti nënligjor. Formulimi i dispozitave të tilla është i dëmshëm, pasi jo vetëm zbatuesit do të kenë vështirësi, por edhe hartuesit e aktit nënligjor nuk do të kenë të qarta çështjet që do të rregullohen. Përcaktimi i dispozitave të tilla është shumë i hapur, duke lënë shteg për të trajtuar çfarëdo çështjeje që mund t'i interesojnë kësaj ministrie, për më tepër vjen ndesh me nenin 118/2 të Kushtetutës, pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në të.

Duke iu referuar kërkesave të mësipërme, si dhe gjendjes aktuale të legjislacionit në fuqi të miratuar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, vërejmë se aktet nënligjore jo në çdo rast justifikojnë nxjerrjen e tyre në bazë e për zbatim të dispozitave të përgjithshme. Në kushtet kur strukturat e ekzekutivit duhet të operojnë në veprimtarinë e përditshme, nxjerrja e akteve nënligjore është një domosdoshmëri dhe nevojë imediate, por ato mund të gjenden përballë një pamundësie reale juridike.

Me qëllim përqaqjen e legjislacionit me Kushtetutën dhe zhdukjen e tejkalimeve në kompetencën dhe fushën e rregullimit nënligjor të marrëdhënies juridike, sugjerojmë trajtimin me përparësi dhe intensifikimin e veprimtarisë së institucioneve të interesuara, për të përgatitur projektamendamentet e nevojshme për të gjitha ligjet që rregullojnë fushën e veprimtarisë nën kompetencën e tyre, me objekt parashikimin e dispozitave që përcaktojnë rast pas rasti nxjerrjen e akteve nënligjore, organin kushtetues kompetent, çështjen që do të rregullojë si dhe parimet bazë për rregullimin e çështjeve, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në nenin 118/2 të Kushtetutës.

Në praktikën e përditshme ndeshemi me raste kur në ligje ose në projektligje parashikohet nxjerrja e akteve nënligjore nga organe, të cilat nuk janë kushtetuese ose e thënë ndryshe nuk janë të parashikuara në mënyrë specifike në Kushtetutë. Në këto raste nxjerrja e aktit vjen në kundërshtim me parashikimin e paragrafit të parë të nenit 118 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, kompetencën e nxjerrjes së akteve normative e kanë vetëm organet e parashikuara në Kushtetutë e, si të

tillë, mund të jenë Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Këshilli i Ministrave, Kryeministri, ministrat, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, organet e pushtetit vendor, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Këshilli ose Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe të tjera organe të institucioneve të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë.

Kjo kërkesë e Kushtetutës duhet të mbahet parasysht në të gjitha rastet kur përgatiten projektligjet e institucioneve dhe të organeve të parashikuara në Kushtetutë, pavarësisht se janë institucione që e shtrijnë juridiksionin në të gjithë territorin e vendit, pra, janë institucione qendrore. Si të tilla po përmendim Arkivin Qendror të Shtetit, Agjensinë e Prokurimeve Publike, Avokaturën e Shtetit, Agjensinë e Trajtimit të Kredive dhe të tjera institucione ose organe të kësaj natyre.

Në disa raste, paraqitja e projektakteve bëhet me propozim të institucionit për shembull, të ministrit, duke mos pasur parasysht kërkesat kushtetuese¹¹.

Një dukuri tjetër që ndeshet në praktikën e hartimit të projektakteve nënligjore është parashikimi i delegimit nga ana e organit, të cilin ligji e ka autorizuar për nxjerrjen e aktit të kompetencës së rregullimit të çështjes nga organet vartëse të tij. Ky delegim i kompetencës vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 118, paragrafi 3 të Kushtetutës. Kjo dispozitë e ndalon në menyrë taksative të drejtën e delegimit të kompetencës së nxjerrjes të akteve nënligjore. Ndalimi i delegimit është i qartë dhe nuk lë vend për të menduar se ka mundësi të bëhen delegime të pjesshme, sic ndodh në praktikë. Për shembull: në projektvendimin “Për kriteret e rimbursimit të barnave të ushtarakëve të Forcave të Armatosura“, në pikën 8 të tij parashikohet:

“8. Kriteret për masën e rimbursimit të barnave mjekësore për ushtarakët e Forcave të Armatosura përcaktohen nga Ministri i Mbrojtjes”.

Në këtë rast kemi të bëjmë me një delegim të kompetencës, pra organi i autorizuar me ligj, në rastin tonë Këshilli i Ministrave, për të përcaktuar kriteret

¹¹ Neni 100 pika 2 i Kushtetutës

e rimbursimit të barnave ia delegon kompetencën Ministrin të Mbrojtjes. Por ligji për përcaktimin e këtyre kriterëve ka autorizuar Këshillin e Ministrave dhe jo Ministrin e Mbrojtjes.

Qëndrimi ynë dhe i gjithë praktikës për këtë pikë duhet të jetë i njëjtë dhe unik. Organi, që me ligj është i autorizuar të nxjerrë një akt nënligjor duhet që t'i trajtojë të gjitha çështjet e përcaktuara me ligj në përmbajtjen e aktit. Nuk duhet të lejohet hapësira për trajtime të pjesshme e më të hollësishme të çështjeve nga organet vartëse, qofshin edhe organe këto të parashikuara nga Kushtetuta.

Në disa raste, hartuesit e akteve nënligjore përgatisin projekte të cilat dalin në bazë e për zbatim të një akti tjetër nënligjor. Ky qëndrim vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 118 të Kushtetutës, paragrafi i parë, sipas të cilit aktet nënligjore nxirren në bazë e për zbatim të ligjeve.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme është tejkalimi i objektit të projektit të akteve nënligjore. Në disa projekte hartuesit parashikojnë dispozita të cilat i kapercenë kufijtë e autorizimit që parashikon ligji, duke e zgjeruar trajtimin e çështjeve për të cilat ato autorizohen nga ligji. Në këto raste, hartuesit nuk kanë marrë në konsideratë kërkesat e nenit 118 të Kushtetutës, i cili kërkon që akti nënligjor të nxirret për çështjen që ka përcaktuar ligji. Kjo kërkesë duhet të mbahet në konsideratë dhe të verifikohet me kujdes në çdo fazë të përgatitjes së projektit.

Projektet nuk mund të mbështeten në akte normative që nuk kanë fuqi juridike, kështu, duam të theksojmë se një numër i konsiderueshëm projektesh i referohen si bazë ligjore vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 424, datë 9.07.1998 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, ndërkohë që ky vendim mbështetet në ligjin nr 8283, datë 3.2.1998 “Për buxhetin e shtetit të vitit 1998” dhe ka prodhuar efekte juridike vetëm për vitin buxhetor 1998. Por ministrinë dhe institucionet e tjera vazhdojnë të shpermdajnë të ardhurat e tyre, duke nxjerrë akte në zbatim të këtij vendimi, i cili nuk ka më fuqi juridike. Nëse i referohemi jurisprudencës, aktet juridike humbasin fuqinë e tyre me një akt tjetër që përcakton shfuqizimin ose vetvetiu, kur konstatohet se marrëdhënia juridike, të cilën ai ka rregulluar ose çështjet që ka trajtuar kanë pushuar, atëherë ai nuk ka më fuqi juridike. Në këtë rast, ligji nr

8283, datë 3.2.1998 është hartuar për të menaxhuar fondet buxhetore të vitit 1998, pra me mbarimin e vitit mbarojnë edhe efektet juridike të këtij akti. Pra, bashkë me të mbarojnë edhe efektet juridike të një akti nënligjor. Për këto arsye, aktet që kanë këtë status nuk mund të shërbejnë si mbështetje ligjore për akte të tjera.

Dispozitat e projektit në asnjë rast nuk duhet të përmbajnë përsëritje të parashikimeve të dispozitave të aktit në bazë e për zbatim të të cilit del ose edhe të akteve të tjera të së njëjtës kategori. Kjo përsëritje nuk do të kishte asnjë dobi për qëllimin për të cilin del akti dhe në të njëjtën kohë do të ngarkonte tekstin e tij me rregullime të përsëritura. Duhet të mbahet parasysh se synimi i nxjerrjes së një akti është të normojë e të disiplinonjë një çështje, e cila është e parregulluar ose është rregulluar në mënyrë të paplotë.

Vëmendje duhet t'i kushtohet përgatitjes së akteve që parashikojnë detyrime financiare të natyrës fiskale ose jo. Në disa raste projektvendimet e dërguara nga ministritë e ndryshme kanë parashikuar gjoha ose detyrime financiare në përmbajtjen e tyre, pavarësisht nga kërkesat e ligjit në bazë e për zbatim të të cilit parashikohet dalja e tyre dhe pavarësisht nga kërkesat e nenit 155 të Kushtetutës. Pra, në një akt nënligjor si vendimi i Këshillit të Ministrave nuk mund të parashikohen sanksione, ato duhet të përcaktohen vetëm me ligj. Një element i rëndësishëm që duhet të mbahet në konsideratë është shqyrtimi dhe evidentimi i kostos financiare që do të ketë implementimi i projektit pas miratimit. Kjo gjë rezulton të bëhet formalisht dhe në disa raste nuk bëhet fare. Lidhur me këtë element duhet të mbahet parasysh bërja e një analize të detajuar dhe të pasqyrohet në çdo rast në relacionin që duhet të shoqërojë projektin.

Një dukuri tjetër me të cilën strukturat e Ministrisë së Drejtësisë përballen shpesh që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës është përdorimi jo vetëm në marrëveshjet ndërkombëtare, por edhe në ato konçensionare i fjalës “qeveri” në vend të “Këshilli i Ministrave”¹².

Nisur nga cilësia e projektakteve, kemi konstatuar se një pjesë e madhe e

¹² Kushtetuta parashikon vetëm termin “Këshilli i Ministrave”.

tyre nuk i nënshtrohen kontrollit të kualifikuar e përfundimtar të specialistëve juristë të sektorëve ose të drejtorive të ministrive propozuese. Mendojmë se kjo është një arsye kryesore pse strukturat dhe specialistët e Ministrisë së Drejtësisë vërejnë mangësi në përmbajtjen e projekteve. Në vijim do të konsideronim si të një rëndësie të veçantë kontrollin përfundimtar të një akti nga specialistët juristë nëpër institucionet që përgatisin projektakte normative, në funksion jo vetëm të rritjes së cilësisë së këtyre projekteve, por edhe një përmbushje të obligimit ligjor të vendosur në ligjin nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Ky detyrim do të ndikonte padyshim edhe në cilësinë e normave juridike në harmoni me parimet e përgjithshme të teknikës legjislativë.

BIBLIOGRAFIA:

- “ Kushtetuta e RSH-së 1998
- “ Kodi i Procedurës Administrative
- “ Ligji nr. 8678, date 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”
- “ Ligjit nr. 9000, date 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”
- “ Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584 date 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”
- “ Rregulla dhe rekomandime për hartimin e akteve normative; Sokol Berberi, Tiranë 2004.

Ndikimi i Acquis Communautaire në efektshmërinë e ligjit në Europën Qendrore dhe Lindore

Matin Bruncko,
Harvard University,
J.F. Kennedy School of Government
Slovakia

HYRJJE

Në 1 Maj 2004 tetë vende të Europës Qendrore dhe Lindore (EQL) priten t'i bashkohen Bashkimit Europian (BE) pasuar edhe nga dy vende të tjera. Procesi i anëtarësimit në Bashkimin Europian (BE) ka shkaktuar jehonë të madhe në ndryshimet e tyre politike dhe ekonomike qysh prej rënies së regjimit komunist. Para se ato t'i bashkohen zyrtarisht Bashkimit Europian duhet të demonstrojnë dëshirën e tyre dhe aftësinë për të pranuar detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në BE. Më qartë, kjo do të thotë që ata duhet të zbatojnë plotësisht paketën ligjore të BE dhe të zbatojnë, *acquis communautaire*. Terësia dhe shpejtësia e proceseve ka rritur numrin e çështjeve të shtruara mbi efikasitetin e institucioneve ligjore që do të rezultojnë prej tyre. A mundet që një sistem i ndërthurur rregullimesh ligjore, të cilave i janë dashur dekada të tëra ngritjeje në vendet e zhvilluara europiane të mund të transpozohet siç duhet në vendet më pak të zhvilluara ekonomikisht dhe ato në tranzicion? A do të jenë vendet e anëtarësuara në gjendje t'i vënë ato në zbatim në një të ardhme të afërt? Si do të ndikojë ai në funksionimin

e institucioneve tyre ligjore? Dhe më tej akoma, a mundet që zbatimi i ligjeve të BE në këtë kontekst të ndihmojë dhe nxisë zhvillimin e ekonomisë të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore.

Ky shkrim ka për qëllim t'i përgjigjet këtyre pyetjeve duke ekzaminuar argumente përkatës teorike dhe eksperiencën konkrete gjithashtu. Është i ndarë në katër pjesë kryesore. Në pjesën e parë ne paraqesim një përmbledhje të shkurtër të mendimit aktual teorik mbi rëndësinë e institucioneve ligjore në rritjen ekonomike. Do të paraqesim, gjithashtu, disa probleme të përmendura shpesh në zbatimin e ligjeve me origjina të huaja. Seksioni tjetër prezanton kuadrin ligjor kryesor të BE-së dhe kontekstin gjatë së cilit ai është transpozuar në vendet anëtare. Seksioni i tretë analizon pranueshmërinë e një mjedisi të ri në ligjin e BE-së dhe aftësinë e vendeve anëtare për të adaptuar efektivisht atë në situatat e tyre të veçanta. Në seksionin e fundit do të merremi me efektshmërinë e të zbatuarit dhe e të respektuarit.

Do të tregojmë që tetë vendet kandidatë më pranë BE-së kanë bërë progres të madh në transpozimin e *acquis communautaire* në kuadret e tyre ligjore aktuale. Të dhënat bëjnë të ditur, gjithashtu, se situata mund të jetë shumë pranuese ndaj ligjeve të reja. Megjithatë, vendet përballen me sfida mjaft të forta në sigurimin e respektimit dhe zbatimit të tyre sa më efektiv.

1. RËNDËSIA E INSTITUCIONEVE LIGJORE DHE PROBLEMET NË ZBATIMIN E LIGJEVE TË HUAJA

Ndikimi i institucioneve ligjore në zhvillimin ekonomik është debatuar gjerësisht në literaturën akademike. Nga ana tjetër, duket shumë e gjetur që pasja e ligjeve të mira dhe mirëfunksionimi i sistemit gjyqësor që mund të çojë në respektimin eficient të tyre, mund të nxisin aktivitete ekonomike në një mjedis të avancuar kapitalist. Historianët e ekonomisë si Landes (1998) kanë argumentuar se në ato shoqëri që kanë të zhvilluara institucione efikase, përfshirë institucionet ligjore, janë zhvilluar më shumë se në ato ku nuk ka të

tilla. Nga ana tjetër, siç thekson edhe Posner (1998), ka shumë shembuj të shteteve dhe vendeve që kanë njohur zhvillim të madh ekonomik në vend të atij politik dhe shpesh kanë demonstruar vendosjen e sistemeve gjyqësore dhe legjislacione të dobëta. Në barazpeshë, të dhënat e hershme bëjnë të ditur se mirëfunksionimi i institucioneve ligjore tenton të çojë drejt rritjes ekonomike. Studimet kanë treguar veçanërisht rëndësinë e institucioneve efektive ligjore në rastet e konvergjencave të kushtëzuara, kur ne kontrollojmë për cilësinë e institucioneve ligjore, vendet që qëndrojnë larg atyre me nivel të ardhurash të qëndrueshme tentojnë të provojnë zhvillim të shpejtë. (Knack dhe Keefer, 1995) Një zbulim i tillë fiton rëndësi të veçantë në kontekstin e zgjerimit të BE. Ai bën të ditur që vendet e anëtarësura – shumica e të cilave kanë nivele GDP për frymë që janë më pak se gjysma e nivelit aktual të BE – mund të tregojnë konvergjencë të shpejtë të mesatares së BE menjëherë me zbatimin dhe respektimin e plotë të *acquis*.

Ka, gjithashtu, prova që pohojnë që institucione më të mira ligjore mund të çojnë drejt një zhvillimi më të mirë ekonomik, sidomos në kuadrin e vendeve të Europës Lindore dhe Qëndrore. Pistor e të tjerë (2000) tregojnë se përmirësimi i efikasitetit ligjor ka një impakt pozitiv në tregun e kapitaleve dhe mbledhjen e kredive private në këtë rajon. Një efektshmëri më e mirë ligjore do të rriste perspektivën e bashkimit të vendeve, pasi të gjithë do të vazhdonin të bënin investime për një kohë të gjatë. Për më tepër që, studimet e bëra nga bizneset vendase janë të mendimit që një kuadër ligjor i papërshtatshëm pengon në aktivitetin ekonomik në rajon. Për shembull, në një anketim të bërë midis disa menaxherëve të lartë dhe analistëve ekonomikë në Sllovaki në vitin 2001, shumica përmendën si pengesë të aktiviteteve sipërmarrëse aftësinë dhe cilësinë e kuadrit ligjor në ndërmarrjen e biznesit: nivel të ulët në respektimin e ligjit, mungesë pavarësie në sistemin gjyqësor, marrëdhëniet midis kreditorëve dhe debitorëve, procedurat e gjata të falimentimit, dhe një përmirësim të komplikuar të aftësive. (IVO, 2001)

Këto vëzhgime të përgjithshme dëshmojnë që anëtarësimi i vendeve mund

të përfitojë nga zbatimi i *acquis communautaire*. Megjithatë, ato nuk nënkuptojnë direkt që thjesht një transpozim i ligjit të BE-së do të çojë automatikisht në një kuadër ligjor më efektiv. Së pari, ne duhet të dallojmë midis cilësisë dhe shtrirjes së ligjit, nga njëra anë, dhe efektshmërisë së ligjit, nga ana tjetër. Edhe ligjet objektivisht më përmirësuese nuk do të kenë një ndikim pozitiv kaq të dukshëm mbi bashkëveprimet sociale dhe ekonomike nëse institucionet ekzistuese mund të mos zbatojnë ato me efikasitet. Prandaj, transpozimi i ligjeve të BE-së në paketat ligjore të vendeve të anëtarësuara mund të jetë një domosdoshmëri, por jo një hap i mjaftueshëm drejt krijimit të një mjedisi mirëfunksionues ligjor.

Në rrethana të caktuara, përdorimi i ligjeve të huaja mund të çojë drejt të ashtuquajturit “efekt i transpozimit”: efektshmëria e ligjeve të tilla mund të jetë më e vogël në këto vende sesa në vendin e tyre të origjinës. (Berkowitz e të tjerë, 1999) Berkowitz e të tjerë vlerëson se efekti i transpozimit shpjegon përafërsisht 69 përqind të mosmarrëveshjeve mbi ligjshmërinë (p.sh. efektiviteti i ligjit), i cili duke u shfletuar shpjegon afërsisht 83 përqind të mosmarrëveshjeve të GNP për frymë. Ky numër mund të jetë deri diku edhe i ekzagjeruar, por edhe nëse efekti i transpozimit aktual ishte vetëm një e dyta e këtyre vlerësimeve; ndikimi i tij do të ishte sërish shumë i madh.

Të njëjtët autorë thonë që efektshmëria e legjislacionit të transpozuar do të varet tek aftësia e vendit transpozues për t’i dhënë atij kuptim dhe për ta zbatuar atë në kontekstin e kushteve të tij social-ekonomike. (*ibid*:10) Efektshmëria e ligjit të ri do të varet fuqimisht nga ajo nëse hartimi i tij është përgjigje e një nevoje për ligj nga njerëzit apo biznesi. Në mungesë të kërkesës, ka gjasa që qytetarët t’i nënshtrihen përdorimit të paktë të ligjeve. Plus që, qytetarët do të nxiten dhe do të kenë aftësinë të përdorin ligjin e ri me efikasitet vetëm nëse do e kuptojnë atë.

Janë dy faktorë kryesorë ata që vendosin nëse ligji i transpozuar ka kuptim në kontekstin e vendit marrës: *afërsia* dhe *përshtatshmëria*. Efektshmëria e ligjit do të rritet, nëse njerëzit janë të njohur me konceptet bazë ligjore të përdorura në ligjin e transpozuar. Një rregull i përgjithshëm thotë, ligji i

transpozuar do të jetë i njohur nëse vendi i origjinës së tij dhe ai që e ka marrë atë ndajnë të njëjtën histori të së drejtës. Të qënurit i njohur me të ul nevojën për përshtatshmëri të mëdha të ligjit të transpozuar. Megjithatë, është e vështirë që vendi i origjinës dhe konteksti social i vendit marrës të jenë pothuaj të njëjtë. Për këtë, me qëllim minimizimin e pasojave të transpozimit, ligjet e reja duhet të përshtaten me kushtet e vendit, veçanërisht me legjislacionin ekzistues dhe atë të zbatueshëm. Ashtu sikurse Berkowitz e të tjerë përmend, përshtatja nuk kërkon domosdoshmërisht që ligji i transpozuar të jetë domosdoshmërisht i ndryshuar. Megjithatë, vendimi për të mos vepruar me ndryshime të mëdha duhet të bëhet mbi bazën e njohurive të posaçme të rregullave dhe ligjeve alternative. (*ibid.*: 11)

Në do t' i përdorim këto parime të përgjithshme si direktiva në analizat tona mbi efektet e ndikimit të zbatimit të *acquis communautaire* në kuadrin ligjor të vendeve të anëtarësuar. Më qartë akoma, së pari, do të vlerësojmë nëse hyrja e *acquis* i përgjigjet kërkesës për një apo më shumë ligje efektive. Gjithashtu, do të vlerësojmë edhe nëse mund të presim që qytetarët në vendet marrëse të jenë familiarizuar me ligjin e BE-së. Shumica e analizave atëherë do të fokusoheshin në atë se si ligjet e reja janë adaptuar me kushtet e vendit dhe nëse ato janë apo mund të zbatohen dhe respektohen me efikasësi.

2. GJENDJA E PËRGJITHSHME NË ZBATIMIN E LIGJIT TË BE NË VENDET ANËTARE

Ligji i BE-së, përgjithësisht, është i njohur si një sistem i ndarë ligjor, i dallueshëm, por edhe ngushtësisht i lidhur me të dy, ligjin ndërkombëtar dhe kuadrin ligjor të vendeve anëtare të BE-së. (Hartley, 1998: 87) Ndonëse i ndarë nga ligji vendas, ligji i Bashkimit është i zbatueshëm nga gjykatat kombëtare. Dispozitat e BE-së duhet të zbatohen nga gjykatat kombëtare nëse kanë *pasojë të drejtpërdrejtë*. Një dispozitë thuhet se ka pasojë të drejtpërdrejtë nëse parashikon të drejta për qytetarët të cilat duhet të zbatohen nga gjykata.¹ Ligji i BE-së nuk merr parasysh ligjin vendas

¹ Që të jetë sa më efektive, një dispozitë duhet të plotësojë dy kërkesa të përgjithshme. Së pari, ajo duhet të jetë pjesë e ligjit të vendit, që do të thotë që gjykatat e vendit duhet ta njohin atë si të vlefshme dhe me efekt detyrues. Në një çështje të njohur të Van Gend en Loos,

në rastet e konfliktit me të dhe kur organet legjislativë nuk kanë fuqinë të ndryshojnë atë. Aspekti tjetër, interpretimi i tij është nën juridiksionin ekskluziv të Gjykatës Europiane të Drejtësisë (GJED). Janë katër burime kryesore të ligjit të BE-së: aktet e shteteve anëtare, aktet e bashkuara, parimet e përgjithshme të ligjit të BE-së, dhe marrëveshjet ndërkombëtare me shtetet jo-anëtare. Aktet e Shteteve Anëtare përfshijnë marrëveshjet e BE-së. “Parimet e përgjithshme” janë miratuar nga GJED. (*ibid*: 88) Aktet e Bashkimit janë miratuar nga institucione të tjera të BE-së, si Komisioni Europian. Ato përfshijnë rregulloret, udhëzimet, vendimet, rekomandimet dhe opinione. Dy kategoritë e fundit nuk kanë forcë detyruese. Ashtu sikurse dispozitat e marrëveshjeve të BE-së janë nënshkruar dhe ratifikuar nga çdo vend anëtar, rregulloret duhet të zbatohen direkt nga gjykatat kombëtare në çështjet për të cilat ato janë nxjerrë. Rregulloret janë akte normative dhe vendosin rregulla të cilat janë detyruese para nivelit të Bashkimit Europian dhe në shkallë kombëtare (Evans, 1998: 188-190; Hartley, 1998: 99). Ndryshe nga rregulloret, udhëzimet dhe vendimet janë detyruese vetëm për personin dhe personat kujt i drejtohen – qytetarë dhe/ose shtete anëtare. Një vendim është detyrues në terësinë e tij në rastet për të cilat ai është ndërmarë. Udhëzimet vendosin qëllime dhe i lënë autoriteteve vendase zgjedhjen e formave dhe metodave për arritjen e tyre. (*ibid*)

Çfarë kuptohet me zbatimin e ligjit të BE-së në vendet anëtare? Vendet

GJED vendosi qartazi që ligji i Bashkimit është pjesë e ligjit vendas. Ajo vendosi që Vendet Anëtare kishin “kufizuar të drejtën e tyre të sovranitetit, edhe pse brenda fushave të kufizuara” dhe se Ligji i Bashkimit synon të njohë të drejtat e individëve “të cilat bëhen pjesë e trashëgimisë së tyre ligjore.”

Së dyti, gjuha e dispozitës duhet të jetë e përshtatshme në njohjen e të drejtave të individëve. Kjo do të thotë që: së pari, ajo duhet të jetë e qartë dhe e kuptueshme; së dyti, ajo duhet të vendosë një detyrim pa kushte; së treti, puna e tij nuk duhet të jetë e varur nga disa veprime të marra nga institucionet e Bashkimit apo Shtetet Anëtare. (Evans, 1998: 186-187; Hartley, 1998: 187-191)

anëtare filluan negociatat e anëtarësimit zyrtar në gjysmën e dytë të viteve 1990 dhe i përfunduan ato në Dhjetor 2002.² Për shkak të negociatave të BE-së, BE e ndau *acquis* në 20 “kapituj” negociimi. Vendet e anëtarësuara pritëshin të zbatonin pjesën më të madhe të *acquis*, e cila arrin në 80.000 faqe ligj. Negociatat e anëtarësimit kishin të bënin me dhënie vendimesh nga *acquis* dhe periudha tranzitore, gjatë së cilës pjesë të veçanta nuk do të zbatoheshin nga vendi zbatues. Secili vend anëtar e udhëhoqi veçmas procesin e negociatave. Një sistem i tillë nënkupton që çdo shtet i anëtarësuar mund të hyjë teorikisht në BE, në kushte të ndryshme konform zbatimit të *acquis*. Megjithatë, përballë shumë çështjesh politike dhe ekonomike Shtetet Anëtare mbajtën qëndrime të njëjta ndaj gjithë vendeve kandidate për në BE. Jacobsen (2001) vlerësoi se të paktën 80 përqind e *acquis* nuk ishte e hapur për diskutime. Në marrëveshjen finale të pranimit, periudhat e tranzicionit janë shumë pak dhe të kufizuara në kohë dhe qëllime; shkarkimet e përkohshme janë edhe më të rralla. Vendeve do t’u kërkohen ligjërisht të zbatojnë dhe respektojnë pjesën më të madhe të ligjeve të BE-së, që nga koha kur ata do të jenë zyrtarisht anëtarë të BE-së. Megjithatë, në shumë fusha, kërkesa për zbatimin e *acquis* është bërë tashmë një detyrim ligjor nën Marrëveshjen e Asociimit, që vendet e anëtarësuara kanë nënshkruar me BE-në në gjysmën e parë të viteve 1990. A ka atëherë një kërkesë të brendshme për një ndërmarje të tillë kaq të gjerë legjislativore? Në të gjitha vendet e anëtarësuara procesi i integrimit në BE është drejtuar nga disa liderë politikë dhe intelektualë. Për më tepër, procesi i integrimit është shumë i përqendruar dhe fillimisht përfshin ekzekutivin, dhe degë të tjera të qeverisë por me rol më të vogël. (Grabbe, 2001) Kjo do të bënte që procesi i zbatimit të *acquis* të mund të kuptohej si një mall i njëanshëm me qëllim të gjërë i një pjese të vogël të shoqërisë për të integruar zyrtarisht vendin e tyre në Europën

² Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Polonia, dhe Sllovenia i filluan negociatat në 1998; Bullgaria, Letonia, Lituania, Sllovakia, dhe Rumania në 2000.

“Perëndimore”. Si rezultat, vendet e anëtarësuara mund të shihen si zbatuese të ligjit të BE-së jo sepse ato dallojnë atë si përfituese direkte në të drejtën e tyre, por sepse origjina e ligjeve influencon që të bëhet kështu. Me fjalë të tjera, një aktivitet i gjerë ligjor është nxitur nga faktorët shtytës.

Ende, kjo shtysë e jashtme duket sikur është ngritur nga kërkesa për një ligjshmëri më të mirë në vendet anëtare. Studimi IVO (2001) përmend paraprakisht se 85 përqind e të intervistuarve kanë indentifikuar si përfitues kryesorë të hyrjes në BE harmonizimin e kuadrit ligjor me BE-në dhe 79 përqind rritjen e efiçensës së ligjit. Për më tepër, zhvillimi i shpejtë i ekonomisë së tregut në të gjitha vendet anëtare gjithashtu bën të ditur një rritje të kërkesës së strukturave ligjore të sofistikuara për përforcim dhe rregullim bashkëveprues të tregjeve. Meqenëse vendet aktualisht anëtare të BE-së janë ekonomi tregu shumë të zhvilluara, ne mund të hipotetizojmë që në përgjithësi ligjet dhe rregulloret e tyre duhet të korrespondojnë me nevojat e vendeve anëtare, duke aspiruar në rivalizimin e suksesit të tyre.

3. ZHVENDOSJA E LIGJIT TË BE

Terminologjia zyrtare e përdorur për të përshkruar zbatimin e ligjit të Bashkimit në vendet anëtare është “transpozim” në vend të “transplitim”. Termi përmban faktin që *acquis* është prezantuar në një mjedis me një kuadër ekzistues dhe të mirë-zhvilluar ligjor. Për pasojë, ligji i Bashkimit nuk zëvendëson kuadrin ligjor ekzistues apo të vendosë një kuadër ligjor totalisht të ri. Më saktë, transpozim do të thotë kur ligji i Bashkimit është në plotësim të ligjit ekzistues. Ligji ekzistues është ndryshuar në ato raste kur ai binte në kundërshtim me ligjin e Bashkimit, ose kur më thjesht është zëvendësuar apo ndryshuar me dispozita të reja. Në disa raste, rreshtimi i legjislationit kombëtar përkrah ligjit të BE-së mund të kërkojë amendamente kushtetuese. Përgjithësisht, aktet e reja legjislative duhet të futen në një kuadër ligjor, i cili mund të hartohet për ato fusha ku ende ai nuk ekziston. Për këtë, zbatim do të thotë ndryshim të akteve normative, reforma të thella institucionale, dhe

ndryshime në strukturën e sistemit ligjor. (Jacobsen, 2001: 13) Megjithatë, vendet e anëtarësuar nuk kanë hartuar një kuadër të ri ligjor në mënyrë mekanike, duke futur në të një sistem ligjor të tërin të huaj, në shoqëritë e tyre. Teoria jonë kështu sugjeron që ky fakt i thjeshtë duhet të limitojë ashpërsinë e efektit të transpozimit.

Me qëllim të kuptojmë se sa vendet transpozojnë këto pjesë të *acquis* që ata marrin, do duhet të shohim me kujdes së pari procesin e transpozimit. Ai fillon me fazën e “projektimit”, në të cilën ekspertët ligjorë të BE-së vlerësojnë kuadrin ligjor ekzistues të secilit vend kandidat. Qëllimi i kësaj faze është për të përcaktuar shkallën e pajtimit të ligjit vendas me atë të *acquis* dhe të metat e sistemit. (Grabbe, 2001: 1022) Paskëtaj, BE-ja propozoi fushat përkatëse, ku ligjet ekzistuese duhet të harmonizoheshin me *acquis*, zbatimin e ligjeve shtesë, dhe ngritjen e institucioneve. Çdo vend ka një “Program Kombëtar për Adoptimin e *Acquis Communautaire*” vjetor, i cili përmbledh ligje të veçanta që qeveria e tij duhet ende t’i zbatojë dhe institucionet që duhet të ngrihen apo forcohen.

Për shkak të statusit të tyre ligjor brenda legjislacionit të BE-së, rregulloret dhe vendimet zbatohen direkt pa ndryshime të mëdha. Për këtë, ato nuk mund t’iu përshtaten kushteve të vendit vetëm nëpërmjet përkufizimeve, të cilat mund të ulin edhe efikasitetin e tyre. Megjithatë, që kur udhëzimet i janë lënë në dorë një Shteti Anëtar në zgjedhjen e mjeteve dhe metodave për arritjen e objektivave që duhen rregulluar, qeveritë e vendeve anëtare mund t’i përshtatin ato. Mirëpo sërish, mund të shihet si e vështirë që qeveritë e vendeve anëtare janë në gjendje të kenë avantazh ndaj kësaj çështjeje. Sigurisht, BE ofron këshilla ligjore dhe ndihmë të ekspertëve ligjorë që ndihmojnë qeveritë e vendeve në draftimin e ligjeve të kërkuara. Për këtë eksperiencia teknike përkatëse duhet të ofrojë lehtësi në përshtatjen sa më efektive të ligjeve konform kushteve të vendit. Në anën tjetër, terësia e legjislacionit që duhet të hartohet, mungesa ekspertëve vendas të kualifikuar dhe numri i limituar i ekspertëve ligjorë nga BE sugjerojnë që vendet e

anëtarësuara shpesh duhet të imitojnë strategjitë ligjore të aplikuara tashmë nga anëtarët e BE.

Ndoshta pengesa kryesore e cila kufizon aftësinë e vendeve të anëtarësuara në përshtatjen e ligjit të Bashkimit është koha e shkurtër brenda së cilës e tërë *acquis* duhet të vihet në zbatim. Kjo kërkon ndërmarrjen e një procesi të tërë eficient në hartimin e ligjeve, i cili në përgjithësi është i papajtueshëm me përfshirjen e gjerë të parlamentarizmit. Si rezultat, legjislaturat e vendeve rrallë herë tentojnë të ndryshojnë ligjet e anëtarësimit miratuar nga qeveritë përkatëse. Për më tepër, Grabbe (2001) bën të ditur se deputetët shpesh ankohen për pamjaftueshmërinë e mendimit teknik siç janë njohuritë e nevojshme të specialistëve në të kuptuarin e përzierjes së legjislacionit. Të tilla praktika institucionale jo vetëm zvogëlojnë nismën në adaptim të ligjeve por gjithashtu krijojnë probleme të konsiderueshme në sistemin demokratik. Marxhinalizon legjislaturën duke i larguar asaj rolin më kryesor, atë të hartimit të legjislacionit. Në përpjekje për të nxitur përshtatjen e *acquis*, të gjitha qeveritë kanë prezantuar disa forma të procedurave të shpejta. (*ibid*: 1017) Disa prej tyre kanë krijuar edhe skema eksplicite për eliminimin e rolit të parlamentit në to sa më shumë të jetë e mundur.³

Disa shenja të dukshme bëjnë të ditur, gjithashtu, që një aktivitet i madh legjislativ në një periudhë të shkurtër kohe ul aftësinë e njerëzve për të asimiluar ligjin. Edhe njëherë, në studimin e IVO (2001) 43 përqind e të përgjigjurve kanë deklaruar që transparenca e legjislacionit të përshtatur së fundmi ka ardhur në rënie në Sllovaki. Vetëm 4 përqind besojnë në përmirësimin e tij. Ky konkluzion shtrun para nesh faktin që qeveria duhet t'i

³ Për shembull, Qeveria Sllovake hartoi një ligj që më pas u miratua në parlament, i cili autorizon Qeverinë të miratojë aktet ligjore – si udhëzimet dhe dekretet – hartuar për zbatimin e *acquis communautaire*. De facto ligji i jep fuqi të gjerë legjislative ekzekutivit. Ai nuk lejon vetëm akte të tilla që mund të amendojnë qëllimin e të drejtave bazë të njeriut dhe të tjera çështje që kushtetuta kërkojnë të bëhen në mënyrë eksplicite nga ligji.

bëjë ndryshimet ligjore më transparente kështu edhe faktorët socialë dhe ekonomikë mund të përshtaten më me efikasitet ndaj ndryshimeve të shpejta legjislative.

Sidoqoftë, ka disa faktorë që mund të influencojnë pozitivisht në transpozicionin e ligjit të BE-së, duke rritur efikasitetin e tij në vendet e anëtarësuara. Së pari, disa vëzhgues kanë vënë re që pasojat e reformës ligjore mund të jenë të mira nëse ecin paralel me reformat ekonomike. Reformat ekonomike ndihmojnë në rritjen e kërkesave për reforma ligjore në të njëjtën kohë që gjeneron edhe burimet e nevojshme për ndërmarjen e reformave ligjore. (Gray, 1997) Të gjitha vendet e anëtarësuara kanë vijuar reformat ligjore me reformat ekonomike. Për më tepër, këto reforma janë pjesë e nje transformimi të gjerë social, i cili mund të sigurojë edhe më shumë kushte të favorshme për një zbatim të suksesshëm të reformave ligjore:

Procesi i transformimit post-komunist mund t'i bëjë vendet (e Europës Qendrore e Lindore) më të pranueshme ndaj modeleve institucionale të BE-së sesa vendet anëtare ekzistuese, sepse modelet e BE-së janë bërë të njohur në të njëjtën kohë me politikëbërësit (e Europës Qendrore e Lindore) që kërkojnë modelet institucionale për të zëvendësuar apo krijuar një strukturë të re. (Grabbe, 2001: 1014)

Veç kësaj, shoqëritë e Europës Qendrore kanë qenë shumë të hapura ndaj influencave të Europës Perëndimore. Qysh prej rënies së komunizmit, ato e kanë perceptuar integrimin në BE si një proces të ripërkufizimit të identitetit të tyre pas rrëzimit të komunizmit. Në shumë prej tyre, ky zakon është mishëruar në sloganin “Kthim në Europë.” Nocioni i kthimit në Europë është rritur duke u plotësuar edhe me shumë nocione të domosdoshme që kuptojnë Integrimin European në termat pragmatistë të ekonomisë, politikës, dhe përfitimeve të sigurisë. (Brusis, 2001) Të qenurit të hapur ndaj influencave europiane nënkupton që shoqëritë duhet të jenë pranuese të ligjeve dhe institucioneve që ato mund t'i indentifikojnë si “europiane.” Një histori politike dhe kulturore e përbashkët e paraluftës së II Botërore me vendet e Europës

Perëndimore rrit edhe më shumë këtë perceptim.

Kushtëzimi i hyrjes në BE është faktori kryesor i cili ndikon në një transpozim të shpejtë dhe të kuptueshëm të *acquis*. Kushtëzimi buron nga fakti që BE=ja nuk ka garantuar anëtarësinë e ndonjë shteti kandidat. Ajo nënshkruan marrëveshje anëtarësimi vetëm me ato vende që përmbushin kushtet e anëtarësimit. Që kur zbatimi i plotë i *acquis* është bërë një prej kushteve, kushtëzimi e ka pajisur BE-në me një mjet të rëndësishëm për të bërë të mundur pëlqimin. Përtej “bombës atomike” të të fshehurit të të gjithë anëtarësisë, BE-ja mund të përdorë dhe ka përdorur vazhdimisht si të tillë armë me pak të dëmshme, por më shumë efektive. Së pari, ka renditur kandidatët dhe ka përdorur mjete të ndryshme për të nxjerrë në pah mungesat në transpozitimin e *acquis* në çdo vend. Këto kanë përfshirë qëndrime nga zyrtarë të BE-së dhe zhvillime zyrtare në raportet e rregullta të anëtarësimit të publikuar çdo vit nga Komisioni Europian. Kritikkat zakonisht janë drejtuar ndaj reportazheve negative ndërkombëtare dhe ato të vendeve dhe presioneve politike që kanë vështirësuar pozitën e qeverive në hartimin e kërkesave të BE-së. (Grabbe: 2001) Megjithatë, problemi kryesor me kushtëzimin është se ai ka funksionuar vetëm kur qeveritë candidate janë angazhuar fortë për t’u anëtarësuar në BE. Nëse kupola qeverisëse politike ka prioritete të tjera, mjeti i kushtëzimit bie, siç ka qenë rasti i Sllovakisë gjatë qeverive pasuese të Kryeministrit Vladimir Meciar (1993-1998).

4. ZBATIMI I EFEKTSHËM DHE RESPEKTIMI: A MUND TË ARRIHET AI?

Nëse përmirësimet në sigurimin e mbrojtjes ligjore të shtetit ndër vendet aplikuese të BE-së çojnë drejt rritjes së efektivitetit të ligjit kjo varet domosdoshmërisht nga prania e institucioneve që mund të administrojnë dhe respektojnë efektivisht ligjin e BE-së. Mënyra e arritjes së këtij qëllimi i referohet asaj që quhet ngritje institucioni. Kjo mund të përkufizohet tërthorazi si ngritje e strukturave, procedurave, burimet njerëzore, dhe menaxhim

aftësish, të cilat kërkohen për të, për të bërë të mundur që *acquis* të zbatohet dhe respektohet korrekt, drejt, me efekt dhe në mënyrë të mundshme. (Jacobsen, 2001: 27) Ashtu sikurse vazhdimi i negociatave të anëtarësimit, është bërë më se e qartë që ngritja e institucioneve do të jetë pengesa më e madhe në sigurimin e zbatimit eficient të *acquis*. Aftësitë e pamjaftueshme institucionale dhe administrative në vendet aplikuese janë përcaktuar si probleme kyç në zgjerimin e procesit edhe nga Këshilli European i Madridit në 1995. (Krenzler dhe Everson, 1998) Në raportin e tij të fundit mbi procesin e anëtarësimit, Komisioni European përfundoi se “pavarësisht progresit të bërë gjatë vitit të fundit, nevoja më e madhe tani konsiston në ngritjen e strukturave adekuate administrative dhe forcimin e aftësive administrative për të zbatuar *acquis*.” (KE, 2001a: 17)

Cilët faktorë kanë penguar dhe cilët kanë nxitur ngritjen e institucioneve në vendet e anëtarësura? Pengesa e parë kryesore është mungesa e eksperiencave të tilla në vend. Institucionet që këto vende kanë pasur gjatë periudhës komuniste ishin ngritur për të drejtuar dhe kontrolluar ekonominë dhe njerëzit. Nuk ishin bërë për të siguruar një kuadër bashkëpunimi të mirë social dhe ekonomik midis qytetarëve të lirë. Njohuritë dhe eksperiencia që ato kanë grumbulluar në këtë fushë që prej rënies së komunizmit kthehen në asgjë krahasuar me atë të vendeve aktuale anëtare të BE-së. Mungesa e eksperiencës është veçanërisht e dukshme në ato vende kandidatë që e kanë fituar pavarësinë e tyre vetëm së fundi. Gjysma e vendeve anëtare ndodhen në këtë kategori: tre vendet Balltike, Sllovakia dhe Sllovenia.

Mungesa e eksperiencës është e lidhur ngushtë edhe me një pengesë tjetër: mungesën e njerëzve të përgatitur. Ky problem ka sjellë disa pasoja. Së pari, asnjë prej vendeve të anëtarësuar nuk ka pasur një shërbim civil të trainuar, të pavaruar dhe profesional gjatë periudhës komuniste. Së dyti, vendet sërish kanë mungesa për organe që mund të sigurojnë përgatitje të mira për nëpunësit civilë. Për shembull, Sllovakia ende nuk ka institucion të sajën të arsimit të lartë dedikuar kualifikimit dhe trajnimit të nëpunësve civile.

Së fundi, ndryshe nga shumë vende të BE-së, në vendet e anëtarësuara individët me aftësitë më të mira dhe të arsimuar rralë zgjedhin të aplikojnë për të zhvilluar karrierë në shërbimin civil. Nëpunësit civilë zakonisht paguhen shumë pak, krahasuar me pagën që merret në sektorin privat dhe nuk gëzojnë të njëjtën gjendje sociale si në shumë vende të Europës Perëndimore. Mos u çudisni kur të shihni se, BE-ja ka treguar një kujdes të veçantë për të siguruar që vendet e anëtarësuara të përsosin profesionalisht shërbimin e tyre civil. Sllovakia ka hedhur hapin e parë të madh për këtë çështje vitin e kaluar me miratimin e ligjit të ri për shërbimin civil.

Pengesa e fundit më e madhe në bërjen të mundur të zbatimit efektiv dhe respektimit të *acquis* është sistemi gjyqësor ineffiçent dhe joefektiv. Drejtësia në shumë prej vendeve në tranzicion historikisht vuan nga një mungesë e madhe pavarësie, paanësie dhe profesionalizmi. Për më tepër, reforma në drejtësi ka hasur në shumë vështirësi në disa vende. Mjaft interesante është se, mungesa e zhvillimit ka ardhur pjesërisht nga besimet e pranuar botërisht që ekzekutivi duhet të shmangë ndërhyrjet e tij në sistemin gjyqësor.⁴ Për shembull, ndaj pushtetit gjyqësor në Sllovaki janë bërë shumë kritika të hapura edhe nga vetë BE. Komisioni Europian ka qënë i shqetësuar për të dyja, për

⁴ Vështirësitë e miratimit të ndonjë ndryshimi në sistemin gjyqësor janë treguar shumë mirë në raportin vijues të EIU: “Ministri [aktual] i Drejtësisë, Carnogursky, fillimisht tentoi të zbatojë ndryshimet gjithëpërfshirëse [në sistemin gjyqësor], përfshirë përpjekjet e qeverisë për të larguar nga detyra kryetarin e Gjykatës së Lartë, Stefan Harabin, i cili ishte emëruar në këtë detyrë gjatë administratës së Meciar. Drejtimi i z. Harabin është kritikuar vazhdimisht nga kolegët e tij në Shoqatën e Gjyqtarëve dhe tetë prej krerëve të 12 gjykatave përkrahën largimin e tij. Megjithatë, në Dhjetor 2000 Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara raportoi mbi pavarësinë e gjyqtarëve, duke iu përgjigjur një ankese të z. Harabin, ku paralajmëroi që komunitetit ndërkombëtar do t’i vinte keq për largimin e tij me votë parlamentare si “jolicjore dhe politikisht jo korrekte“. Parlamenti me vështirësi e hodhi poshtë këtë masë. Ndonëse ka patur pak progres në reformimin dhe riorganizimin e sistemit gjyqësor” (EIU, 2002: 12-13)

kohëzgjatjen dhe cilësinë e procedimeve gjyqësore. Kohëzgjatja mesatare e procedimeve gjyqësore ka qenë pothuajse 13 muaj për çështjet civile në vitin 2000. Komisioni vëren se:

Përmirësimet [e rëndësishme] në nivelin praktik janë të nevojshme gjithashtu edhe për të garantuar paanësinë profesionale të gjyqësorit dhe pavarësinë politike. Raportet dhe studimet vazhdojnë të tregojnë se korrupsioni mbetet ende një problem serioz. Gjyqësori nuk është në rrugën e duhur për të luftuar korrupsionin. [...] trajnimet në rritje të gjyqtarëve, së bashku me sigurimin e pajisjeve të përshtatshme dhe stafëve administrative janë gjithashtu çështje prioriteti. (EC, 2001b: 18)

Prandaj, është e qartë që një respektim i duhur efektiv i *acquis* nuk mund të arrihet pa reforma të qarta në veprimtarinë e sistemit gjyqësor.

Pavarësisht nga të gjitha këto vështirësi, ne mund të identifikojmë faktorë të ndryshëm që mund të çojnë drejt përmirësimit të ngritjes së institucioneve dhe respektimit të *acquis*. Sikurse e kemi përmendur edhe më parë, rasti i Sllovakisë tregon që ka një kërkesë në rritje tashmë për institucione efektive dhe në respektim të ligjit. Nëse bosët e biznesit shohin se mosrespektimi i ligjit është pengesa kryesore në aktivitetin e tyre sipërmarrës, ata do të nxisin qeverinë për të përmirësuar situatën. Duke qenë se ata janë të vetmit që krijojnë mundësi punësimi dhe rritje ekonomike, ata përbëjnë një grup të rëndësishëm interesi të cilin qeveria nuk mund ta lërë mënjanë për shumë kohë. Presion më i madh ushtrohet edhe nga jashtë vendit. Siç tregohet edhe nga raportet e fundit të Komisionit Europian, BE-ja ka treguar interes të vazhdueshëm në zbatimin efektiv dhe respektimin e *acquis*. Lidhur me anëtarësimin, kushtëzimi për këtë çështje mund të sjellë mjete jashtëzakonisht efektive në sigurimin e efiçencës së ligjit të BE-së në vendet candidate. Dhe vërtetë, presioni i BE-së së fundi ka çuar në forcimin e pavarësisë të sistemit gjyqësor në Sllovaki. Pas kritikave të përsëritura nga BE-ja, Sllovakia kaloi në 2001 një amendament kushtetues me ndikim të gjerë. Midis të tjerave, amendamenti shfuqizoi periudhën e stazhit të gjyqtarëve dhe ngriti një Këshill

të Gjyqtarëve duke e autorizuar atë të mbikqyrë procedurat e emërimit dhe lëvizjes së gjyqtarëve.

BE-ja po ndihmon gjithashtu vendet e anëtarësuara në përmirësimin e cilësisë së shërbimit civil me programe binjakëzimi. Qëllimi i binjakëzimit është të ndihmojë vendet e anëtarësuara të përmirësojnë institucionet e tyre duke mësuar nga eksperiencat e vendeve anëtare me inkuadrimin e legjislacionit dhe strukturimin e aftësive organizative të nevojshme në zbatimin e *acquis*. (Grabbe, 2001: 1024) Kjo përfshin vendosjen e zyrtarëve të vendeve anëtare të BE-së të punojnë në ministri dhe organe të tjera të administratës publike në vendet e anëtarësuara. Si përfundim, BE-ja siguron, gjithashtu, programe trajnimi të ndryshme për nëpunësit civilë të vendeve kandidatë, ashtu sikurse edhe ndihmë teknike dhe mbështetje financiare në ngritjen e institucioneve. (*ibid*)

A do të mundet anëtarësia aktuale e BE-së të sigurojë kushte për përmirësime të mundshme të zbatimit dhe respektimit të *acquis*? Ato që priten janë të mjaftueshme në vendet e anëtarësuara. Sipas studimit të IVO (2001), 79 përqind e të intervistuarëve besojnë se respektimi i ligjit do të përmirësohej në Sllovaki, pasi vendi t'i bashkohej BE-së. Vetëm 2 përqind parashikojnë përkeqësim të situatës. Një optimizëm i tillë mund të jetë i ekzagjeruar. Më saktë, sapo vendi kandidat t'i bashkohet Bashkimit, BE nuk do të jetë në gjendje edhe për shumë kohë të përdorë kushtëzimin e anëtarësisë për të ndikuar në ngritjen e institucioneve. Për më tepër, pagesat diferencuese midis vendeve të BE-së dhe atyre kandidatë mund të çojnë në “rrjedhje të trurit” nga vendet e anëtarësuara. Shumë nëpunës civilë të kualifikuar që punojnë aktualisht për çështjen e integritimit në BE do të iknin për punëra më të paguara që do të hapeshin në Bruksel. Kjo do të përkeqësonte edhe më mungesën e burimeve njerëzore në administratën publike.

Megjithatë, këto faktorë negativë mund të kompesohen në kushtet e reja politike dhe ligjore që mund të vijnë nga anëtarësimi në BE. Më tej, avantazhi

më i madh buron nga ngritja e një institucioni të ri të madh gjyqësor në kuadrin ligjor Sllovak, Gjykatën Europiane të Drejtësisë. Megjithëse, marrëveshjet i kanë dhënë Gjykatës Europiane juridiksion të limituar, ajo ushtron edhe pushtet të rëndësishëm. (Hartley, 1998: 58) GJED mund të mund të kuptohet si një gjykatë e lartë e cila siguron një kuadër të përkulur të jurisprudencës dhe gjithashtu merret me çështjet gjyqësore, në të dyja rastet referuar gjykatave kombëtare dhe atyre që janë ngritur fillimisht para saj. Pamvarësisht faktit që Gjykata nuk mund të zbatojë ligjin direkt, vendimet e saj kanë peshë direkte dhe ka pushtet të ndëshkojë qeveritë e vendeve anëtare për mos-zbatimin e ligjit të BE. Si rezultat i vendimeve të saj, dëmet mund ti kërkohen atyre qeverive që dështojnë në zbatimin e saktë të ligjit të BE. (Éallace, 2000: 23) Për pasojë, aktorë të ndryshëm brenda BE kanë mundësi të përdorin GJED si mënyrë për të vënë në zbatim atë dhe respektimin e *acquis* në vendet e anëtarësuaras pas zgjerimit të Bashkimit.

Për më tepër, ne mund të shohim që qeveri të tjera të vendeve anëtare do të jenë në gjendje të ushtrjnë presionin e duhur për të siguruar efciçensën e kërkuar të ligjit. Një situatë e veçantë interesante mund të ishte, nëse kompanitë e ngritura nga vendet e tjera anëtare dhe që do të mund të punonin në vendet e tjera të ndjenin se interesi i tyre do të prekej nga paaftësia e gjykatave kombëtare në respektimin e ligjit, pjesërisht. Në raste të tilla, të dy, qeveritë anëtare dhe Komisioni mund të përdornin mjete të ndryshme presioni tek anëtarët e rinj për të marrë pëlqimin e tyre.

KONKLUZION

Shumica e anëtarëve të ardhshëm të BE-së nga Europa Qëndrore dhe Lindore kanë bërë goxha progres në transpozimin e *acquis communautaire* në sistemet e tyre ligjore. Megjithatë, ecuria në zbatimin e ligjeve në bllok nuk është pasuar nga rezultate të krahasueshme në ngritjen e institucioneve dhe respektimin e tyre. Provat e deritanishme thonë se këto mungesa kufizojnë efciçensën e ligjeve të reja. Vendet e anëtarësuaras ende qëndrojnë

të lidhura pas trashëgimisë post-komuniste dhe asaj gjyqësore. Ato ende kanë mungesë eksperience dhe burimesh njerëzore të kërkuara nga procesi i anëtarësimit. Megjithatë, faktorë të ndryshëm sugjerojnë që ne mund të presim përmirësime të qëndrueshme në fushën e respektimit dhe për këtë në efikasësinë e përgjithshme të institucioneve ligjore. Së pari, BE do të vijojë të sigurojë burime të tilla, përfshirë financime dhe trainime, për përmirësimin e aftësive administrative në vendet e anëtarësuar. Së dyti, shtimi i institucioneve të reja dhe respektimi siguron presionin e nevojshëm ndaj vendeve kandidatë në vazhdimin e reformave. Nevojat e brendshme për kërkim të një efikasiteti ligjor më të mirë janë gjithashtu shenja inkurajuese. Së fundi, hyrja aktuale në BE mund të sjellë faktorë shtesë duke çuar drejt një mjedisi ligjor më efikas. Ato përfshijnë detyrimet ligjore të zbatimit dhe respektimit të *acquis*, ashtu sikurse dhe autoritetet e reja gjyqësore, Gjykata Europiane e Drejtësisë.

Këmbëngulja e zgjerimit do të ndryshojë pa dyshim natyrën e Bashkimit Europian. Do të ripërcaktojë dhe ripërkufizojë totalisht mjedisin institucional dhe aktivitetin e vendeve të reja anëtare. Në këtë pikë, askush nuk mund të parashikojë qartë efektet e sakta të një mënyre të re jetese në vendet e anëtarësuar së fundmi. Megjithatë, duket se vetë ata do të përfitojnë nga një përmirësim i vazhdueshëm i efikasitetit të ligjit. Kështu, ne mund të presim që së bashku me përfitimet e marra nga pjesëmarrja në tregun e BE, kjo do të na çojë drejt një performante më të mirë ekonomike në Europën Qendrore dhe Lindore.

BIBLIOGRAFIA

Berkowitz, D., K. Pistor, dhe J.F. Richard (2000) “Zhvillimi Ekonomik, Ligjshmëria, dhe Efekti i Transpozimit,” CID Shkrimet mbi Ligjin dhe Zhvillimin Nr. 1, Kembrixh, MA: Universiteti Harvard

Bilcik, V. (2001) “A mundet Sllovakia të arrijë? Përfshirjet e bisedimeve të Pranimit të BE një vit pas Samitit të Helsinkit,” Shkrimi i DUPI Nr. 2001/1, Kopenhagen: Instituti Danez i Marrëdhënive Ndërkombëtare Brusis, M.

(2001) “Konkluzione: Ngjashmëritë Kombëtare dhe Europiane në Vendet e anëtarësuara – Roli i Bashkimit European,” në P. Drulak (ed.), *Ngjashmëritë Kombëtare dhe Europiane në Zgjerimin e BE*, Pragë: Instituti për Marrëdhëniet Publike

EBRD (1999) *Raportet Kalimtare: Dhjetë Vite Tranzicion*, Londër: Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

EC (2001a) “Suksesi i zgjerimit,” Strategjia dhe Raporti i Komisionit European në rrugën drejt anëtarësimit nga secili vend anëtar,” Bruksel: Komisioni i Komunitetit European

EC (2001b) “Raporti 2001 i Zhvillimit të Sllovakisë drejt Anëtarësimit.” Bruksel: Komisioni i Komunitetit European

EIU (2002) *Sllovaki: Profili vendit 2002*, Londër: Njësia e Zbulimit Ekonomik

Evans, A (1998) *Tekst mbi Ligjin e BE*, Oksford: Botimet Hart

Grabbe, H. (2001) “Si ndikon europeanizimi në qeverisjen e EQL? Kushtëzimi, shpërndarja dhe ndarja,” *Gazeta e Politikës Publike Europiane*, vol. 8 (December 2001), pp. 1013-1031

Gray, C. W. (1997) “Reformimi i Sistemeve Ligjore në Ekonomitë në Zhvillim dhe Tranzicion,” *Financa dhe Zhvillimi*, vol. 94 (3), pp. 14-16a

Hartley, T.C. (1998) *Themeluesit e Ligjit të Komunitetit European*, Neë York: Zyra e Shtypit të Universitetit Oksford

Hay, J.R., Shleifer, A. and R. Vishny (1996) “Drejt teorisë së reformës ligjore,” *Vështrim mbi Ekonominë Europiane*, vol. 40, pp. 559-567

IVO (2001) “Studim mbi Mendimet e Krerëve të Ekonomisë mbi Çështjet e Ditës së Ekonomisë Sllovake,” Bratislavë: Instituti për Çështjet Publike (IVO)

Jacobsen, C.B. (2001) “Përshtatshmëria e Sistemeve Ligjore të Vendeve Kandidate – Çështja e Shteteve Baltike,” Shkrimi DUPI Nr. 2001/8, Kopenhagen: Instituti Danez i Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Knack, S. dhe P. Keefer (1995) “Zhvillimi Institucional dhe Ekonomik:

Provat në natyrë të Masave Alternative Institucionale,” *Ekonomia dhe Politika*, vol. 7 (Nëntor 1995), pp. 207-27

Krenzler, H.G. dhe M. Everson (1998) “Përgatitja e *Acquis Communautaire*: Raport mbi Punën në grup të Zgjerimit Lindor të Bashkimit Europian,” Robert Schuman Qendra e Studimeve, Florence: Instituti Universitetit Europian

La Porta, R., F. Lopez-de-Silanes, A. Shleifer, dhe R. Vishny (1998), “Ligji dhe Financa,” *Gazeta e Ekonomisë Politike*, vol. 106, pp. 1113-55

Landes, D. (1998) *Pasuria dhe varfëria e Kombeve: Pse disa janë të pasur dhe disa të varfër*, Londër: Little, Brown dhe Kompania

Nicolaides, P. (1999) “Zgjerimi i EU dhe Zbatimit Efektiv i Rregullave të Komunitetit: Shkrim mbi Integrimin,” Shkrimi 99/W/04, Maastricht: Instituti Europian i Administratës

Pistor, Katharina, M. Raiser, dhe S. Gelfer (2000) “Ligji dhe Financa në Ekonomitë në Tranzicion”, *CID Shkrime mbi Ligjin dhe Zhvillimin* Nr. 4, Kembrixh, MA: Universiteti Harvard

Posner, R. (1998) “Hartimi i një Kuadri Ligjor për Ekonomitë në Zhvillim,” *Studimi Kërkimor i Bankës Botërore*, vol. 13 (Shkurt 1998), pp. 1-11

Schauer, F. (2000) “Politika dhe Stimujt e Transpozimit Ligjor,” in J. Donahue dhe J. Nye (eds.), *Qeverisja në një Botë Globale*, Washington: Zyra e Shtypit të Institutit Brookings

Sedelmeier, U. dhe H. Wallace (2000) “Zgjerimi Lindor,” në H. Wallace dhe W. Wallace, *Politikë-Bërja në Bashkimin Europian*, Neë York: Zyra e Shtypit të Univesitetit Oksford

Steyer, E. (1997) *Traditat Kombëtare dhe Ligji i Komunitetit Europian: margarine dhe martesa*. Grookfield: Kompania e Botimeve Dartmouth

Wallace, H. (2000) “Kuadri Institucional,” në H. Wallace dhe W. Wallace, *Politikë-Bërja në Bashkimin Europian*, New York: Zyra e Shtypit të Universitetit Oksford.

Ligjshmëria e ligjshmërisë

Charles-Albert MORAND

Përktheu: Diana Estrefi

Parimi i ligjshmërisë imponohet aq qartë, saqë, po të pyesësh për bazën e tij juridike, duket sikur kënaq një kureshtje të dëmshme. Në fakt ka një pikë provokimi që urdhëron parimin e ligjshmërisë të përligjet juridikisht. Kjo është si të pyesësh Zotin të qartësojë bazat e tij. Duke ngulmuar të formulosh një pyetje të tillë, rrezikon të bësh një tjetër gabim, atë të kotësisë. A nuk mbyllemi në lojëra të pastra intelektuale, duke pyetur mbi bazat juridike të parimeve të para dhe mbi paradokset dhe rrathët viciozë që nuk mungojnë të hasen në këtë rast? I pari i këtyre paradokseve është se një parim, i cili mbahet se furnizon të drejtën me parashikim dhe siguri, është aq i lëvizshëm dhe i ndikueshëm, saqë është tepër e vështirë të përcaktohet në një rast konkret gjerësia e kërkesave që dalin prej këtij parimi. I dyti është ai që tekstet ligjore nuk duken se luajnë ndonjë rol të madh në përcaktimin e kërkesave të ligjshmërisë. Atëherë pyesim: Përse parimi nuk i trashëgon vetitë të cilat ai i vetë shpall? A nuk e thotë vetë ai se kush bën ligjet duhet edhe të pësojë prej tyre? (*legem patere quam fecisti*)?

Megjithatë, është e nevojshme të kërkojmë t'i kuptojmë këto situata paradoksale. Kjo na lejon që të shqetësohemi për natyrën e parimeve të ligjshmërisë dhe përtej kësaj, edhe për parime të tjera të përgjithshme të së drejtës. Mund të shpresojmë, gjithashtu, t'i japim një ndriçim të ri çështjeve të vjetra, si për shembull, për lidhjet mes ligjit dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës të zbuluara nga jurisprudenca.

I. PASIGURIA E PARIMIT TË LIGJSHMËRISË

Tradicionalisht njihen dy aspekte të parimit: përparësia dhe rezerva ndaj ligjit. Parimi i përparësisë do të thotë që një organ shtetëror duhet të jetë në pajtim me ligjin. Kur aktet janë të hierarkizuara, normat më të ulëta duhet t'u përshtaten akteve sipërore. Parimi i ligjshmërisë ka një rëndësi që e tejkalon përshtatjen me ligjin. Ai “shpreh *përshtatjen me ligjin* dhe është *sinonim i rregullit juridik*” (VEDEL/DELVOLVE: 443). Zona e pasigurisë kryesore gjendet në detyrimin që kanë gjyqtari dhe administrata për të respektuar ligjin kur e interpretojnë atë. Parimi i përparësisë, i kombinuar me atë të ndarjes së pushteteve, shënon një kufi në veprimtrinë krijuese të gjyqtarit. Ky kufi përbëhet nga një numër i madh rregullash ose urdhrash interpretimi. Mirëpo këto nuk rregulla janë shumë të qarta dhe janë pak detyruese. Edhe heqja e të drejtës së interpretimit *contra legem*, që duket sikur i vendos një barrierë të lirë veprimtarisë krijuese të gjyqtarit, nuk është e qartë. Nuk është parë që një gjyqtar të zbatojë një ligj, kur ai do të ishte plotësisht i paarsyeshëm.

Fakti që jemi të paafte për të saktësuar natyrën e rregullave të interpretimit, që flasim herë për metoda, herë për rregulla, herë për parime, herë për direktiva¹ do të thotë se nuk mund të pritet ndonjë siguri e madhe e së drejtës nga përdorimi i tyre. Megjithatë, është e kotë që, duke nisur nga rregulla kaq lehtë të përpunueshme, të mund të bësh parashikime të sigurta lidhur me interpretimin që mund t'i bëhet një ligji në një rast të caktuar. Pamundësia në të cilën ndodhemi, kur themi që një metodë interpretimi vlen më shumë se të tjerat, kur ato nuk arrijnë të gjitha në të njëjtin rezultat,

¹ Mbi këto variante të terminologjisë, shih veprën e botuar nën drejtimin e J-F. PERRIN, Rregullat e interpretimit. Parimet e pranuar bashkarisht nga juridiksionet. Aty gjenden rregulla dhe parime, metoda në një seri ndihmesash dhe direktivash në penën e OST dhe të Van de KERCHOVE.

tregon fare mirë se interpretimi shihet si një veprimtari krijuese, e cila i lë gjyqtarit një marzh të madh vlerësimi. Pra, kush thotë krijim i së drejtës, nënkupton hapje të kutisë së zezë ose të kutisë së Pandorës të pasigurive. Gjithsesi, kjo hapje është e ndryshme për fusha të ndryshme.

Parimet e vendosura nga gjyqtari administrativ, për të kontrolluar veprimtarinë e administratës, përfshirë këtu edhe parimin e ligjshmërisë, nuk kanë të bëjnë shumë me interpretimin e ligjeve. Ky përfaqëson një veprimtari të ndërtimit të së drejtës. E njëjta gjë është edhe me gjyqtarin kushtetues, kur ai sajton një sistem kompleks të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive, duke u nisur nga ligje tepër lakonike, si deklaratat e të drejtave. Ky është *a fortiori* rasti kur rregullat e parimet nuk mund të lidhen me asnjë ligj, siç ndodh rëndom me raste të tjera.

Liria, me të cilën gjyqtari kushtetues dhe ai administrativ po i japin vetes, për të ndërtuar një të drejtë të re, po përhapet si një sëmundje ngjitëse edhe në juridiksionet civile dhe, në përmasa më të vogla edhe, në ato penale. Depërtimi i parimeve kushtetuese të të drejtave të tjera po e bën këtë përhapje të pashmangshme. Kjo liri, e cila pritet nga pozicioni i papërkrahshëm i shkollës së interpretimit dhe kritikës, tregon se moskufizimi i kompetencës së gjyqtarit në lidhje me ligjvënësinë ka ndryshuar rrënjësisht me kalimin e kohës, duke humbur rreptësinë e vet.

Parimi i rezervës së ligjit është, edhe ai gjithashtu, burim i shumë pasigurive. Ai nuk kënaqet të sigurojë respektin formal dhe material të lidhjeve hierarkike që ndërmarrin nenet dhe normat në një rend juridik. Ai kërkon që çdo vendim gjyqësor ose administrativ të gjejë mbështetje në një bazë ligjore të mjaftueshme. Ai përmban një seri kërkesash të cilat do të kufizohemi t'i paraqesim shkurtimisht.

Kërkesa e parë ka të bëjë me bazën ligjore formale. Me qëllim që kjo bazë të jetë e mjaftueshme, duhet që elementet e rëndësishme të rregullimit të figurojnë në ligjin formal të miratuar në Parlament (dhe/ose nga populli në demokracinë e drejtpërdrejtë). Çështjet dytësore mund të pasqyrohen në

rregulloret e zbatimit. Kjo kërkesë tregon paqëndrueshmërinë e vet në shumë pikëpamje. Së pari, ajo ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme me kalimin e kohës dhe, së dyti, shfaqen shumë hezitime atëherë kur bëhet fjalë për përcaktimin e fushave të veprimit ku ajo nevojitet. Më tej duket se kërkesa ndryshon, përsa i përket intensitetit, nga njëra fushë në tjetrën.

Fillimisht kemi ndryshimin në kohë. Ajo kërkesë, që në shekullin XIX kishte të bënte vetëm me kufizimin e lirive dhe heqjen e taksave (GRISEL 1984, vëll.I-rë:312) dhe me parlamentet që rezervoheshin (nga ku vjen terminologjia e rezervës, *Vorbehalt*), u shtri progresivisht në një numër vendesh të rregullat e organizimit dhe të masat nxitëse (*Leistungsverwaltung*) (GRISEL 1984, vëll.I-rë:317)². Megjithatë, mendohet që një shtrirje në të gjithë veprimtaritë e shtetit (*Totalvorbehalt*) nuk është e përligjur dhe do të kontribuonte në paralizimin e tij (GRISEL, po aty:318). Mirëpo lista e veprimtarive shtetërore, që do të mund të zhvilloheshin pa bazë ligjore formale, nuk mund të ndërtohet aq lehtë. Mund të flasim këtu për veprimtaritë ndihmëse të administratës, për dhënien e huave të veçanta jo aq të mëdha³.

Vihet re se fusha të tëra i shpëtojnë kërkesës. Pasiguria atëherë lind kundërshti që nxisin përjashtimin e disa fushave. T'i lejosh shtetit të kufizojë përdorimin e fushës publike, edhe pa bazë ligjore, tregon, le të themi, një konceptim të vjetëruar lidhur me përvetësimin në mënyrë shpërdoruese të një pronari privat, i cili mund të veprojë si të dojë në sferën e vet të zotërimit (MALINVERI 1981:136). Kundërshtohet vlefshmëria e detyrimeve të paparashikuara nga ligji, veçoritë e të cilave të bindin të pranosh në mënyrë kontraktore⁴. Koncepti, sipas të cilit shteti, pa bazë ligjore, mund të rregullojë

² X. Oberson, Ligjshmëria: Një parim me gjeometri të ndryshueshme, 1992: 91.

³ Për këtë rregull në Zvicër shih: P. Richli, "Subventionen obne gesetzliche Grundlage", Recht 1990:58.

⁴ Për këtë çështje shih P.MOOR 1988: 316; F. BELLANGER 1992: 67.

disa raporte të posaçme të varësisë (ushtarake, funksionare, të brendshme, të studentëve etj.), vjen nga një koncept i vjetëruar tashmë për lidhjet mes shtetit dhe këtyre njerëzve⁵.

Kur një bazë ligjore formale është e nevojshme, diskutohet shumë për atë, që përbën thelbin e çdo fushe, i cili do të duhet të rregullohet nga ligji. Çdo situatë duket e veçantë. Kërkesa përcakton nga njëra anë teknikën e bilancit, duke lënë mënjanë vlerat që militojnë në favor të asaj që saktëson ligji dhe nga ana tjetër konsideratat praktike që përlligjin hapjen e tyre. Nëse parimi i ligjshmërisë bëhet i veçantë në këtë pikë, nuk do të çuditëshim që ligji vetë të humbiste kapacitetin përgjithësues dhe përjashtues të të gjitha rrethanave të veçanta.

Po kështu ndodh me rezervën formale që përshkruan se në rast të delegimit legjislativ elementet më të rëndësishme të rregullimit figurojnë në ligj. Edhe kjo linjë e dytë e mbrojtjes së ligjshmërisë formale, që ne e quajmë rezervë përfundimtare (MORAND 1989a: 141), në kundërshtim me të parën që është e përkohshme, nuk është e vizatuar shumë qartë. Gjithashtu, është një metodë impresioniste, pa skematizma, një karakteristikë e thjeshtë që lejon të thuhet me shumë përparësi se cilat janë elementet më të rëndësishme, të cilat, sido që të jetë, duhet të figurojnë në një ligj (MOOR 1988: 310, 311).

Një kërkesë e fundit është që, qoftë ligji formal, qoftë ligji material, qoftë të dy tipet e rregullimit të marra së bashku, të kenë një dendësi normative të mjaftueshme (*Bestimmt-heitserfordernis*). Sipas kësaj kërkesë do të duhej që ligji të mos i japë administratës një liri vlerësimi të ekzagjeruar ose ajo të mos e furnizojë atë me liri gjykimi të tepruar nga fakti i përdorimit të nocioneve të papërcaktuara mirë. Kërkesa ka një përmasë europiane, përderisa ajo është pjesë e minimumit të kërkuar nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut në planin e ligjshmërisë.⁶ Kriteri, sipas të cilit që dendësia norma-

⁵ Shih R. ZIMMERMANN 1992:117.

⁶ Për këtë shih, për shembull, T.B.Borer 1986:315.

tive të jetë e mjaftueshme, është tepër i paqartë dhe është paradoksale që kërkesa e përcaktimit të nocioneve të bëhet nëpërmjet një kriteri kaq të papërcaktuar.

Kërkesa e dendësisë normative është, përveç kësaj, e lëkundshme, sepse politikat publike të ndërhyrjes nuk janë strukturuar që të mund të lejojnë mbajtjen e qëndrimeve, duke u nisur nga nocione të sakta, por përfshijnë programe të finalizuara dhe marrin formën e shqiptimit të objektivave e të mjeteve (MORAND 1989a: 141). Këto programe, kur arrijnë të shënojnë kufijtë e veprimitarisë së shtetit, nuk *parashkruajnë* më (MOOR 1988: 159); ato nuk janë të formuara nga norma që kanë një strukturë kushtëzuese; ato nuk lejojnë të veprohet me përfundime të vërteta të nxjerra me ndihmën e silogjizmave (MORAND 1989a: 141). Parimi i bazës ligjore, i cili kërkon që legjislacioni të ketë një minimum dendësie normative, është minuar strukturalisht nga politikat publike moderne (MORAND 1989a: 141). Qysh atëherë ai është bërë edhe më tepër i pasigurt.

Në fund të këtij hetimi të shkurtër intuita jonë e parë duket e konfirmuar në mënyrë të shkëlqyer. Asgjë nuk është më e sigurt, e ndryshueshme, e lëvizshme sesa parimi i ligjshmërisë, në sajë të të cilit, megjithatë, bëhen të mundura siguria dhe parashikueshmëria e së drejtës.

Për thjeshtëzim ne kemi paraqitur parimet e epërsisë dhe të rezervës që kanë një vlerë universale në regjimet demokratike dhe liberale. Ky universalitet nuk është i kundërshtueshëm për sa i takon parimit të parësisë dhe atij të kërkesës së një baze ligjore në veprimin e gjyqtarit ose të administratës. Përkundrazi, nocioni i rezervës, i cili shërben për të përcaktuar nëse një bazë ligjore është e mjaftueshme, gjen origjinën e vet në ndarjen e pushtetit legjislativ, ashtu si ekzistonte ai në mesin e shekullit të XIX-të në monarkinë kushtetuese gjermane (GRISEL 1984 vëll.I-rë:312; AUER 1981:259). Ai është tepër larg të qenit universal. Veçojmë akoma: kërkesat lidhur me dendësinë normative, që duhet të veshë ligji formal, i kanë rrënjët e tyre në

vendet si Zvicra ose Italia⁷, edhe pse këto vende nuk kanë njohur në historinë e tyre një situatë të krahasueshme me atë që nocioni i rezervës ka marrë në Gjermani. Ato duken, përkundrazi, të panjohura në Francë, ku ligjshmëria përmbledhet për të kërkuar përshtatje me të drejtën (VEDEL/DELVOVE 1990, vëll.1: 442). Kjo shpjegohet me faktin që për një kohë të gjatë dekretligjet ishin të ndaluara. Kushtetuta e vitit 1968 (neni 38), nga ana e saj, nuk e ka gjykuar të arsyeshme të kufizojë gjerësinë e delegimit legjislativ në këtë mënyrë, por ka zgjedhur imponimin pikërisht të kufijve kohorë dhe proceduralë. Praktika e delegimit nuk u zhvillua, përveç kësaj, për arsye të cilat, po t'i shtjellonim këtu, do të shkonte pak gjatë. Në këto kushte, nuk është ndier nevoja e kufizimit të asaj që parlamenti duhet të rregullonte patjetër dhe të asaj që mund të delegonte legjitimisht. Në Britaninë e Madhe sovraniteti i Parlamentit dhe mungesa e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve bëjnë që ky problem të mos shtrohet fare. Çdo mendim përqendrohet në interpretimin e pushteteve të deleguara.

Për sa i përket kërkesës për njëfarë dendësie të ligjit formal ose material (*Bestimmtheitserfordernis*), kjo është një problematikë më universale. Këtë e dëshmon fakti që ajo bën pjesë tek ai minimum tepër i reduktuar që imponon Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në lëndën e mjaftueshmërisë së bazës ligjore. Megjithatë, ky problem, i cili shtrohet pothuajse në të gjitha vendet, nuk është problematizuar kudo në këndin e parimit të ligjshmërisë. Në Britaninë e Madhe, ku Qeveria nuk ka kompetenca të tjera përveç atyre që i atribuon ligji, bëhet fjalë për një çështje të thjeshtë interpretimi të pushteteve të dhëna. Në fakt, atribuime të paqarta nuk i kënaqin kërkesat e *Common Law*.

Do të theksonim se pasiguria nuk ka kursyer edhe të drejtën penale. Jo vetëm se aty ka, si edhe në sektorët e tjerë të së drejtës, një pjesë krijuese të veprimtarisë gjyqësore, por edhe sepse problemi i rezervës së ligjit formal

⁷ Shih nenin 76 të Kushtetutës Italiane.

ka ardhur së bashku me të drejtën penale administrative. Në të drejtën zvicerane shikojmë që ligjvënësi duhet të krijojë inkriminimin dhe të parashikojë sanksionin, por përcaktimi i elementeve përbërëse të shkeljes mund t'i delegohet Qeverisë (ROTH 1992). Problemi shtrohet edhe në të drejtën penale të zakonshme me kryerjen e shkeljeve pak “të natyrshme”, si ato të qarkullimit të parave të pista ose shkelje që “cenojnë interesat në saje të mekanizmave gjithmonë e më komplekse, si rrjedhim, më të vështira për t'u përshkruar” (GRAVEN 1992). Problemi i dendësisë normative të ligjit penal po bëhet së fundmi shumë i mprehtë. Legjislacioni duhet, në fakt, të shmangë dy tipe rreziqesh: atë që vjen si pasojë e përdorimit të nocioneve tepër të paqarta dhe atë që lind nga përshkrimet tepër të detajuara (GRAVEN 1992).

II ROLI I TË DREJTËS SË SHKRUAR

Tekstet ligjore janë të rralla, më shumë deklaruese ose simbolike. Për jurisprudencën ato nuk përbëjnë gjë tjetër përveçse një burim frymëzimi mes shumë të tjerave. Nëse do krahasojmë atë që është thënë nga gjykatat lidhur me kërkesat ndaj ligjshmërisë dhe disa teksteve ligjore që i trajtojnë ato, do të habiteshim me rrallësinë e këtyre të fundit.

Teksti me më shumë fjalë është Deklarata e vitit 1789. Sipas nenit 4, kufijtë e lirisë “mund të caktohen vetëm nga ligji”. Sipas nenit 5, “ajo që nuk është e mbrojtur nga ligji nuk mund të jetë e ndaluar dhe asnjëri nuk mund të detyrohet të bëjë atë që ai nuk e urdhëron”. Ky është një formulim i mirë i kërkesës tradicionale me bazë ligjore. Ka edhe shumë garanci të tjera: “Asnjë njeri nuk mund të akuzohet, arrestohet dhe të burgoset përveçse sipas rasteve të përcaktuara nga ligji dhe sipas formave që ai parashkruan”, thotë neni 7. “Asnjëri nuk mund të dënohet përveçse sipas ligjit të hartuar dhe nxjerrë para kryerjes së krimit, dhe që është ligjërisht i zbatueshëm”, shton neni 8. Këto formula janë kaq të bukura, ato ngjajnë si të gdhendura në mermer dhe kanë qenë konsideruar për pothuajse dy shekuj me vlera politike dhe jojuridike. Ato kanë ushqyer jo pak jurisprudencën, e cila ka gjetur në deklaratë një

grumbull mësimesh, të cilat mund t'i nxirrte sa herë do kishte nevojë.

Në Kodin Civil zviceran, parësia e ligjit dhe kërkesa e bazës ligjore dalin nga neni 1 i Kodit Civil të titulluar “zbatimi i ligjit”. Ky nen i lidh kërkesat me formulën e njohur që parashikonte se në mungesë të një dispozite ligjore të zbatueshme dhe një zakoni, gjyqtari vendos sipas atyre rregullave që ai do të hartonte nëse do të kishte qenë ligjvënës. Shumë kode penale thonë shprehimisht, ashtu si edhe Kodi Penal zviceran, neni 1, se “asnjë njeri nuk mund të dënohet nëse nuk ka kryer një vepër shprehimisht të dënueshme nga ligji”.

Pa mohuar rëndësinë simbolike, ndonjëherë edhe reale të këtyre ligjeve, vërejmë se ato shpesh nuk bëjnë gjë tjetër veçse rikujtojnë parimet themelore, të cilat do të ishin imponuar edhe pa qenë në tekste. Gjithashtu, vërejmë se domethënia e tyre mund të ndryshohet në mënyrë të konsiderueshme, në qoftë se ndryshojnë edhe rrethanat.

Karakterit deklarues i teksteve ligjore për ligjshmërinë penale është i dukshëm po të marrim parasysh që ato i bien po asaj muzike të vjetër, si *nullum crime, nulla poena, sine lege*, ose thonë të njëjtat porosi që gjenden edhe në tekste politike si Deklarata e të Drejtave të Njeriut. Në projektin e Kushtetutës së Zvicrës të vitit 1977, neni 23 thotë se “kufizimet e të drejtave themelore kërkojnë një bazë ligjore; ato më të mëdhatë duhen të jenë edhe të parashikuara shprehimisht nga ligji”. Pra, nuk bëhet gjë tjetër veçse shprehen në mënyrë sintetike rregullat e hartuara progresivisht nga jurisprudenca, të cilat nuk janë bazuar në ndonjë dispozitë të shprehur në Kushtetutë.

Ligjet, që shkruhen lidhur me kërkesat për bazë ligjore, duket se kanë një vështirësi të veçantë për t'i rezistuar nevojave që i dalin shoqërisë. Kjo ngjan pak sikur praktika të tallej me tekstet ligjore dhe të thurte pëlhurën e vet në mënyrë të tillë që t'i bënte të palexueshme fragmentet e ligjshmërisë së shkruar. Kjo duket fare mirë, si për sa i përket teksteve që forcojnë ligjshmërinë, ashtu edhe për ato që e zbusin atë. Heqja e së drejtës për të

marrë “vendim për rregullore”, që i bëhet gjyqtarit nga neni 5 i Kodit Civil francez nuk e ka penguar jurisprudencën të bëhet një burim i rëndësishëm i të drejtës dhe nëse ajo është burim i të drejtës, kjo ndodh pikërisht sepse *ratio decidendi* i vendimeve përbën një rregull të përgjithshëm dhe abstrakt, duke u zbatuar në të ardhmen sa herë që një situatë e ngjashme do të paraqitet. Një shembull tjetër: heqja e së drejtës, e shprehur nga dekretligjet e kohës së Republikës së IV është fshirë nga nevoja. Me gjithë dredhitë e bëra në vitin 1948, për ta rikthyer atë, që nga viti 1953 procedohet me delegime të mëdha legjislativ (HAURIOU 1970).

Në të kundërt, neni 1, paragrafi 2 i Kodit Civil zviceran, i cili i njeh gjyqtarit në rast vështirësish një pushtet krijues të konsiderueshëm dhe që ka bërë emër në kohën e vet si një risi e madhe, ka humbur sot një pjesë të madhe të origjinalitetit të vet. Në fakt, gjyqtarët që në traditën e Kodit të Napoleonit ishin poshtëruar prej ligjit, progresivisht kanë rinjohur pushtetin e krijimit të së drejtës, atëherë kur do të paraqitet nevoja. Nga ana tjetër, gjyqtari civil zviceran, nën ndikimin e doktrinës, e ka mposhtur zellin e madh krijues (ENGEL 1980, vëll.31:173; BERGEL 1989:71). Së fundi, pushteti krijues i gjyqtarit civil duket relativisht pak i rëndësishëm, po të krahasohet me atë që ushtron gjyqtari administrativ ose kushtetues. Lehtësia që i jepet gjyqtarit civil zviceran për të kaluar vështirësitë, është, nga pikëpamja e zhvillimit, tepër e thjeshtë. Fjala është për një ndërtim të ndërlikuar, që është bërë i nevojshëm nga pretendimi i ekzagjeruar i Kodit, për të siguruar një rregullore shteruese të të gjitha problemeve.

III. ARSYET E MUNGESËS SË STABILITETIT TË PARIMIT TË LIGJSHMËRISË

Karakterit i pasigurt dhe fleksibiliteti i parimit të ligjshmërisë mund të shpjegohen nga shumë faktorë.

Faktori i parë është që në shekullin XIX, ai ka mundur të zhvillohet në gjithë thjeshtësinë dhe pastërtinë e vet, pasi shteti ndërhynte pak, duke u

kufizuar në përshkrimin e një kuadri të shkëmbimeve, të jetës familjare dhe në kapjen e disa shkëlqeve relativisht të thjeshta. Me ndërlikimin e shoqërisë dhe ardhjen në fuqi të një shteti të fuqishëm, i cili filloi të nxjerrë edhe më shumë ligje, u vu re një ndarje mes ligjit formal dhe atij material. Dhe mbi të gjitha vetë shteti u angazhua, me ndërhyrjen e tij, në ndryshimin e një shoqërie të pastabilizuar, të njohur keq, duke bërë parashikime të pasigurta mbi efektet që mund të shkaktoheshin nga e drejta. Parimit të ligjshmërisë do t'i duhej të llogariste edhe veçoritë e kësaj mënyre të të bërit të ligjeve. Ai u prek thellë nga tensionet që ekzistonin mes modelit legjislativ dhe atij pragmatik të zgjidhjes së problemeve, i cili e përfshiu atë në një proces provash e gabimesh (MORAND 1989a: 153) dhe, që nga ai çast, në një orientim kaotik drejt realizimit të objektivave. Nën këtë presion atij iu desh të diferenciohej. Që atëherë ai ka trashëguar, në një farë mënyre, pasigurinë që karakterizon realitetin shoqëror mbi të cilin vepron ligji (MORAND 1989a: 147).

Faktori i dytë është se, nëse ligjshmëria ka qenë shprehur me një pastërti shumë të madhe në epokën Kodit të Napoleonit, kjo ka ndodhur sepse në Francë nuk kishin besim te parlamentet e regjimit të vjetër dhe, përveç kësaj, ekzistonte mendimi se ishte realizuar një vepër e përkryer, pothuajse e përjetshme. Doktrina për një ligjshmëri të pastër dhe të prerë mbështetej në idenë e perfeksionimit të kodit. Për aq sa ligjet duhet të interpretohen me shkathtësi, për të marrë parasysh ndërlikimet dhe transformimet e realitetit shoqëror, ndarja e prerë ndërmjet funksionit të krijimit të së drejtës prej ligjit dhe atij të zbatimit të saj në vendimet e drejtësisë do të ishte e megjulluar (RHINOW 1979). Kështu, ligji ka humbur karakterin e tij të shenjtë në atë masë që tekstet ligjore janë shtuar e janë përshtatur ose edhe janë copëtuar.

Faktori i tretë ka të bëjë me natyrën e parimit të ligjshmërisë, me faktin që ai nuk përfshin një rregull, por një parim të përgjithshëm të së drejtës. Ky dallim mes këtyre dy tipe normash, rregullash dhe parimesh (ALEXY 1986:71) është vendimtar për të kuptuar pasigurinë që fshehin këto të fundit. Ndërsa përshkruajnë, rregullat thonë atë që duhet ose që nuk duhet bërë. Ato i lënë

vend një arsyetimi që nxirret si përfundim i një krahasimi mes fakteve dhe atyre që ajo parashikon (ALEXY 1986:76). Përsa i përket parimeve, ato përfshijnë një proces konkretizimi dhe optimalizimi. Zbatimi i tyre varet jo vetëm nga realizimi i disa fakteve, por edhe nga një krahasim me parime të tjera dhe rregulla të kundërta. Kështu, për shembull, shkalla e saktësisë së bazës ligjore formale duhet të vihet në balancë me parime të tjera, si nevoja urgjente për rregullim, karakteri teknik i këtij rregullimi, ndryshueshmëria e dukurive mbi të cilat ajo vepron etj. Pra, parimet bashkohen me objektivat, të cilat, edhe ato vetë, nuk mund të jenë të zbatueshme në një rast të veçantë, por që duhet të jenë të konkretizuar. Ndryshimi është se objektivat nuk kanë prirje për t'u shndërruar në rregulla të sakta (MORAND 1989: 854). Këto të fundit janë thjesht mjete që mund të shërbejnë për të arritur objektivat.

Pasiguria e parimeve është e pandashme me to. Duke qenë pjesë e asaj që duhet të jetë “ideale”, në kundërshtim me atë që duhet të jetë “reale” (ALEXY 1986:120), parimet janë në konflikt me parime të tjera. Vetëm në situatën konkrete të çdo rasti dhe si vazhdim i vlerësimit të rolit që duhet të luajë parimi i ligjshmërisë në lidhje me konsideratat e tjera, mund të hiqet një rregull, i cili do të lejonte nxjerrjen e përfundimeve. Pasiguria e parimeve zgjat aq sa kalimi në akt, domethënë në një rregull, nuk është kryer. Mund të shikojmë kështu, përse parimi i ligjshmërisë nuk mund të jetë i pajisur me vetinë e sigurisë dhe të parashikueshmërisë që mendohet se ai mund të krijojë. Ky konstatim i dobëson dhe i ndërvar atributet që mund t'i japim të drejtës. Që prej shumë kohësh dihej se ideologjia juridike maskonte pasigurinë që lindte në tekstet ligjore nga fakti i interpretimit. Këtu zbulojmë një tip të dytë të pasigurisë, edhe më të fshehtë, që ka të bëjë me mënyrën me të cilën tekstet ligjore duhet t'i trajtojnë qëndrimet e parashikuara, të ndaluara, të autorizuar. Do ta analizojmë, sipas shijeve, këtë fshehje të dyfishtë rreth pasigurisë së të drejtës, si një dinakëri e pushtetit, një e keqe e domosdoshme ose një gënjeshtër me bisht.

IV. PËRSE KJO DOBËSI NË TEKSTET E SHKRUARA?

Ndikimi tepër i kufizuar i teksteve i detyrohet edhe ai faktit që aspekte të ndryshme të ligjshmërisë përbëhen nga parime të përgjithshme, të cilave jurisprudenca u jep jetë dhe forcë.⁸

Epërsia e parimeve të moduluara nga jurisprudenca rrjedh nga ndikueshmëria dhe prejardhja e tyre. Konturet e parimit të ligjshmërisë varen, në një moment të dhënë, nga lidhjet që jurisprudenca krijon midis vlerave demokratike dhe liberale, nga njëra anë, dhe atyre që bien mbi realizimin e frytshëm të detyrave publike nga ana tjetër. Këto lidhje nuk janë vendosur njëherë e përgjithmonë. Ato janë në një rindërtim të përhershëm. Duke bërë aluzion me teknikën e peshores, vëmë nga njëra anë e saj rëndësinë që duhet t'i kushtohet secilit nga parimet ku bazohet ligjshmëria në një fushë të caktuar dhe, nga ana tjetër, nevojat e veçanta të fushës, të cilat justifikojnë një lehtësim të këtyre kërkesave. Për të marrë disa shembuj, e shohim të arsyeshme që në fushën e lirive, kufizimet e tyre duhet, në thelb, të parashikohen nga ligjvënësi formal. Për sa i përket kushteve të mbajtjes në burg të të burgosurve, ato, pa asnjë problem, fare mirë mund të figurojnë në një rregullore, e cila, megjithatë, duhet të ketë një dendësi normative, për të parandaluar shpërdorimet e autoriteteve. Edhe dhënia e huave duhet të bëhet sipas atyre rregullave që bëhet kufizimi i lirisë, veçse mospranimi mund të çojë në cenime të rënda të interesave të caktuar. Në rast të kundërt mund të kënaqemi me disa rregulla të përgjithshme të adoptuara nga qeveria ose administrata. Megjithatë, do të pranohet këtu se disa ndihma fikse dhe të papërsëritshme mund të jepen edhe pa bazë legale, mjaft që të jetë e pasqyruar në buxhet etj.

Rregullimi i parimit të ligjshmërisë me çdo lloj veprimtarie shtetërore është një vepër pretoriane, të cilën ligjvënësi nuk do ishte i aftë ta përmbushte. Jemi mësuar aq shumë me pushtetin e plotë të ligjit, sa që do ishte e vështirë

⁸ Shih: Lidhja mes jurisprudencës dhe parimeve, J.- L.BERTEL 1989:90.

njohja e mospërshtatjes së tij funksionale me disa mënyra të krijimit të së drejtës. Por duhet vënë në dukje se në sistemet e së drejtës së shkruar, si edhe në regjimet e *Common Law*, baza e së drejtës është vepër e jurisprudencës. E drejta e shkruar është një mbistrukturë që i mbivendoset një strukture bazë, e cila është e formuar prej dhjetëra parimesh të së drejtës. Këto lejojnë, nëpërmjet trukimit të një procesi konkretizimi progresiv, t'u japin zgjidhje grindjeve konkrete. E drejta e shkruar shkon, por parimet, për shkak të numrit dhe ndikueshmërisë së madhe, mbeten. Kuptohet qartë se në këto kushte Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka konsideruar se jurisprudenca mund të luajë një rol pothuajse po aq të rëndësishëm si në vendet e kontinentit, ashtu edhe në ato të *Common Law* ⁹.

Epërsia e parimeve shpjegohet, gjithashtu, edhe nga prejardhja e tyre logjike. Kjo prejardhje ka qenë vënë në dukje për sa i përket parimeve që janë në baze të ligjeve. DOMAT-i, në marrëveshjen e tij mbi ligjet, fliste që atëherë për parimet e para të çdo ligji (BERGEL 1989: 85). Varësia në të cilën gjenden ligjet në raport me parimet i ka çuar disa ta përshkruajnë procesin e formimit dhe të zbatimit të së drejtës si përfshirës të tri niveleve. Dy janë nivele klasike, ai i formimit të ligjit dhe ai i zbatimit të tij. Një nivel suplementar, i cili i mbivendoset të parëve, është ai i krijimit të normave bazë (*Grundsatznorm*) (KAUFMANN 1972: 162; RHINOW 1979). Kjo epërsi e parimeve është logjike dhe funksionale. Ndodh ndonjëherë që ajo të shprehet në hierarkinë e akteve dhe normave shtetërore. Në Francë, Këshilli Kushtetues ka ngritur në rang normash kushtetuese të drejtat dhe liritë e lejuara nga parimet themelore që njihen nga ligjet e republikës, të cilave u referohet hyrja e Kushtetutës së vitit 1946 (LUCHAIRE 1980: 29, 134, 163, 247; GENEVOIS 1988: 332, 363; FAVOREU/PHILIP 1986: 383, 385, 510). Ngritja e një kontrolli rreth përshtatjes së ligjeve me parimet e përgjithshme

⁹ Mbi këtë jurisprudencë të Gjykatës, shih G. MALINVERI, f.403 (vep. i cituar, shënimi 6).

të së drejtës është paraqitur si paralajmërim i kontrollit të kushtetutshmërisë. Në Regjimin e Vjetër parlamentet i lejonin vetes të drejtën e kontrollit të vlefshmërisë së ligjeve dhe të rregullimit në raport me ligjet themelore të mbretërisë¹⁰. Edhe në Angli, është gjetur një gjyqtar, Lord Coke, i cili shpalli pavlefshmërinë e ligjeve që kanë neveri ndaj *Common Law and reason*¹¹.

Në të njëjtën mënyrë mund të konsiderojmë se prapa rregullave kushtetuese ka parime themelore që u mbivendosen vetë këtyre rregullave, parime pa të cilat ato nuk do të mund të funksiononin ose që janë të pandara me regjimin politik të vendit. Pjesë e këtyre parimeve është edhe ai i ligjshmërisë, përkrah atij të barazisë, të përpjestueshmërisë etj.

Nga një këndvështrim funksional dhe logjik këto parime janë mbikushtetuese¹². Ligjet kushtetuese mund të përmbajnë rregulla që ndryshojnë nga ato që, përgjithësisht, dalin prej parimit të ligjshmërisë. Nga ana tjetër nuk është e mundur që ato të heqin dorë nga vetë parimi. Kjo do të ishte sikur të fusje me vetëdije të plotë anarkinë me heqjen e parimit, i cili siguron respektimin e ndërtesës hierarkike të rendeve juridike, çka do të ishte pikërisht mohimi i idesë së kushtetutës. Gjithashtu, kjo do të ishte sikur të hartojë një rregull kontradiktore me të gjitha ato që përbëjnë thelbin e regjimit politik në fjalë.

Mbikushtetutshmëria e parimeve themeluese të një regjimi, që ndonjëherë madje i quajmë edhe parime strukturore¹³, është, megjithatë, relative. Duke qenë të shumta, këto parime janë të parishikueshme, sa ndryshon edhe regjimi. Në rast ndryshimi themelor të këtij të fundit, me rrugë ligjore ose

¹⁰ Shih CAPELLETTI, vep. e cituar, (shën. 2), f.462.

¹¹ Po aty.

¹² Për mbikushtetutshmërinë, shih RIALS 1986:57. Në Francë koncepti fillon me DUGUIT-in, i cili e zbatoi në Deklaratën e 1789-s.

¹³ Mbi hierarkinë e parimeve strukturore në një rend juridik, shih P. MASTRONARDI 1988:24.

revolucionare, parimi mund të ndryshohet ose të zhduket. Supremacia e parimeve është kështu funksionale dhe e përkohshme dhe jomateriale e përfundimtare, siç është rasti i Gjermanisë, ku është krijuar një mekanizëm me qëllim sigurimin e përjetësisë së tyre¹⁴.

Në një regjim demokratik e liberal ka një pamundësi logjike, për të hequr dorë nga parimet themeluese. Përvoja tregon se edhe një regjim revolucionar, cili tenton të predikojë vlera të tjera, nuk guxon t'i heqë. Ai do të donte më mirë t'i shtrembëronte ato. Gjithashtu ai do të mund të shtonte parime të tjera që frymëzohen nga vlera të kundërta, duke u nisur nga fakti se ideologjia që fsheh kushtetuta do të bënte të vlerësoheshin këto të fundit.

Zgjidhja që konsiston në njohjen e përparësisë logjike dhe funksionale të parimeve themelore i vendos shpinë më shpinë partizanët dhe kundërshtarët e kufijve materialë për rishikimin e kushtetutës. Nëse është e saktë se nuk mund të përlligjet ekzistenca e kufijve materialë të pakapërcyeshëm për rishikimin e kushtetutave, ka kufij funksionalë dhe logjikë që nuk mund të ndryshohen përveçse nëpërmjet një ndryshimi të plotë të regjimit.

Mbikushtetutshmëria e parimit të ligjshmërisë, megjithatë, ka gjetur një konfirmim formal, ashtu siç edhe e kemi parë, duke u bërë pjesë e së drejtës në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Porse ky konfirmim është i pjesshëm, pasi parimi njihet vetëm për sa i përket kufizimit të të drejtave dhe lirive të Konventës dhe kundrejt densitetit normativ, domethënë të shkallës së saktësisë të gjykuar si e nevojshme që një ligj formal ose material të mund të përbëjë një bazë ligjore të mjaftueshme për një vendim kufizues të lirisë.

Mbikushtetutshmëria e parimeve lejon të spjegohet pushteti krijues që juridiksionet kushtetuese japin për njohjen e lirive të reja. Këto të fundit, ndërsa shpallen në kushtetutë, janë parime që nuk mund të kthehen në

¹⁴ Shih nenin 79, paragrafi 3, i ligjit themeltar gjerman.

rregulla, përveçse në përfundim të një hartimi të gjatë jurisprudencial, i cili nënëzon një seri parimesh që justifikojnë kufizimet që mund të bëhen (interesa publike, ligjshmëri, pjestueshmëri, barazi). Shprehja e tyre në kushtetutën demokratike dhe liberale është vetëm deklarative. Liritë, thelbësore për funksionimin e një regjimi të këtij lloji, nuk kanë nevojë të figurojnë shprehimisht në Kushtetutë. Ato mund të zbulohen në një juridikson kushtetues. Kjo dukuri shpjegon përse Gjykata federale njohu ekzistencën e të drejtave kushtetuese të pashkruara (ROSSINELLI 1987).

Gjithashtu, kuptojmë se në teori mund të kishim thënë, dhe kjo të habit në vështrim të parë, se burimi i drejtpërdrejtë i të drejtave kushtetuese në Zvicër ndodhet në jurisprudencë dhe se teksti kushtetues nuk është veçse burimi i tërthortë i tyre (AUER 1983). Në të njëjtën mënyrë Gjykata e Bashkësive ka konsideruar se kishte, gjithmonë brenda kufijve të traktateve kushtetuese, parime të përgjithshme që ofrojnë si të drejtë komunitare mbrojtjen e lirive, pak a shumë të njëjtë me shtetet anëtare (LOUIS 1989:95). Prej kësaj veprimtarie krijuese, Gjykata nuk kufizohet në njohjen e disa të drejtave dhe lirive. Ajo krijon një rrjet të tërë parimesh, të cilat, pasi formulohen, prodhojnë rregulla që lejojnë zgjidhjen e grindjeve konkrete.

Kështu në fushën e lirive, e cila ka qenë djepi i parimit të ligjshmërisë, afirmohet epërsia e jurisprudencës mbi ligjet, qofshin ato edhe kushtetuese, në atë masë që ajo u jep jetë parimeve të përgjithshme të së drejtës. Duke u ngritur mbi kushtetutat demokratike e liberale, ka vend për vlera themelore, shprehje të së drejtës njerëzore, së cilës duhet t'i nënshtrohen ligjet. Ndoshta nuk shprehin gjë tjetër, veç asaj që thotë zonja GOYARD-FABRE, kur pyet për legjitimitetin e ligjshmërisë. Për dijeni, a “përkufizohet ligjshmëria gjithmonë me të njëjtën kërkesë të pastër e të përsosur mbi paraqitjen e nevojës së arsyes e cila e bën njerëzimin prej njeriut”¹⁵. Duket se i

¹⁵ Shih: S. GOYARD-FABRE, “Bazat e ligjshmërisë”, supra, 29.

¹⁶ Shih: G. VEDEL “Hyrje”, supra, 1.

bashkohemi, gjithashtu, edhe Doyen VEDEL-it, i cili, në parathënien e këtij libri, tregon se ligjshmëria “nuk do mund të gjente te vetja bazën e saj” dhe që “nuk mund ta mendojmë atë pa menduar në të njëjtën kohë për mendimet që e lidhin me botën e jashtme dhe me atë sipërane”¹⁶

Monitorimi i zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare”¹

Raport paraprak

*Përgatiti: Milaim Demnushaj
Qendra e Studimeve Parlamentare*

I. HYRJE

Qendra e Studimeve Parlamentare (QSP), me mbështetjen financiare të Fondacionit Shoqëria e Hapur (Soros) dhe Ambasadës Amerikane ka zhvilluar një monitorim për të vlerësuar zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”² në institucionet qendrore.

Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentet zyrtare. Monitorimi ka patur objekt vlerësimi detyrimet ligjore të autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacion mbi dokumente zyrtare.

Monitorimi synon të vlerësojë situatën në zbatimin e ligjit, të evidentojë problemet që janë shfaqur, si dhe të ndihmojë në hartimin e rekomandimeve të nevojshme dhe adresimin në mënyrën e duhur të çështjeve që do t’i shërbejnë një zbatimi sa më të plotë të së drejtës themelore të qytetarëve për të marrë informacion.

¹ Ligji nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

² Ligji nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

II. METODOLOGJIA

Zbatuesit e projektit për zhvillimin e monitorimit fillimisht bënë një analizë të kuadrit ligjor të së drejtës së informimit. Gjatë analizës u konsultuan Kushtetuta, ligjet bazë për të drejtën e informimit, për mbrojtjen e të dhënave vetjake, për informacionin e klasifikuar, si dhe aktet nënligjore përkatëse. Gjithashtu, u vlerësua jurisprudenca e disponueshme në këtë fushë, si dhe raporte të tjera.

Pas analizës u identifikuan standardet ligjore, të cilat duhet të respektohen nga autoritetet publike. Gjithashtu, u hartuan pyetsorët në bazë të këtyre standardeve, si instrumente të nevojshme për të mbledhur informacionin që kërkohet, për të bërë vlerësime sa më objektive.

Për kryerjen e monitorimit u angazhua një grup prej 6 monitoruesish, nga të cilat katër ishin studentë të Fakultetit të Drejtësisë. Përpara se të kryhej monitorimi, u zhvillua një trajnim për njohjen me standardet ligjore të së drejtës së informimit, si dhe me teknikat e monitorimit.

Monitorimi u shtri në njëzet institucione qendrore. Për mbledhjen e informacionit për vlerësimin lidhur me zbatimin e standardeve u shfrytëzuan këto burime: intervista në bazë të pyetsorëve; vëzhgime nga vetë monitoruesit; konsultimi i dokumenteve dhe i faqeve të internetit aty ku ekzistonin.

III. INSTITUCIONET E MONITORUARA

1. Kuvendi i Shqipërisë
2. Presidenti
3. Këshilli i Ministrave
4. Ministria e Rendit Publik
5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës
6. Ministria e Punëve të Jashtme
7. Ministria e Shëndetësisë
8. Ministria e Drejtësisë
9. Ministria e Ekonomisë

10. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve
11. Ministria e Mjedisit
12. Ministria e Mbrojtjes
13. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
14. Ministria e Bujqësisë
15. Ministria e Integritit
16. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale
17. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit
18. Ministria e Industrisë dhe Energjistikës
19. Ministria e Financave
20. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

IV. DISA REZULTATE PARAPRAKE NGA VLERËSIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT NËPËRMJET MONITORIMIT

1. Standardi: Autoriteti publik nxjerr rregullore që rregullon marrjen e informacionit për dokumentet zyrtare nga publiku (neni 6).

1.1 Nga njëzet institucionet qendrore të monitoruara rezultojnë se vetëm në 2 institucione janë miratuar rregullore të veçanta për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare. Kjo përbën një nismë pozitive për zbatimin e ligjit në fjalë. Në këto rregullore ka dispozita të përgjithshme të ligjit për të drejtën e informimit dhe nuk përcaktohen rregulla të detajuara për realizimin e kësaj të drejte. Kështu, nuk përcaktohen qartë strukturat përgjegjëse, procedurat që ndiqen për dhënien e informacionit, lehtësitë që duhet të krijohen për qytetarët që kërkojnë informacion etj. Gjithashtu, në një nga këto rregullore vërehet se ka një kufizim të parashikimeve ligjore, duke përjashtuar nga detyrimi për publikim disa nga dokumentet që parashikon ligji në nenin 8 (b;c;ç).

1.2 Të njëzet institucionet e monitoruara kanë nxjerrë rregullore të brendshme për organizmin dhe funksionimin e administratës së institucionit. Në institucionet, ku nuk ka një rregullore të veçantë për të drejtën e informimit,

në rregulloren e brendshme nuk rezulton të jetë e rregulluar e drejta e informimit sipas kërkesave të ligjit për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare. Ka dispozita të shpërndara që lidhen me kërkesat ose pritjen e qytetarëve, por që nuk janë hartuar sipas kërkesave të ligjit të përmendur më sipër, si dhe dispozita që bien në kundërshtim me ligjin në fjalë. Pavarësisht se pjesa më e madhe e rregulloreve janë hartuar pas daljes së ligjit për të drejtën e informimit, rezulton se nuk janë patur parasysh detyrimet e këtij ligji.

1.3 Në institucionet, që nuk kanë një rregullore të veçantë, nuk ka një akt tjetër që rregullon marrjen e informacionit nga qytetari.

1.4 Rregulloret e brendshme të organizmit të institucionit, me përjashtim të dy institucioneve, nuk janë të bëra publike. Në një rast rregullorja është e disponueshme në faqen e internetit të këtij institucioni dhe në rastin tjetër është e botuar së bashku me një përmbledhje aktesh të tjera nga institucioni përkatës. Zakonisht rregullorja mund të merret me kërkesë. Ka patur raste kur punonjësit e shohin si një dokument konfidencial rregulloren ose në rastin më të keq nuk e dinë nëse ka rregullore ose jo institucioni ku punojnë.

2. Standardi: Autoriteti publik krijon lehtësi strukturore e praktike për marrjen e informacionit për dokumentet zyrtare nga publiku (neni 6).

2.1 Në nëntë nga institucionet e monitoruara ka zyra që kryejnë shërbimin e marrëdhënieve me publikun. Nuk ka një unifikim përse i përket strukturave dhe emërimit të zyrave që kryejnë këto shërbime. Për një informacion më të detajuar referohuni në aneksin nr.1 bashkëngjitur këtij raporti. Në institucionet, që kanë një zyrë për marrëdhëniet me publikun, zakonisht zyra është e hapur gjatë orarit zyrtar. Në tri nga zyrat për marrëdhëniet me publikun vlerësojmë se kanë pajisjet e nevojshme për kryerjen e shërbimit të informimit të publikut.

2.2 Në institucionet ku nuk ekziston një zyrë për marrëdhëniet me publikun qytetari duhet të adresohet në drejtorinë përkatëse që pretendohet se ka informacion, për të cilin ai është i interesuar. Zakonisht, në këto raste, pritja e qytetarëve bëhet në një orar të caktuar.

2.3 Në katër instucione zyra për marrëdhëniet me publikun është e vendosur në një pozicion ku bëhet lehtësisht e aksesueshme nga publiku. Në institucionet, ku është i angazhuar dhe shërbimi i Gardës së Republikës, ka vështirësi në hyrjen e qytetarëve. Nuk ka qartësi për pozitën dhe funksionet oficerëve të Gardës përsa i përket kontaktit dhe komunikimit me qytetarët që kërkojnë të hyjnë në institucionin përkatës. Kjo mund të krijojë një perceptim te qytetari se institucionet janë të mbyllura dhe, në të njëjtën kohë, mund të ngjallë një lloj frustrimi ndaj institucioneve publike që duhet të jenë në shërbim të tij. Duke mos lënë mënjanë çështjet e sigurisë, duhet që kjo të bëhet pa cenuar të drejtën e qytetarëve për të hyrë dhe për të marrë informacion në një institucion publik.

2.4 Nga njëzet institucionet e monitoruara, në dy prej tyre rezulton që të jenë nxjerrë akte për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Një akt pozitiv në këtë drejtim përbën Urdhri i Këshillit të Ministrave nr.164, datë 20.10.2004 «Për krijimin e faqeve të internetit për institucionet e administratës publike dhe përmbajtjen e tyre». Nga vlerësimi i faqes së internetit të Departamentit të Administratës Publike rezulton se kjo strukturë ka marrë nisma për zbatimin e ligjit në fjalë dhe urdhrin të përmendur më sipër. Në këtë faqe jepen të dhëna se si mund të kërkohet informacion dhe një formular i veçantë kërkesë.

2.5 Në 50 për qind të punonjësve, që punojnë në zyrat për marrëdhëniet me publikun, rezulton se ata njohin detyrimet e ligjit për të drejtën e informimit.

2.6 Në institucionet që nuk ka një zyrë të veçantë për marrëdhëniet me publikun, siç u përmend më sipër, bëhet kërkesë në drejtoritë përkatëse. Në këto raste është më e mundshme që punonjësit të mos njohin detyrimet e të drejtës së informimit dhe të mos respektojnë afatet dhe në të njëjtën kohë të shmanget përgjegjësia.

2.7 Vetëm në tri institucione ka shenja dalluese që ndihmojnë publikun për t'u orientuar në zyrën për marrëdhëniet me publikun.

3. Standardi: Autoriteti publik vë në dispozicion të publikut pa kërkesë

vendndodhjen e organit, si dhe emrat e punonjësve nga të cilët publiku mund të marrë informacion, të paraqesë kërkesë ose të marrë përgjigje (neni 8/a).

3.1 Dy nga institucionet e monitoruara kanë nxjerrë botime, ku jepet një informacion për strukturën e institucionit përkatës, por që nuk jepen detaje për procedurat e marrjes së informacionit. Ky botim është i disponueshëm në Bibliotekë.

3.2 Të dhëna për institucionet mund të gjenden në faqet e internetit të këtyre institucioneve. Nga njëzet institucione, vetëm në dy nuk ka një faqe funksionale. Nuk jepen të dhëna për marrjen e informacionit dhe për punonjësit përkatës, me përjashtim të faqes së Këshillit të Ministrave dhe DAP-it.

4. Standardi: Autoriteti publik vë në dispozicion të publikut pa kërkesë rregullat, procedurat dhe mënyrat se si mund të merren formularët e ndryshëm, shpjegime për qëllimin dhe përmbajtjen e tyre ose të dokumenteve dhe të vërtetimeve të nevojshme për plotësimin e formularëve (neni 8/b).

4.1 Në dy institucione, nga institucionet e monitoruara, rezulton që të jenë hartuar formularë të veçantë për të drejtën e informimit. Këto nuk janë të shoqëruar me dokumente shpjeguese për plotësimin e tyre. Këtu përmendim, gjithashtu, një model kërkesë të përgjithshme të hartuar nga DAP-i që është i disponueshëm nëpërmjet faqes së internetit të kësaj strukture.

4.2 Në institucionet ku ekzistojnë zyrat për marrëdhëniet me publikun jepen shpjegime gojarisht për kërkesat që duhet të bëhen. Në këto raste nuk ka një format të caktuar, por kërkesat bëhen sipas formatit të zakonshëm.

5. Standardi: Autoriteti publik vë në dispozicion të publikut pa kërkesë rregullat e përgjithshme ligjore, sipas të cilave vepron autoriteti publik, si dhe ndryshimet e bëra në to (neni 8/c).

5.1 Për sa i përket rregullave të funksionimit të institucioneve duhet të bëhet dallimi ndërmjet rregullave të funksionimit të institucionit si organ kushtetues ose ligjor nga rregullat brendshme të funksionimit të administratës

së këtyre institucioneve. Rregullat e para janë të botuara kryesisht në Fletoren Zyrtare ose janë të bëra publike në faqet e internetit të këtyre institucioneve. Nga njëzet institucionet e monitoruara, në një institucion rezulton që rregullat e funksionimit të administratës së këtij institucioni janë bërë publike nëpërmjet faqes së internetit. Rregulloret e brendshme për institucionet e tjera nuk janë të botuara në Fletoren Zyrtare dhe nuk janë të disponueshme në faqet e internetit.

5.2 Për marrjen e këtyre rregulloreve bëhet një kërkesë me shkrim, por që, siç rezulton nga monitorimi, mund të mos kthehet përgjigje dhe të mos bëhet e disponueshme. Kjo ndodh kryesisht në institucionet ku nuk ekziston një zyrë për marrëdhëniet me publikun. Shpeshherë kërkesës mund të mos i përgjigjet asnjë zyrë me pretendimin për mosbulim të këtij shërbimi.

5.3 Në 50 për qind të rasteve në institucionet e monitoruara, rezulton se punonjësit e zyrave për marrëdhëniet me publikun e njohin këtë detyrim.

6. Standardi: Autoriteti publik vë në dispozicion të publikut pa kërkesë shpjegimet e detajuara për metodat dhe procedurat e punës së autoritetit publik (neni 8/ç).

6.1 Për këtë standard referohu te vlerësimet e dhëna për standardin pesë.

7. Standardi: Autoriteti publik parapërgatit për shqyrtim ose kopjim, në pritje të kërkesës nga publiku, vendimet përfundimtare për një çështje të caktuar, përfshi dhe mendimin e pakicës, si dhe urdhrat ose udhëzimet në zbatim të tyre. (neni 9/a)

7.1 Këtu duhet të dallojmë vendimet që merren nga institucionet me cilësinë e organit kushtetues dhe vendime të tjera që merren me cilësinë e organit administrativ. Përsa i përket vendimeve që merren me cilësinë e organit kushtetues këto vendime botohen në Fletoren Zyrtare. Vetëm në një institucion të gjitha vendimet që merren janë të disponueshme në faqen e internetit të institucionit (Zyra e Presidentit). Nuk janë të disponueshme ligjet dhe aktet normative që nxirren nga Qeveria dhe ministrat në faqet e internetit të këtyre

institucioneve. Këto akte janë publike dhe nuk mbrohen nga e drejta e autorit. Pra, do t'i shërbehej qytetarëve në mënyrë më të shpejtë dhe efektive, duke i bërë publike këto vendime në faqet e internetit. Përsa i përket akteve të tjera të karakterit administrativ, këto nuk botohen, por mund të kërkojnë me kërkesë me shkrim.

7.2 Vendimet depozitohen në sekretariatë e këtyre institucioneve dhe më pas kalojnë në arkiv.

8. Standardi: Autoriteti publik parapërgatit për shqyrtim ose kopjim, në pritje të kërkesës nga publiku, urdhrat dhe udhëzimet e brendshme që ndikojnë në marrëdhëniet e autoritetit publik me publikun (neni 9/b).

8.1 Nuk rezulton që ky detyrim të realizohet nga institucionet e monitoruara. Duhet të bëhet kërkesë, sipas procedurës së përmendur më sipër, për të marrë një dokument të tillë. Në disa institucione është shfaqur dhe një mosbesim dhe pasiguri nëse ky dokument është publik ose konfidencial dhe a duhet të bëhet publik.

8.2 Në përgjithësi nuk rezulton që punonjësit janë të informuar për këtë detyrim.

9. Standardi: Autoriteti publik parapërgatit për shqyrtim ose kopjim, në pritje të kërkesës nga publiku, kopje të çdo dokumenti zyrtar, i cili i është dhënë më parë të paktën një personi (neni 9/c).

9.1 Nuk rezulton që të respektohet një detyrim i tillë. Nuk evidentohen dokumente të tilla.

9.2 Në përgjithësi punonjësit e intervistuar janë në dijeni të këtij detyrimi.

10. Standardi: Autoriteti publik parapërgatit për shqyrtim ose kopjim, në pritje të kërkesës nga publiku indeksin ose skedarët e dokumenteve zyrtare.

10.1 Nuk rezulton në asnjë nga institucionet e monitoruara që të zbatohet një detyrim i tillë.

10.2 Nuk rezulton që këto dokumente të evidentohen.

10.3 Në përgjithësi punonjësit nuk janë në dijeni të këtij detyrimi.

11. Standardi: Autoriteti publik respekton të drejtën e informimit për

dokumentin zyrtar në bazë të kërkesës së një personi të interesuar në një format të përshtatshëm (neni 7).

11.1 Nuk ka një format të caktuar për përgjigjen që jep institucioni për kërkesat për marrjen e informacionit.

11.2 Përgjigjet përgatiten në formatin e përgjithshëm që ndjek institucioni si për çdo kërkesë.

12. Standardi: Autoriteti publik respekton afatet për plotësimin e kërkesës (neni 11).

12.1 Në dy raste rezulton se ka regjistër të veçantë për kërkesat që lidhen me të drejtën e informimit. Në rastet kur nuk ka një strukturë për marrëdhëniet me publikun është më e mundur që të mos respektohen afatet, sepse kemi një shpërndarje të përgjegjesisë dhe punonjësit nuk e njohin këtë detyrim.

12.2 Nuk rezulton që të mbahet përgjegjësi për mosrespektimin e afateve për mosdhënien e përgjigjes. Nuk ka një rast ku të rezultojë një veprim administrativ për mosrespektim të këtij detyrimi, nga sa del nga monitorimi.

13. Standardi: Autoriteti publik respekton afatet për mospranimin e kërkesës (neni 12).

13.1 Për këtë standard referohu në vlerësimet si më sipër.

14. Standardi: Autoriteti publik për kryerjen e shërbimit të informimit për dokumentet zyrtare, nëse kjo kërkon shpenzime, mund të vendosë tarifa. Tarifat për shërbimet standarde bëhen publike (neni 13).

14.1 Vetëm në dy institucione zbatohen tarifa për dokumete të ndryshme zyrtare që kërkohen nga qytetari. Nuk ka një specifikim për tarifat. Tarifat vlerësohen të arsyeshme. Në rastet që ato ekzistojnë, janë të përcaktuara në rregulloren e të drejtës së informimit. Tarifa bazohet në koston e fotokopjes për një format a4 me çmimin që përdoret dhe në treg.

Aneks 1

Strukturat për marrëdhëniet me publikun dhe informacionin në institucionet qendrore të monitoruara

Këshilli i Ministrave

Sipas urdhrit nr.97, datë 13.5.2004 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Kryeministrisë”, në strukturën e Kryeministrisë nuk ka Drejtori të Marrëdhënieve me Publikun, por është një drejtori tjetër “Drejtoria e Informacionit” e cila në përbërjen e saj ka 2 sektorë:

1. Sektori i informacionit, me gjithsej 7 punonjës (6 specialistë, 1 specialist përkthyes)

2. Sektori i marrëdhënieve me publikun, me gjithsej 6 punonjës (1 përgjegjës sektori, 3 specialistë, 1 specialist arkivist protokollist, 1 operator).

Në strukturën e Kryeministrisë janë parashikuar edhe dy drejtori të tjera të cilat kanë të bëjnë me informimin e publiku:

1. “Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit”, me 4 punonjës (1 drejtor dhe 3 specialistë).

2. “Drejtoria e Dokumentacionit”, me 17 punonjës, i ndarë në 4 sektorë.

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit

Sipas urdhrit nr.153, datë 1.9.2004 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit”, në strukturën e kësaj Ministrie nuk parashikohet asnjë drejtori ose sektor për marrëdhëniet me publikun.

Ka një drejtori të emërtur “Drejtoria e Statistikës”, e cila është e përbërë nga dy sektorë:

1. Sektori i mostrimeve dhe vëzhgimeve, me 5 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë).

2. Sektori i përpunimit të të dhënave statistikore, me 4 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë)

Ministria e Financave

Sipas urdhrit të Kryeministrit nr.35, datë 16.3.2005 “Për disa ndryshime në urdhrin nr.192, datë 23.12.2004 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave”, në strukturën e kësaj Ministrie nuk parashikohet asnjë drejtori ose sektor për marrëdhëniet me publikun.

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve

Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.101, datë 31.7.2003 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.59, datë 24.4.2003 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Kulturës”, në strukturën e kësaj Ministrie nuk parashikohet asnjë drejtori ose sektor për marrëdhëniet me publikun.

Në strukturën e Ministrisë ka një drejtori të emërtuar “Drejtoria e kulturës së shkruar dhe e komunikimit”, 1 drejtor dhe 1 specialist. Kjo drejtori në përbërjen e saj ka edhe një sektor të emërtuar “Sektori i Bibliotekë-Arkivit”, me 3 punonjës (3 specialistë).

Ministria e Mjedisit

Sipas urdhrin të Kryeministrit, nr.2, datë 17.2.2005 “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr.147 datë 1.9.2004 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Mjedisit”, në strukturën e kësaj Ministrie nuk parashikohet asnjë drejtori ose sektor për marrëdhëniet me publikun.

Ka një drejtori të emërtur “Drejtoria e komunikimit dhe e marrëdhënieve me jashtë”, e cila në përbërjen e saj ka 1 sektor të emërtuar “Sektori i Teknologjisë së Informacionit”. E gjithë drejtoria ka këtë organikë: 1 drejtor dhe 3 specialistë.

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

Sipas urdhrin të Kryeministrit nr.148, datë 1.9.2004 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit”, në strukturën e kësaj Ministrie nuk parashikohet asnjë drejtori ose sektor për marrëdhëniet me publikun. Ka një “Sektor të teknologjisë së informacionit”, i përbërë nga 3 opunonjës (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Ky sektor është pjesë e Drejtorisë së Regjistrin Kombëtar.

Ministria e Shëndetësisë

Sipas urdhrin të Kryeministrit nr.6, datë 18.1.2005 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Shëndetësisë” në strukturën e kësaj Ministrie nuk parashikohet asnjë drejtori seo sektor për marrëdhëniet me publikun.

Ka një drejtori të emërtuar “Drejtoria e zhvillimit të teknologjisë së informacionit” me 4 punonjës (drejtori, 2 specialistë dhe një operator).

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Sipas urdhrorit të Kryeministrit nr.8, datë 24.1.2005 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit” në strukturën e kësaj Ministrie nuk ka një strukturë të veçantë për marrëdhëniet me publikun. Ka një drejtori të emërtuar “Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe të Statistikës”.

Kjo drejtori ka në organikën e saj gjithsej 5 punonjës (1 drejtor, 2 specialistë për teknologjinë e informacionit, 2 specialistë për statistikën).

Ministria e Rendit Publik

Sipas urdhrorit të Kryeministrit nr.193, datë 23.12.2004 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Rendit Publik”, në strukturën e kësaj Ministrie ka një drejtori për marrëdhëniet me publikun “Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe të Informacionit”. E gjithë drejtoria ka në strukturën e saj 8 punonjës, duke përfshirë dhe drejtorin. Kjo drejtori ka dy sektor:

1. Sektori i marrëdhënieve me publikun, 4 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë).

2. Sektori i kërkesë-ankesava, 3 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë).

Ministria e Punëve të Jashtme

Sipas urdhrorit të Kryeministrit nr.63, datë 25.4.2003 “Për disa ndryshime në urdhrin nr.138, datë 31.5.2002 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Punëve të Jashtme”, në pikën 2 thuhet: “Struktura e Ministrisë së Punëve të mbetet e pandryshuar”.

Në strukturën e kësaj Ministrie nuk parashikohet asnjë drejtori ose sektor për marrëdhëniet me publikun. Nga struktura e kësaj Ministrie do të veçonim këto drejtori të cilat kanë të bëjnë me marrëdhëniet me publikun, mbajtjen e dokumentacionit, përpunimin dhe dhënien e informacionit:

1. Drejtoria Arkivit, Dokumentacionit dhe Bibliotekës (e përbërë nga 3 sektorë)

- a. Sektori i arkivit, me 3 punonjës (3 specialistë).
- b. Sekretaria qendrore, me 3 punonjës (1 sekretar dhe 2 specialistë).
- c. Biblioteka, me 1 punonjës (1 bibliotekar).

2. Drejtoria e Shtypit, Informacionit dhe Përkthimit gjithsej 8 punonjës, e përbërë nga 3 sektorë:

- a. Sektori i shtypit, me 4 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë).
- b. Sektori i informacionit dhe përkthimit, me 5 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë).
- c. Sektori i teknologjisë së informacionit, me 3 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë).

Ministria e Ekonomisë

Sipas urdhrimit të Kryeministrit nr.163, datë 14.10.2004 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit” në strukturën e kësaj Ministrie nuk parashikohet asnjë drejtori ose sektor për marrëdhëniet me publikun.

Ministria e Industrisë dhe Energjetikës

Sipas urdhrimit të Kryeministrit nr.152, datë 1.9.2004 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës”, në strukturën e kësaj Ministrie nuk parashikohet asnjë drejtori ose sektor për marrëdhëniet me publikun.

Ka një drejtori të emërtur “Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit”, e cila në përbërjen e saj ka 4 sektor, njëri prej të cilëve është “Sektori i Informacionit, Statistikës dhe Botimeve”, me 4 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë).

Ministria e Mbrojtjes

Sipas urdhrimit të Kryeministrit nr.20, datë 7.2.2005 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Mbrojtjes”, në strukturën e kësaj Ministrie parashikohet një drejtori e veçantë për informimin e publikut

“Drejtoria e Informacionit dhe Shtypit” me gjithsej 7 punonjës. Kjo drejtori përbëhet nga 2 sektorë:

1. Sektori i medias, shtypit dhe botimeve, me 3 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë).

2. Sektori i marrëdhënieve publike, me gjithsej 3 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë).

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale

Sipas urdhrimit të Kryeministrit nr.148, datë 1.09.2004 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale”, në strukturën e kësaj Ministrie parashikohet një sektor i emërtuar “Sektori i Burimeve Njerëzore dhe i Marrëdhënieve me Publikun” i cili është pjesë e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Ky sektor ka gjithsej 4 punonjës: 1 përgjegjës sektori; 1 analist pune dhe 2 specialistë.

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit

Sipas urdhrimit të Kryeministrit nr.151, datë 1.9.2004 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit”, në strukturën e kësaj Ministrie nuk parashikohet ndonjë drejtori e veçantë për marrëdhëniet me publikun, por ka një sektor i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe është “Sektori i burimeve njerëzore, statistikës dhe marrëdhënieve me publikun”, me 4 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë).

Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacioneve

Sipas urdhrimit të Kryeministrit nr.194, datë 29.12.2004 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacionit”, në strukturën e kësaj Ministrie parashikohet një sektor i emërtuar “Sektori i Burimeve Njerëzore dhe i Marrëdhënieve me Publikun”, i cili është pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve. Ky sektor ka gjithsej 5 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë).

Ministria e Drejtësisë

Sipas urdhrimit të Kryeministrit nr.162, datë 14.10.2004 “Për miratimin e

strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë” në strukturën e kësaj Ministrie ka një Drejtori për marrëdhëniet me publikun “Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun”. Kjo drejtori ka dy sektorë: Sektori i marrëdhënieve me jashtë dhe Zyra e marrëdhënieve me publikun, e cila ka gjithsej 3 specialistë.

Ministria e Integritit

Sipas urdhrit të Kryeministrit nr.150, datë 1.9.2004 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Integritit European” në strukturën e kësaj Ministrie nuk parashikohet asnjë drejtori ose sektor për marrëdhëniet me publikun.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako

Jurist

Qendra e Studimeve Parlamentare

Ligji nr. 9090, datë 26.6.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”. Sipas ligjit të lartpërmendur, ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë ndërmjetësimin e një personi të tretë ose të një grupi personash, për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin. Ndërmjetësimi zbatohet vetëm kur kërkohet dhe pranohet nga palët, përpara ose pasi të ketë lindur mosmarrëveshja. Kur për këtë të fundit është e detyrueshme zgjidhja në rrugë gjyqësore, nuk mund të lejohet zgjidhja e saj me ndërmjetësimin. Gjithashtu, ndërmjetësuesi ose grupi i ndërmjetësuesve, nuk ka të drejtë të urdhërojë ose të detyrojë palët të pranojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Veprimtaria e ndërmjetësimit mund të ushtrohet nga çdo person që përmbush disa kushte, të cilat janë: mosha mbi 22 vjeç, të ketë arsimin e lartë, të mos jetë dënuar për vepra penale me dashje dhe të ketë figurë morale dhe publike të përshtatshme. Personat që ushtrojnë ndërmjetësimin si profesion, janë të detyruar të regjistrohen në gjykatë si persona fizikë a juridikë dhe të depozitojnë të dhënat e tyre në regjistrin e ndërmjetësuesve pranë Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në organet tatimore. Ndërmjetësuesit që e ushtrojnë veprimtarinë si profesion, kanë të drejtë të kërkojnë shpërblim për punën e kryer. Gjykata ose arbitrazhi nuk fillon ose

nuk pezullon vazhdimin e procedurave përkatëse, në rast se palët kanë rënë dakord të përdorin ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ndërmjetësuesi, brenda 45 ditëve duhet të njoftojë, sipas rastit, gjykatën ose prokurorinë për zgjidhjen ose jo të mosmarrëveshjes. Gjykata ose prokuroria mund ta vlerësojë, marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim të pavlefshme, kur konkludojnë se nuk pasqyrohet vullneti i palëve në konflikt, kur janë cenuar rëndë të drejtat dhe interesat e tyre ose kur zhdëmtimi është haptaz në disproporcion me dëmin e shkaktuar. Ligji ka 21 nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 61 të vitit 2003, në faqen 2566.

Ligji nr. 9091, datë 26.6.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8502, datë 30.6.1999 “Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”. Ndryshimet dhe shtesat që i janë bërë ligjit në fuqi kanë të bëjnë me strukturën, varësinë, detyrat, kompetencat, statusin etj. të Qendrës së Publikimeve Zyrtare dhe këto shtesa e ndryshime kanë ndikuar njëkohësisht edhe qartësimin më të mirë me anë të disa ndryshimeve që janë bërë kryesisht për anën redaksionale. Ndryshimi në nenin 1 e bën këtë Qendër institucion qendror në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe jo institucion shtetëror në rang drejtorie në varësi të Ministrisë së Drejtësisë siç është në ligjin në fuqi. Neni 2 i ligjit në fuqi trajton problemet e botimeve të Qendrës, pra përcakton se çfarë duhet të botojë kjo qendër. Ky nen ndryshohet i gjithi dhe bëhet më i plotë e më i saktë. Kështu, tani kjo Qendër, krahas detyrimeve të tjera detyrohet të botojë edhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara ose në të cilat aderohe, akte nënligjore të tjera përveç atyre që përmenden në shkronjën “a” të këtij neni, revistën “Drejtësia” dhe indekse të përgjithshme dhe indekse për fusha të veçanta në ndihmë të subjekteve të interesuara dhe të publikimit. Rregullime janë bërë edhe në nenet që trajtojnë procedurat e botimit, sidomos me afatet, dhënien e përparësive disa akteve për botim edhe në një afat më të shkurtër, mënyrën e shpërndarjes së Fletores

Zyrtare etj. Ndryshimet që i janë bërë ligjit në fuqi (në nenet 19-22), organin më të lartë vendimmarrës të Qendrës së Publikimeve Zyrtare nuk e quan më “Komision”, por “Këshill” dhe ky ndryshim bëhet për çdo nen ku përmendet fjala “Komision”. Në ndryshim nga neni 19 (në fuqi), ndryshimi i tij përcakton se Këshilli drejtohet nga përfaqësuesi i caktuar nga Ministri i Drejtësisë. Me ndryshimet që bëhen, janë prekur edhe probleme që trajtojnë strukturën, organikat dhe pagat e punonjësve të Qendrës, si dhe probleme lidhur me statusin e punonjësve të administratës së Qendrës së Publikimeve Zyrtare. Pra, pranimi në punë, transferimi, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë u nënshtrohen kritereve dhe procedurave të parashikuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të personelit administrativo-teknik, do të rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Ligji ka 11 nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 61, të vitit 2003, në faqen 2571.

Ligji nr. 9092, datë 3.7.2003 “Për zbatimin e “Konventës për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe shkatërrimin e tyre””. Ky ligj përcakton autoritetin, përgjegjësitë, krijimin dhe funksionimin e organeve të nevojshme për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa për Ndalimin e Armëve Kimike (KNAK) në Republikën e Shqipërisë, si shtet palë e saj. Autoriteti shtetëror për zbatimin e Konventës është Ministri i Mbrojtjes. Në mbështetje të autoritetit shtetëror, sipas ligjit, në Ministrinë e Mbrojtjes krijohet dhe funksionon struktura për zbatimin e Konventës. Ligji përcakton edhe detyrat e kompetencat e kësaj strukture. Deklarimi i veprimtarisë dhe verifikimi nga autoriteti shtetëror janë të detyrueshme. Subjekte deklarimi janë të gjithë ato që prodhojnë, zotërojnë, përdorin ose transferojnë lëndë kimike, importojnë ose eksportojnë lëndë me përbërje kimike që përcaktohen në tabelat që i bashkëlidhen këtij ligji. Subjektet e tilla informacionin e japin përmes një deklarate vjetore ose sa herë iu kërkohet nga autoriteti shtetëror. Ky i fundit,

kur çmon se gjendet përpara çështjeve që ndikojnë në sigurinë kombëtare, vë në dijeni Kuvendin, Presidentin dhe Kryeministrin.

Ligji në mënyrë të detajuar ka përcaktuar edhe rregullat për deklarim dhe marrje të licencës, detyrimin për informacion për organet e kontrollit kur kërkon të marrë licencën, dokumentacionin që duhet paraqitur kur kërkohet licenca si dhe organet që do të merren me këtë punë, rastet e mospranimit të kërkesës për licencë, revokimin e licencës etj.

Një vend të posaçëm zenë në këtë ligj sidomos problemet që kanë të bëjnë me inspektimet shtetërore dhe ndërkombëtare, lidhja e marrëveshjeve për inspektim, bashkëpunimi me inspektorët, kryerja e inspektimeve, detyrimi për bashkëpunim ndërmjet organeve shtetërore dhe drejtuesve të impianteve që inspektohen etj. Parashikohen, gjithashtu, edhe rastet e kundërvajtjeve administrative. Ligji ka 30 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 63 të vitit 2003, në faqen 2809.

Ligj nr.9093, datë 3.7.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”. Brenda kuadrit të Organizatës së Bujqësisë dhe të Ushqimit të Kombeve të Bashkuara, palët kontraktuese, kanë krijuar Komisionin e Përgjithshëm për Mesdheun, duke mbajtur parasysh se këto palë, kanë një interes të përbashkët në zhvillimin dhe përdorimin e përgjithshëm të burimeve detare të gjalla në Detin Mesdhe dhe Detin e Zi dhe ujërat bashkëngjitur atyre. Palët kontraktuese, gjithashtu, kanë shprehur besimin se nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, do të plotësojnë objektivat e tyre nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, i cili do të realizohet nga Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun, duke veçuar sidomos rëndësinë e ruajtjes dhe menaxhimit të peshkimit në Rajon dhe të promovimit të bashkëpunimit për këtë qëllim. Komisioni drejtohet nga një kryetar, i cili ka edhe dy nënkryetarë. Selia e tij është në Romë. Marrëveshja parashikon probleme të funksionimit të Komisionit, të rekomandimit të masave të menaxhimit, të kooperimit me

organizatat ndërkombëtare në çështje me interes të ndërsjellë, të problemeve financiare, të administratës, të amendimeve të Marrëveshjes, të pranimit ose të tërheqjes nga Marrëveshja etj. Anëtarët e Komisionit marrin përsipër edhe detyrimin, për të kontribuar çdo vit me kuotën e tyre në buxhetin vjetor, në përputhje me një shkallë kontributesh që miratohet nga Komisioni. Ky i fundit mundet gjithashtu, të pranojë donacione dhe forume të tjera asistence nga organizata, individë dhe burime të tjera për qëllime që lidhen me përmbushjen e çfarëdo funksioni të saj. Është parashikuar që çfarëdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, në rast se nuk zgjidhet nga Komisioni, do t'i referohen një Komiteti të përbërë nga një anëtar i caktuar nga secila prej Palëve në mosmarrëveshje. Në rast se edhe ky Komitet nuk e zgjidh mosmarrëveshjen, ajo do t'i referohet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.63 të vitit 2003, në faqen 2816. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja, si dhe lista me shkallën e kontributeve për buxhetin autonom.

Ligj nr.9094, datë 3.7.2003 “Për ratifikimin e “Protokollit opsional të Konventës kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës”. Qëllimi i këtij protokollit është vendosja e një sistemi vizitash të rregullta të ndërmara nga organe të pavarura ndërkombëtare dhe kombëtare në vendet ku njerëzve u është hequr liria, me qëllim që të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtëruës. Funksionet e parashikuara në këtë protokoll, do të ushtrohen nga një Nënkomitet për parandalimin e torturës dhe të trajtimit ose dënimit të egër çnjerëzor ose poshtëruës. Ky Nënkomitet e kryen punën e tij brenda kuadrit të kartës së Kombeve të Bashkuara dhe udhëhiqet nga qëllimet dhe parimet e saj, si dhe normat e Kombeve të Bashkuara në lidhje me trajtimin e njerëzve që u është hequr liria. Nënkomiteti përbëhet nga 25 anëtarë, të cilët zgjidhen nga personat me karakter të lartë moral, me përvojë profesionale

në ushtrimin e drejtësisë. Protokollin optimal trajton me hollësi kriteret, kushtet dhe procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Komitetit parandalimit, kompetencat e tyre, si dhe detyrimet e shtetasve palë për krijimin e të gjitha kushteve, me qëllim që organet e Nënkomitetit të parandalimit t'u mundësohet kryerja e detyrës. Kështu shtetet palë detyrohen të pranojnë Nënkomitetin e parandalimit në territorin e tyre dhe t'i lejojnë kryerjen në vendet e ndaluara, t'i japin informacionin përkatës, t'i lehtësojnë kontaktet me mekanizmat kombëtare parandaluese, të shqyrtojnë rekomandimet dhe të hyjnë në bisedime me të, lidhje me masat e mundshme për zbatim etj. Protokollin detyron çdo shtet pale, që një vit pasi ka ratifikuar ose ka aderuar në këtë Protokoll, të emërojë ose të krijojë një ose disa organizma të pavarur kombëtarë parandalues për parandalimin e torturës në nivel kombëtar. Po ashtu, shtet palë detyrohen të garantojnë pavarësinë e personelit të këtyre organizmave, si dhe të botojnë dhe të shpërndajnë raportet vjetore të mekanizmave parandaluese kombëtare. Protokollin trajton edhe probleme financiare, probleme të nënshtrimit të tij, të hyrjes në fuqi, të denoncimit, ndryshimit etj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.63 të vitit 2003, në faqen 2828. Ligjit i bashkëlidhet Protokollin Opsional i Konventës kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës.

Ligji nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”. Objekti i këtij ligji është rregullimi i veprimtarisë së shërbimit të jashtëm, i organizimit, bashkëpunimit dhe funksionimit të organeve që ushtrojnë shërbimin e jashtëm dhe i statusit të diplomatëve. Sipas ligjit, organet që ushtrojnë shërbimin e jashtëm janë Ministria e Punëve të Jashtme dhe strukturat në varësi të saj, bazuar në programin e Qeverisë dhe orientimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në plotësim të detyrave dhe të përgjegjësisë të veta, kjo Ministri njofton Kuvendin për çështje të rëndësishme të politikës së jashtme dhe i propozon Këshillit të Ministrave

të paraqesë përpara Kuvendit ato çështje për të cilat është e nevojshme që të mbahet qëndrim nga Kuvendi. Ligji parashtron gjithashtu, edhe bashkëpunimin e kësaj Ministrie me Presidentin e Republikës dhe institucionet e tjera. Në pjesën e dytë të ligjit flitet për institucionet e shërbimit të jashtëm dhe jepen në mënyrë të detajuar funksionet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, tregohet se nga kush drejtohet kjo Ministri, jepet statusi i Ministrit të Jashtëm, i zëvendësministrit dhe i sekretarit të përgjithshëm. Gjithashtu, në këtë pjesë flitet për strukturat e Ministrisë së Punëve të Jashtme, detyrat e zyrës së Protokollit të Shtetit për edukimin profesional të diplomatëve, e cila bëhet nga Akademia Diplomatike që ngrihet pranë kësaj Ministrie, funksionimi i të cilës rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfaqësitë diplomatike jashtë vendit, kategoritë e këtyre përfaqësive, hapja dhe mbyllja e përfaqësive diplomatike dhe funksionet e misionit diplomatik trajtohen në Kreun II. Në po këtë kre trajtohet edhe kryerja e funksioneve konsullore, funksionet e postit konsullor, misioni special, përzgjedhja e shefave të përfaqësive diplomatike, funksionet e shefit të misionit diplomatik etj. Pjesa e tretë e ligjit trajton statusin e nëpunësit të shërbimit të jashtëm, kategorizimet, pranimet, transferimet, pezullimet, humbjen e statusit etj. Në po këtë pjesë flitet edhe për gradat diplomatike dhe konsullore. Të drejtat dhe detyrat e nëpunësit të shërbimit të jashtëm, si dhe shkeljet e masat disiplinore trajtohen në pjesën e katërt, kurse pjesa e pestë dhe e gjashtë trajtojnë pagat dhe statusin e nëpunësve administrativë dhe të personelit ndihmës. Ligji ka 51 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.64 të vitit 2003, në faqen 2854.

Ligji 9096, datë 3.7.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar në ligjin nr. 8908, datë 6.6.2002”. Ligjit në fuqi, me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003, i bëhen 20 ndryshime dhe 2 shtesa. Këto shtesa janë dy nene të plota e konkretisht janë shtuar nenet 23/1 dhe 23/2. Me nenin 23/1 gjejnë rregullim

e trajtohen si shërbime të rregullta edhe ato shërbime që sigurojnë një transportim për kategori të caktuara udhëtarësh, duke përjashtuar udhëtarët e tjerë, përderisa shërbime të tilla kryhen në përputhje me pikën 3/10 të nenit 3, çka do të thotë që duhet të jetë një transport në itinere dhe vendqëndrime të pandryshuara, të ofruara nga transportues dhe të përcaktuara më parë në rregulloren e udhëtimit. Në nenin 23/2 shtohet emërtimi “transporte për llogari të vet”, duke shpjeguar se transporte të tilla quhen ato që kryhen nga një ndërmarrje për punonjësit ose një shoqatë, pa qëllim fitimi, për anëtarët e vet, në kuadër të veprimtarisë shoqërore, me kusht që transporti të jetë vetëm një veprimtari ndihmëse për ndërmarrjen ose shoqatën. Edhe ndryshimet paraqesin interes, sepse bëjnë shumë rregullime të nevojshme, si për shembull në kuptimin dhe përcaktimin më të saktë të disa termave si “transportues”, “mjet motorik”, “autobus”, “taksi”, “kamion”, “mjet motorik i kombinuar”, “transport i kombinuar” etj. Rregullim gjejnë edhe probleme lidhur me transportin e udhëtarëve brenda vendit, nga kush do të caktohen linjat në transportin qytetës, rreth qytetës dhe ndërqytetës, kush i jep licencat për këto lloje transporti etj. Në nenet pasuese trajtohen më gjerë në veçanti çdo njësi nga transportet që përmendëm më lart. Janë ndryshuar edhe disa nene të cilat kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve me taksi, si dhe për transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus, i cili duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë. Kundërvajtjet administrative janë zgjeruar edhe për disa veprime që nuk kanë qenë në ligjin në fuqi dhe përveç gjobave tani parashikohet si masë për dënimin dhe pezullimi i lejës së transportit, i lejës së qarkullimit ose të çertifikatës nga 1 deri në 6 muaj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.64 të vitit 2003, në faqen 2866.

Ligji nr.9097, datë 3.7.2003 “Për vlerësimin e konformitetit”.
Qëllimi i këtij ligji është të vendosë parimet e përgjithshme për përcaktimin e

procedurave të njëjta për vlerësimin e konformitetit të produkteve, proceseve ose shërbimeve në sferën e detyruar. Për të gjitha produktet, proceset ose shërbimet, që nuk përfshihen në sferën e detyruar, vlerësimi i konformitetit është vullnetar. Ligji ka vendosur detyrimin që si të zbatohet nga çdo person fizik dhe juridik ose privat, vëndas a i huaj që deklaron vlerësimin e konformitetit të produkteve, procesve ose shërbimeve, përkundrejt kërkesave të standardeve, rregullave teknike ose kërkesave të tjera teknike. Vlerësimi i konformitetit në sferën e detyruar zbatohet për produktet, proceset ose shërbimet që kanë të bëjnë me sigurinë e jetës, mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit ose të interesave të tjerë publikë. Ky vlerësim në sferën e detyruar bëhet nga organizma publike ose private të propozuara nga ministria apo institucioni qendror përkatës dhe të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Procedurat e vlerësimit të konformitetit në sferën e detyruar përcaktohen në rregullat teknike ose tërthorazi në standarde e kërkesa teknike dhe mbikëqyren nga ministritë ose institucioni qendror i ngarkuar me këtë detyrë. Mosmarrëveshjet ndërmjet organizimit që bën vlerësimin e konformitetit dhe subjektit të interesuar zgjidhen nga ministri përkatës. Kundër vendimit të ministrit palët e interesuara mund të paraqesin padi në gjykatën e rrethit të Tiranës. Ligji ka ngarkuar Këshillin e Ministrave, që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi, të nxjerrë katër akte nënligjore, duke përcaktuar edhe fushat që do të rregullojnë këto akte. Ligji ka 12 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.64 të vitit 2003, në faqen 2872.

Ligji nr.9098, datë 3.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj rregullon procedurat për realizimin e të drejtave për arsimimin, punësimin, kujdesin shëndetësor e shoqëror, strehimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë. Për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve të tjera përkatëse është përgjegjëse Zyra për Refugjatët e krijuar me ligjin nr.8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në

Republikën e Shqipërisë”. Ligji përcakton të drejtat e detyrimet e të huajit, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, në disa nga fushat më kryesore e më jetike si arsimimi dhe kualifikimi, punësimi, trajtimi social, përfitimi i strehimit, bashkimi familjar etj. Në fushën e arsimimit e të kualifikimit dhe të punësimit i huaji, që ka përfituar azil, gëzon të drejtën e arsimimit në institucionet publike njëlloj si shtetasi dhe për punësimin, gjithashtu, gëzon të njëjtat mundësi ligjore në tregun e punës sikurse shtetasi shqiptar. Edhe përsa i përket trajtimit social, këta të huaj e gëzojnë atë njëlloj si shtetasit shqiptarë, në përputhje me legjislaturën përkatëse lidhur me sigurimet shoqërore, përkrahjen sociale dhe sigurimet shëndetësore. Përsa i përket strehimit, ligji ka parashikuar disa variante për të plotësuar këtë nevojë. Edhe në këtë rast i huaji që ka përfituar azil ka të drejtë të gëzojë mundësitë ligjore për përfitimin e strehimit si shtetas shqiptar. Në mungesë të mundësive të veta për strehim, ky i huaj ka të drejtë të qëndrojë në qendrat për refugjatët ose në ato të strehimit të përkohshëm. Mundësi tjetër është edhe mbulimi pjesërisht i shumës së qirasë për strehim deri në masën 50 për qind të vlerës. Ligji përcakton hollësisht edhe procedurat dhe të drejtat edhe për bashkimin familjar, marrjen e vendimeve, anulimin e tyre etj. Gjithashtu, janë përcaktuar edhe disa përgjegjësi të zyrës për refugjatët dhe në fund trajtohen probleme lidhur me buxhetin dhe aktet nënllogjore, ku janë përcaktuar se kanë nevojë për këto akte nenet 6, 11, 13, 17, 25 dhe 41 të këtij ligji. Ligji ka 43 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.3.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.64 të vitit 2003 në faqen 2875.

Ligji nr. 9099, datë 3.7.2003 “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”. Qëllimi i ligjit nr. 8894, datë 15.9.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive” është vendosja e rregullave për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, tek Agjencia e Trajtimit të Kredive, si dhe mënyra e drejtimit të kësaj Agjencie. Në nenin 1 ku flitet për

sa thamë më lart, me ligjin nr. 9099, datë 3.7.2003 është shtuar një fjali ku thuhet se Agjencia e Trajtimit të Kredive, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, trajton edhe portofolin e investimeve të kryera në banesa nga shoqëria INSIG sh.a. Në pikën 2 të nenit 23 të këtij ligji në fuqi thuhet se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha veprimtaritë e Agjencisë, të cilat janë në formën e detyrimeve kundrejt debitorëve të ndryshëm, shndërohen në formën e kërkesave të Republikës së Shqipërisë dhe këto kërkesa i kalojnë Ministrisë së Financave. Me ndryshimet që bëhen në pikën 2 të nenit 23 parashikohet se këto kërkesa i kalojnë Ministrisë së Financave, e cila pas përfundimit të afatit të veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Kredive, i propozon Këshillit të Ministrave mënyrën e menaxhimit të pjesës së mbetur. Ligjia ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 64 të vitit 2003, në faqen 2884.

Ligji nr. 9100, datë 10.7.2003 “Për ratifikimin e “Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Furnizime dhe mbështetje e NATO-s (NAMSO) mbi bashkëpunimin për mbështetje logjistike””. Ky Memorandum mirëkuptimi përbën bazën ligjore në vendosjen e marrëdhënieve logjistike ndërmjet Shqipërisë dhe NAMSO-s dhe ratifikimi i tij bëhet edhe me faktin që Shqipëria ka pranuar ftesën për t’u bashkuar me partneritetin për paqe (PfP) dhe ka firmosur Dokumentin e Partneritetit për Paqe në 23 shkurt 1994 duke u bërë vend partner në PfP. Gjithashtu edhe Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë ka shprehur interes në lidhje me shërbimet e afruara nga NAMSO-ja brenda kuadrit të programeve të saj dhe partneritetit në sistemin e armëve. Memorandumi përcakton një kornizë formale për sigurimin e shërbimeve logjistike në fusha të përcaktuara qartë, duke përfshirë, por jo të kufizuara në furnizimet, mirëmbajtjen, transportin, kontrollin e trajtimit dhe asistencën teknike. Secila pale, që merr materiale ose shërbime brenda këtij Memorandumi të mirëkuptimit, do të heqë dorë nga pretendimet

për dëmet (përfshirë edhe dëmet që çojnë në vdekje), humbjet ose dëmtimet në rast se këto dëme, humbje ose dëmtime vijnë nga përdorimi normal ose/ dhe veprime gjatë punës me to. Në Memorandum parashikohet që shkëmbimi i informacionit teknik i nënshtrohet të drejtave të pronësisë, por gjithsesi palët në këtë rast kanë një seri detyrimesh, ku më kryesoret duket se janë detyrimet për përdorimin e informacionit të palës tjetër, vetëm për qëllimet e marrëveshjes dhe mbrojtjen plotësisht të sekretit të informacionit që i takon palës tjetër dhe ta ruajë nga përhapja, transferimi ose vënia e tij në dispozicion të një pale të tretë. Memorandumi trajton edhe probleme që kanë të bëjnë me procedurat e vizitave, amendamenteve, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve etj. Pjesë e Memorandumit janë edhe dy Aneksë. I pari tregon pikat e kontaktit për të gjitha çështjet që lidhen me dispozitat e këtij Memorandumi dhe Aneksi i 2 flet për një Marrëveshje zbatuese që ka të bëjë me shkatërrimin e stoqeve të minave antipersonel në Republikën e Shqipërisë. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 65 të vitit 2003, në faqen 2889. Ligjit i bashkëlidhen Memorandumi i mirëkuptimit dhe dy anekset.

Ligji nr. 9101, datë 10.7.2003, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bosnjës e Hercegovinës”. Në ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje, Republika e Shqipërisë dhe e Bosnjës e Hercegovinës kanë afirmuar angazhimin e tyre për të kontribuar në forcimin e procesit të integritimit European në Europën Juglindore, duke shprehur bindjen e plotë se kjo Marrëveshje do të përmirësojë edhe bashkëpunimin ndërsjellë dhe do të kontribuojë në procesin e integritimit në Europë. Për këtë qëllim, palët kontraktuese do të krijojnë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë gjatë një periudhe tranzitore që zgjatet deri më 31 dhjetor 2007, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe me nenin 24 të GATT-it 1994 dhe OBT-së. Objektivat e Marrëveshjes janë që, nëpërmjet zgjerimit të tregtisë dhe zhvillimit harmonik të marrëdhënieve

ekonomike, të përmisërohen standardet e jetesës, të rritet punësimi dhe, duke vendosur kushte të barabarta konkurrence, të kontribuohet në heqjen e barrierave ndaj tregtisë dhe përmirësimin e saj me tregjet e vendeve të treta. Në mënyrë të detajuar Konventa trajton probleme lidhur me tarifatat doganore bazë, me fushën e produkteve industriale, tarifat doganore mbi importet dhe eksportet, detyrimet që kanë efekt të njëjtë, barrierat në tregti etj. Të njëjtat probleme trajtohen edhe për produktet bujqësore, por për këto produkte ka edhe specifika, siç janë masat mbrojtëse sanitare dhe fitosanitare etj. Trajtohen edhe probleme të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me bashkëpunimin me administratat doganore, taksimin e brendshëm, monopolet shtetërore, rregullat e konkurrencës në mes të sipërmarrjeve, prokurimin publik, mbrojtjen e pronësisë intelektuale, antidumpingun dhe masat kundërbalancuese, procedurat për zbatimin e masave mbrojtëse në tregti, bashkimet doganore, zonat e tregtisë së lirë dhe tregtia kufitare etj. Nga kjo Marrëveshje lind detyrimi i palëve për të themeluar një Komitet të Përbashkët të përbërë nga përfaqësues të secilës palë kontraktuese. Implementimi i kësaj Marrëveshje do të bëhet nën mbikqyrjen dhe administrimin e Komitetit të Përbashkët. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 68 të vitit 2003, në faqen 3001.

Ligji nr. 9102, datë 10.7.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Shtesat dhe ndryshimet bëhen në disa nene që trajtojnë disa nga aspektet e punës së prokurorisë. Kështu në nenin që flet për ligjshmërinë e prokurorisë shtohet një fjali, ku përcakton se shkalla e hierarkisë në organin e prokurorisë përcaktohet nga Prokurori i Përgjithshëm, në përputhje me këtë ligj. Në nenin 8 të ligjit në fuqi titulli ndryshon nga “Detyrat” në “Kompetencat” dhe ndryshon pika 1 e këtij neni duke sanksionuar se Prokurori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, në

emër të shtetit, si dhe për realizimin e detyrave që, me ligj i ngarkohen Prokurorisë. Në po këtë nen, ndryshime ka pësuar edhe pika 3 që flet për delegimin e përgjegjësive, duke dhënë në mënyrë taksative se cilat përgjegjësi mund të delegohen. Me interes paraqiten edhe ndryshimet në ligjin në fuqi lidhur me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Këshillin e Prokurorisë. Në këtë të fundit është shtuar fakti që, kur Prokurori i Përgjithshëm do t'i propozojë Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të ndonjë prokurori, duhet të japë mendim për shkeljen disiplinore edhe Këshilli i Prokurorisë. Neni 19, i cili përmbante rastet e kufizimeve të emërimit, është shfuqizuar, kurse për shpalljene vende vakant për prokurorë, për të cilin ligji në fuqi kërkonte të merrej edhe mendimi i Këshillit të Prokurorisë, me ndryshimet e bëra ky mendim nuk kërkohet. Kandidatët për prokurorë emërohen në detyrë nga Presidenti i Republikës me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Kështu e ka parashikuar neni 21 i ligjit në fuqi, kurse me ndryshimin e këtij neni, lind detyrimi që Prokurori i Përgjithshëm e bën këtë propozim pasi të ketë marrë më përpara edhe mendimin e Këshillit të Prokurorisë. Ndryshime kanë pësuar edhe nenet që kanë të bëjnë me ngritjen në detyrë dhe transferimin, me komandimin e prokurorëve nga prokuroritë ku punojnë në prokuroritë e tjera, me afatet e komandimit, me largimin dhe shkarkimin nga detyra, me procedimin disiplinor etj. Me ndryshimet që janë bërë, është bërë një trajtim më i plotë edhe i procedurës së ankimit kundër dhënies së masës disiplinore dhe është hequr nga ligji në fuqi paragrafi që e bënte të paankimueshëm dekretin e Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra. Shtesat e ndryshimet që janë bërë prekin edhe probleme që kanë të bëjnë me trajtimin dhe mbrojtjen e prokurorëve që ushtrojnë detyrën pranë gjykatave të krimeve të rënda, me kohën e punës, me trajtimin ekonomik dhe me statusin e nëpunësit civil. Ligji ka 21 nene dhe ka hyrë në fuqi më 15.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 62 të vitit 2003 në faqen 2081.

Ligji nr. 9103, datë 10.7.2003 “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare”. Ky ligj synon mbrojtjen mjedisore të liqeneve ndërkufitare në gjendjen e tyre natyrore e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e jetës dhe të ekosistemeve në to, duke nxitur zhvillimin e veprimtarive të dobishme në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe duke ndaluar veprimtaritë që i rrezikojnë. Ligji zbatohet për liqenet ndërkufitare dhe pellgun e tyre ujëmbledhës për pjesën shqiptare të liqeneve të Shkodrës, Ohrit dhe të Prespës. Ligji përcakton dhe trajton probleme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e gjendjes natyrore, me detyrat e organeve shtetërore, mbrojtjen ligjore, elementet e mbrojtjes, administratën e liqeneve, kuadrin ligjor, probleme të pronësisë etj. Një vend i veçantë u kushtohet problemeve të përdorimit dhe të shfrytëzimit, duke patur parasysh këtu zbatimin e kërkesave të zhvillimit të qëndrueshëm, përdorimit të ujërave të liqeneve, veprimtarive kërkimore-shkencore dhe sidomos përcaktimit të veprimeve të ndaluara. Për veprimtaritë në liqenet ndërkufitare bëhet e detyrueshme marrja e lejes mjedisore, duke paguar një tarifë, masa e të cilës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Liqenet ndërkufitare dhe zonat e tyre ujëmbledhëse i nënshtrohen monitorimit të vazhdueshëm, për të mbajtur nën kontroll cilësinë e tyre dhe llojshmërinë biologjike. Gjithashtu, për këto liqene, ligji ka parashikuar që të bëhet inventarizimi i gjallesave dhe habitateve të tyre, në mënyrë që në bazë të këtyre inventareve të hartohet dhe të zbatohet plani i masave për mbrojtjen e llojshmërisë biologjike. Përveç inventarizimit, ligji detyron që për gjallesat bimore e shtazore të çdo liqeni ndërkufitar të ngrihet skedari rajonal, si pjesë e skedarit kombëtar, kurse administrimi i këtyre liqeneve kryhet në bazë të planeve të menaxhimit që hartohen nga Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, me organet e qeverisjes vendore, institutet kërkimore-shkencore dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore. Për zbatimin e kërkesave të këtij ligji janë përcaktuar edhe llojet e kontrollit, shkeljet dhe sanksionet ndaj tyre. Ligji ka 26 nene dhe ka hyrë në fuqi më 20.8.2003. Botuar në

Fletoren Zyrtare nr. 65 të vitit 2003, në faqen 2895.

Ligji nr. 9104, datë 17.7.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, lidhur me bashkëpunimin në fushën e parandalimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe forcimit të marrëdhënieve ushtarake dhe të mbrojtjes””. Marrëveshja e lartpërmendur është nënshkruar në Uashington DC më 12 maj 2003. Qëllimi i saj është që të ndalojë përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, si dhe të teknologjisë, materialeve dhe ekspertizës që lidhen me armë të tilla. Marrëveshja parashikon që Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sipas nevojës, mund të ndihmojë Qeverinë e Republikës së Shqipërisë të ndalojë përhapjen e këtyre lloj armëve, të parandalojë transferimin, të sigurojë magazinimin dhe transportimin e sigurt dhe të garantuar të armëve të shkatërrimit në masë, si dhe objektivave të tjerë, siç është rënë dakord ndërsjelltas me shkrim nga palët. Për zbatimin e Marrëveshjes, secila palë do të caktojë një agjent ekzekutiv dhe për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, agjenti ekzekutiv do të jetë Ministria e Mbrojtjes, kurse për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës agjenti ekzekutiv do të jetë Departamenti i Mbrojtjes. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të lehtësojë hyrjen dhe daljen e punonjësve të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të personelit kontraktues në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim që të kryejnë veprimtaritë e tyre në përputhje me këtë Marrëveshje. Punonjësve ushtarakë dhe civilë të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (përfshi edhe pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës) të pranishëm në territorin e Republikës së Shqipërisë për veprimtari që lidhen me këtë Marrëveshje, do t’u jepen privilegje dhe imunitete të barabarta me ato që i ofrohen stafit administrativ dhe teknik në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të 18 prillit 1961. Marrëveshja parashikon edhe

detyrime të tjera të ndërsjella midis palëve lidhur me shpenzimet, detyrimet doganore etj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 20.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 65 të vitit 2003, në faqen 2903. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligji nr. 9105, datë 17.7.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për privilegjet dhe imunitetet e agjencive të specializuara” dhe anekset e saj”. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka miratuar më 13 shkurt 1946 një Rezolutë që parashikonte unifikimin sa më të madh të mundshëm të privilegjeve dhe imuniteteve që gëzojnë Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e ndryshme të specializuara. Mbase janë zhvilluar këshillime ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe agjencive të specializuara, lidhur me zbatimin e Rezolutës së sipërpërmendur, Asambleja e Përgjithshme më 21 nëntor 1947 ka miratuar këtë Konventë, e cila i është paraqitur agjencive të specializuara dhe çdo shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara për pranim, si dhe çdo shteti tjetër anëtar i një ose më shumë agjencive të specializuara. Konventa trajton probleme të personalitetit juridik të këtyre agjencive, të pronave, fondeve dhe pasurive, lehtësirave për komunikim, privilegjeve, zgjidhjes së marrëveshjeve, të aderimit në këtë Konventë etj. Konventa përmban edhe tekstin përfundimtar të anekseve, siç është miratuar nga agjencitë e specializuara në dhjetor 1951, dhe janë gjithsej 16 anekse që i përkasin këtyre agjencive:

Aneksi I: - Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Aneksi II: - Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësinë.

Aneksi III: - Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Aneksi IV: - Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën.

Aneksi V: - Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Aneksi VI: - Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Aneksi VII: - Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Aneksi VIII: - Bashkimit Universal të Postave.

Aneksi IX: - Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit.

Aneksi X: - Organizatës Ndërkombëtare të Refugjatëve.

Aneksi XI: - Organizatës Botërore të Meteorologjisë.

Aneksi XII: - Organizatës Ndërqeveritare të Konsulencës Detare.

Aneksi XIII: - Korporatës Ndërkombëtare të Financës.

Aneksi XIV: - Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit.

Aneksi XV: - Organizatës Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale.

Aneksi XVI: - Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor.

Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 69 të vitit 2003. Ligjit i bashkëlidhen Konventa dhe Anekset.

Ligji nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj ka për qëllim të rregullojë organizimin, funksionimin dhe kontrollin e veprimtarisë në fushën e shërbimit spitalor në Republikën e Shqipërisë. Sipas dispozitave të këtij ligji, shtetasit shqiptarë dhe të huaj përfitojnë shërbim spitalor në spitalet publike dhe jopublike që ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Hapja dhe mbyllja e spitaleve bëhet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Shërbimi spitalor në Republikën e Shqipërisë është publik dhe jopublik, i përgjithshëm dhe i specializuar. Spitalet publike dhe jopublike janë të detyruara të shtrojnë e t’i japin ndihmë mjekësore shtetasve shqiptarë dhe të huaj, të siguruar ose jo, që kanë nevojë për shërbim spitalor urgjent për çfarëdo sëmundje ose aksident. Ligji trajton dhe rregullon edhe probleme të strukturës dhe të administrimit të autoritetit spitalor të qarkut, siç janë organizimi i autoritetit

spitalor publik të qarkut, organet drejtuese të tij, këshillin administrativ dhe funksionet e këtij këshilli, funksionet e drejtorit ekzekutiv, të komisionit mjekësor të mbikëqyrjes e të kontrollit etj. Zgjidhje gjejnë në këtë ligj edhe përcaktimi i spitaleve publike, financimi i tyre, forma e financimit, si dhe mënyra se si e zhvillojnë veprimtarinë financiare, duke udhëruar që për këtë të fundit do të zbatohen ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për institucionet me buxhet të pavarur. Spitalet publike dhe jopublike njihen, hapen, klasifikohen dhe licencohen nga Ministri i Shëndetësisë, në varësi të përmbushjes së disa kushteve dhe standardeve në bazë të teknologjisë spitalore. Ligji jep në mënyrë të detajuar se cilat janë këto kërkesa që duhen plotësuar. Përsa i përket klasifikimit të spitaleve, ligji i klasifikon ato në spitale ditore, spitale në nivel bashkie, spitale qarku dhe spitale terciare (spitale me organizim teknik të tillë që japin ndihmë mjekësore të nivelit të lartë). Lidhur me planifikimin spitalor, ligji ka parashikuar që pranë Ministrisë së Shëndetësisë të ushtrrojë veprimtarinë e vet, si një organ këshillimor, Komiteti Shtetëror për Planifikimin Spitalor. Edhe për spitalet jopublike ligji shpjegon se çdo person juridik vendas ose i huaj mund të ushtrrojë veprimtari në fushën e shërbimit spitalor, sipas procedurave të parashikuara në dispozitat e këtij ligji. Ky i fundit, përveç procedurave jep edhe kërkesat lidhur me dokumentacionin që paraqitet për marrjen e licencës pranë Komisionit të Licencave të Ministrisë së Shëndetësisë. Për nenet 3, 6, 18, 37, 39 dhe 41 ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore, kurse për nenet 7, 23, 31, 45 dhe 47 ngarkohet Ministria e Shëndetësisë. Ligji ka 53 nene dhe ka hyrë në fuqi më 20.8.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 65 të vitit 2003, në faqen 2907.

Ligji nr. 9107, datë 17.7.2003 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8636, datë 6.7.2000 “Për zonat e lira”, ndryshuar me ligjin nr. 8725, datë 26.12.2000”. Me ligjin e lartpërmendur, ndryshimet bëhen në

